In this prism, civil society in Kosovo should not be seen only as a product of transition, but as an active actor that builds and redefines the democratic space itself. It carries with it contradictions inherited from the past and new challenges related to institutionalization, legitimacy and real influence in decision-making. However, it is precisely in this tension between the normative ideal and the practical reality that its transformative potential lies, making it an irreplaceable component in the consolidation of democracy. At the same time, the return of the concept of citizenship within this space shows that the transition is not only institutional, but also deeply social and cultural. Civil society thus becomes the place where the

individual not only articulates his interests and identity but also takes shape as an active political subject.

Conclusion

This article has sought to elaborate the relationship between civil society and Fehmi Agani, presenting this connection through the prism of Agani’s intellectual and political profile. It positions Professor Agani as both a thinker and an active participant in civil society. This is demonstrated through an examination of his writings on civil society, alongside other works, as well as his political engagement during the 1990s. Civil society, in its broader conceptualization, is presented here as inherently democratic and as a sphere for the expression of human freedom, emerging in both theoretical and practical dimensions. In this sense, civil society operates not solely as a political domain but also as a philosophical one, reflecting Agani’s consistent view of their interrelatedness. Within a temporal framework, civil society is further conveyed as a national movement in Kosovo, particularly through the process of the NGO-ization of society. Agani did not regard civil society as distinct from politics; on the contrary, he encouraged civic organizations such as educational institutions and self-organized unions to assume an active and democratic role in public life, grounded in his belief that politics and civil society are fundamentally interdependent.

This temporal framing further expands the figure of Professor Agani, wherein the past is interpreted through reflection and theoretical engagement. Consequently, his figure is conceptually advanced as inseparable from civil society, with each reinforcing and reflecting the other.

In summary, for Agani, theory and practice do not exist as separate realms but rather function as two sides of the same coin. He not only articulated the concept of civil society but also embodied

it as a lived philosophy, thereby becoming a central figure in the modern history of Kosovo and in the construction of a democratic culture grounded in freedom, dialogue, and civic participation.

REFERENCES

- Agani, F. (2002a). *Në rrjedha të mendimit sociologjik* (Vepra, Libri I), [In the Streams of Sociological Thought (Works, Book I)], Pejë: Botimet Dukagjini.
- Agani, F. (2002b). *Për shoqërinë civile* (Vepra, Libri II), [On Civil Society (Works, Book II)], Pejë: Botimet Dukagjini.
- Agani, F. (2002c). *Demokracia, kombi dhe vetëvendosja* (Vepra, Libri III), [Democracy, Nation, Self-Determination (Works, Book III)], Pejë: Botimet Dukagjini.
- Agani, F. (2008). *Studime Sociologjike dhe Politologjike* [Sociological and Political Studies], Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës.
- Ekiert, G; Foa, R. (2011). *Civil Society Weakness in PostCommunist Europe: A Preliminary Assessment*. College Carlo Alberto.
- Fuchs, C. (2016). *The Praxis School's Marxist Humanism and Mihailo Marković's Theory of Communication*. Critique.
- Mavriqi, R. (2005). *Poesis e praxis: Zhvillimi i nocionit të punës prej Aristotelit deri te Hegeli*. Pejë: Dukagjini.
- Walzer, M. (1991). *The idea of civil society*. Dissent.
- Weber, M. (2006). *Politika si profesion* [Politics as a profession], Tiranë: Plejad

**DREJT ZHVILLIMIT TË PRAKTIKAVE TË
VLERËSIMIT TË SHËNDETIT MENDOR TË
ADOLESHENTËVE NË SHQIPËRI: VLERËSIMI
PSIKOMETRIK I YP-CORE, ISI-5 DHE RSES**

Blerta BODINAKU

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë

E-mail: blerta.bodinaku@unitir.edu.al

Migena BUKA

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë

E-mail: migena.buka@unitir.edu.al

Skerdi ZAHAJ

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë

E-mail: skerdi.zahaj@unitir.edu.al

Edmond RAPTË

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë

E-mail: edmond.rapti@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky studim synon të përkthejë, përshtasë kulturalisht dhe standardizojë tre instrumente me vetëraportim për vlerësimin e shëndetit mendor të adoleshentëve në Shqipëri: Young Person's Clinical Outcomes in Routine Evaluation (YP-CORE), Rosenberg Self-Esteem Scale (RSES)

dhe Identity Style Inventory–Version 5 (ISI-5). Studimi u zhvillua me 595 adoleshentë shqiptarë të moshës 12–16 vjeç nga disa rajone të vendit, ndërsa analizat psikometrike u kryen mbi kampionin final me të dhëna të plota (N = 249). Procedurat përfshinë përkthimin dhe përshtatjen kulturore sipas udhëzimeve të International Test Commission, administrimin në dy momente kohore me interval dyjavor dhe analizimin e konsistencës së brendshme, stabilitetit test–ritest, strukturës faktoriale dhe validitetit konvergjent. Rezultatet treguan se YP-CORE dhe RSES paraqitën konsistencë të mirë të brendshme dhe stabilitet të lartë kohor, ndërsa shumica e nënshkallëve të ISI-5 treguan besueshmëri të kënaqshme. Korrelacionet ndërmjet instrumenteve ishin në përputhje me pritshmëritë teorike: distresi psikologjik lidhej negativisht me vetëvlerësimin dhe angazhimin ndaj identitetit, por lidhej pozitivisht me stilin difuz-shmangës të identitetit. Analizat faktoriale mbështetën përgjithësisht strukturat teorike të instrumenteve, megjithëse disa pohime dhe nënshkallë kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm për kontekstin shqiptar. Gjetjet sugjerojnë se versionet shqiptare të YP-CORE, RSES dhe ISI-5 përbëjnë instrumente premtuese për vlerësimin e mirëqenies emocionale, vetëvlerësimin dhe proceseve të identitetit tek adoleshentët. Studimi kontribuon në zgjerimin e infrastrukturës psikometrike për fëmijët dhe adoleshentët në Shqipëri dhe mbështet zhvillimin e praktikave të vlerësimit të ndjeshme ndaj kontekstit kulturor në mjedise arsimore, klinike dhe kërkimore.

Fjalë kyçe: *Shëndeti mendor i adoleshentëve; vlerësim psikometrik; përshtatje kulturore; vlerësim psikologjik; stilet e identitetit; vetëvlerësimi.*

Prof. Asoc. **Blertha BODINAKU** është pedagogje në Departamentin e Pedagogjisë dhe Psikologjisë të Fakultetit të Shkencave Sociale në University of Tirana. Ajo është diplomuar në Psikologji Klinike dhe ka përfunduar studimet master në Psikologji Këshillimi pranë të njëjtit universitet, ndërsa studimet e doktoraturës i ka kryer në fushën e psikoterapisë dhe vlerësimit psikometrik pranë Sigmund Freud University Vienna. Që prej vitit 2007 zotëron Çertifikatën Europiane të Psikoterapisë (ECP). Veprimtaria e saj profesionale dhe kërkimore fokusohet në psikoterapi, vlerësim psikometrik, shëndet mendor dhe dhunën me bazë gjinore. Ka kontribuar në sjelljen e instrumenteve të para të vetëraportimit të validuara dhe të standardizuara në Shqipëri dhe promovon praktika të ndjeshme ndaj kontekstit kulturor në psikoterapi dhe vlerësim psikologjik. Është autore publikimesh shkencore dhe anëtare aktive e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare profesionale në fushën e psikologjisë dhe psikoterapisë.

Prof. Asoc. Dr. **Migena BUKA** është pedagogje dhe kërkuese shkencore pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë. Aktiviteti i saj akademik dhe profesional fokusohet në psikologjinë organizative, menaxhimin e burimeve njerëzore, pedagogjinë, sjelljen konsumatore dhe metodat e kërkimit shkencor. Ajo ka një eksperiencë të gjerë në mësimdhënie, kërkim dhe koordinim projektsh kombëtare e ndërkombëtare, si edhe në bashkëpunime me organizata dhe institucione të ndryshme, përfshirë UNICEF, UNDP, GIZ dhe aktorë të sektorit privat. Interesat e saj kërkimore përfshijnë vlerësimin psikometrik, mirëqenien dhe shëndetin mendor, sjelljen organizative dhe analizën e të dhënave në shkencat sociale.

Prof. Asoc. Dr. **Skerdi ZAHAJ** është pedagog në Departamentin e Pedagogjisë dhe të Psikologjisë së Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Ka kryer specializime në Institutin Qëndror të Shëndetit Mendor në Universitetin Heidelberg në Gjermani dhe është psikoterapist i certifikuar në orientimin kognitiv-bihejvioral (CBT) dhe në terapinë e fokusuar në skema (ST). Ka një përvojë 16-vjeçare në fushën e mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të psikoterapisë. Mësimdhënia e tij është fokusuar në fushën e psikoterapisë, trajtimin të traumave psikologjike, dhe metodave të kërkimit shkencor në psikologji. Interesat e tij kërkimore janë të fokusuar mbi studimin e procesit të zhvillimit të identitetit, traumave psikologjike, zhvillimit të personalitetit dhe psikopatologjive. Interesat e tij klinik janë të fokusuar në trajtimin e traumave komplekse, çrregullimeve të personalitetit, depresionit, ankthit dhe problemeve në çift. Është anëtar i Shoqatës Europiane të Psikologëve të Zhvillimit (EADP), i Shoqatës Shqiptare të Terapisë Kognitiv-bihejviorale (AACBT) dhe anëtar i “European Association for Behavioural and Cognitive Therapies” dhe “The International Society of Schema Therapy (ISST)”.

Prof. Dr. **Edmond RAPTI** është profesor i pedagogjisë dhe psikologjisë me një karrierë të gjatë akademike dhe profesionale prej mbi 40 vitesh. Ai ka përfunduar studimet universitare në biokimi dhe studimet pasuniversitare në pedagogji dhe psikologji në Universitetin e Tiranës, studime të avancuara në drejtim dhe administrim arsimit në Pace University, New York, SHBA, si dhe një sërë specializimesh profesionale në disa vende europiane. Gjatë 30 viteve të fundit ka dhënë mësim në programet bachelor, master dhe doktoraturë në fushat e pedagogjisë dhe psikologjisë. Fushat e tij të ekspertizës përfshijnë psikologjinë shkollore, shërbimin psikosocial, këshillimin e karrierës, menaxhimin dhe lidhshimin arsimor. Ai ka mbajtur role drejtuese universitare dhe ka kontribuar në reformimin e arsimit shqiptar dhe zbatimin e Procesit të Bolonjës.

Deklaratë financimi: ky studim është financuar nga Universiteti i Tiranës në kuadër të programit “UT – Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”.

Hyrje

Shëndeti mendor i adoleshentëve është kthyer gjithnjë e më shumë në një shqetësim domethënës për shëndetin publik dhe sistemin arsimor në nivel global, me një theks në rritje mbi identifikimin e hershëm dhe praktikatat bashkëkohore të vlerësimit (World Health Organization [WHO], 2025). Megjithatë, në Shqipëri, zhvillimi i instrumenteve të standardizuara dhe të vlerësuara psikometrikisht për adoleshentët mbetet i kufizuar, pavarësisht rritjes së ndërgjegjësimit mbi vulnerabilitetet psikosociale që prekin brezat e rinj (UNICEF Albania, 2021, 2024). Studimet ekzistuese kanë kontribuar me të dhëna të rëndësishme epidemiologjike dhe psikosociale, por shkollat, shërbimet e këshillimit dhe mjediset komunitare vazhdojnë të funksionojnë me akses të kufizuar në instrumente vlerësimi të validuara kulturalisht dhe të përshtatshme për përdorim klinik apo arsimor.

Në këtë kontekst, ky studim synon të përkthejë, të përshtasë kulturalisht, të validojë dhe të standardizojë tre instrumente vetëraportimi tek adoleshentët shqiptarë të moshës 11–17 vjeç: Young Person’s Clinical Outcomes in Routine Evaluation (YP-CORE), Identity Style Inventory–Version 5 (ISI-5) dhe Rosenberg Self-Esteem Scale (RSES). Së bashku, këto instrumente vlerësojnë

dimensione plotësuese të funksionimit të adoleshentëve, duke përfshirë distresin psikologjik, procesimin e identitetit dhe vetëvlerësimin global. Përmes ekzaminimit të vetive të tyre psikometrike në kontekstin shqiptar, studimi synon të kontribuojë në zhvillimin e praktikave të vlerësimit të ndjeshme ndaj kontekstit kulturor për mjediset arsimore, klinike dhe kërkimore në Shqipëri.

Rishikimi i literaturës

Adoleshenca përfaqëson një periudhë zhvillimore të karakterizuar nga transformime të rëndësishme psikologjike, emocionale, njohëse, relacionale dhe sociale. Gjatë kësaj faze, individët përballen me detyra qendrore zhvillimore që lidhen me formimin e identitetit, rregullimin emocional, autonominë, përkatesinë në grupin e bashkëmoshatarëve dhe vetëkonceptin, ndërkohë që navigojnë kërkesa gjithnjë e më të mëdha akademike, ndërpersonale dhe shoqërore (Sawyer et al., 2018). Megjithëse këto procese përbëjnë aspekte normative të zhvillimit, adoleshenca njihet gjithashtu si një periudhë me vulnerabilitet të shtuar ndaj shfaqjes së problemeve të shëndetit mendor. Evidencat ndërkombëtare tregojnë në mënyrë të qëndrueshme se shumë çrregullime psikologjike manifestohen për herë të parë gjatë adoleshencës, ku çrregullimet

emocionale, ankthi, vështirësitë në sjellje dhe vetëdëmtimi kontribuojnë ndjeshëm në dëmtimin psikosocial dhe barrën globale të sëmundshmërisë tek të rinjtë (World Health Organization [WHO], 2025). Sfidat e shëndetit mendor gjatë kësaj periudhe lidhen jo vetëm me stresin emocional të menjëhershëm dhe dëmtimin e funksionimit, por edhe me pasoja afatgjata në lidhje me arritjet arsimore, marrëdhëniet ndërpersonale, funksionimin profesional dhe trajektorët e shëndetit mendor në moshën adulte (Patel et al., 2007; Solmi et al., 2021).

Në këtë kuadër, vlerësimi psikologjik përbën një komponent qendror në praktikën e shërbimeve të shëndetit mendor të mbështetura në gjetje shkencore. Instrumentet e standardizuara dhe psikometrikisht të qëndrueshme mbështesin identifikimin e vështirësive emocionale dhe psikosociale, lehtësojnë komunikimin midis konteksteve të ndryshme profesionale dhe kontribuojnë në planifikimin e ndërhyrjeve, monitorimin dhe zhvillimin e kërkimit shkencor. Kornizat bashkëkohore të psikometrisë theksojnë gjithashtu se instrumentet psikologjike nuk funksionojnë në mënyrë ekuivalente në kontekste të ndryshme gjuhësore dhe sociokulturore pa kaluar përmes proceseve sistematike të përkthimit, përshtatjes kulturore dhe validimit (ITC, 2017). Kuptimet kulturore, normat sociale dhe përvojat kontekstuale ndikojnë në mënyrën se si distresi psikologjik përjetohet, shprehet, interpretohet dhe raportohet. Për këtë arsye, standardet bashkëkohore psikometrike theksojnë rëndësinë e ekzaminimit të besueshmërisë, validitetit, strukturës faktoriale dhe interpretueshmërisë së instrumenteve brenda popullatës së synuar përpara se ato të zbatohen në praktikë (Mokkink et al., 2019).

Në Shqipëri, shëndeti mendor i adoleshentëve po konsiderohet gjithnjë e më shumë si një çështje e rëndësishme e shëndetit publik dhe e sistemit arsimor, në kontekstin e transformimeve më të gjera socioekonomike dhe të ndryshimeve në kushtet psikosociale që prekin brezat e rinj (Bajramaj, 2026; Qosja, 2025). Megjithatë të dhënat epidemiologjike dhe longitudinale në shkallë të gjerë mbeten relativisht të kufizuara, evidencat ekzistuese sugjerojnë se mirëqenia psikologjike e adoleshentëve formësohet nga ndërveprimi i faktorëve relacionalë, zhvillimorë, sjellorë dhe më gjerë kontekstualë (UNICEF Albania, 2021, 2024). Studime të kohëve të fundit në Shqipëri kanë lidhur përvojat negative zhvillimore, neglizhencën emocionale, vulnerabilitetin e lidhur me identitetin dhe proceset joadaptive të përballimit me rezultate më të dobëta psikosociale tek adoleshentët dhe të rinjtë (Bodinaku, 2022; Sulstarova et al., 2025; Zahaj & Dimitrova, 2018). Në të njëjtën kohë, gjetjet ekzistuese tregojnë gjithashtu ndikimin e kushteve më të gjera kontekstuale përfshirë transformimet e shpejta sociale, përvojat e lidhura me migracionin, ndryshimet në strukturat familjare, pasigurinë ekonomike dhe aksesin e pabarabartë në mbështetjen psikosociale mbi mirëqenien e adoleshentëve në kontekstin shqiptar (Bodinaku et al., 2024; Pjetrushaj & Melonashi, 2025; Zahaj & Dimitrova, 2018).

Pavarësisht rritjes së ndërgjegjësimit mbi këto çështje, shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët në Shqipëri vazhdojnë të funksionojnë përmes kufizimeve të rëndësishme strukturore, duke përfshirë kapacitete të kufizuara profesionale, shpërndarje të pabarabartë gjeografike të shërbimeve dhe integrim të pamjaftueshëm ndërmjet sistemeve arsimore, psikosociale dhe

shëndetësore (Pjetrushaj & Melonashi, 2025). Në të njëjtën kohë, zhvillimi i infrastrukturës psikometrike të standardizuara për adoleshentët në Shqipëri mbetet dukshëm i kufizuar. Studimet ekzistuese dhe iniciativat monitoruese kanë kontribuar me të dhëna të vlefshme në nivel popullate mbi mirëqenien e adoleshentëve dhe vulnerabilitetin psikosocial, duke u mbështetur shpesh në kuadre ndërkombëtarisht të njohura vlerësimi, si instrumentet e Health Behaviour in School-aged Children, HBSC (UNICEF Albania, 2024). Megjithatë, këto qasje jo domosdoshmërisht u ofrojnë klinikistëve, psikologëve shkollorë, këshilluesve apo profesionistëve të shërbimeve komunitare instrumente të validuara kulturalisht dhe të përshtatshme për vlerësim individual klinik, ndjekje apo praktikë rutinë.

Mungesa e instrumenteve psikometrike të validuar dhe përshtatur kulturalisht krijon një hendek, i cili ka implikime të rëndësishme si për praktikën profesionale, ashtu edhe për kërkimin shkencor. Në mungesë të instrumenteve të standardizuara në nivel lokal, proceset e vlerësimit mund të mbështeten në përshtypje klinike informale, përkthime ad hoc apo instrumente, vetitë psikometrike të të cilëve në kontekstin shqiptar mbeten të paqarta. Kufizime të tilla reduktojnë besueshmërinë dhe interpretueshmërinë e gjetjeve të vlerësimit dhe kufizojnë zhvillimin e ndërhyrjeve të mbështetura në evidencë në mjediset arsimore dhe të shëndetit mendor. Studimet në nivel botëror ndërkombëtare tregojnë në mënyrë të qëndrueshme se instrumentet e standardizuara të vlerësimit mund të përmirësojnë identifikimin e hershëm, saktësinë e referimit, planifikimin e trajtimit dhe monitorimin e progresit, kur integrohen në mënyrë të përshtatshme në sistemet shkollore dhe të shëndetit

mendor (Basheer et al., 2025; Oddleifson et al., 2025; Thomson et al., 2025). Këto konsiderata marrin një rëndësi të veçantë në kontekste me burime të kufizuara dhe në tranzicion, ku instrumentet e shkurtra, të aksesueshme dhe psikometrikisht të qëndrueshme mund të ndihmojnë në reduktimin e barrierave ndaj vlerësimit dhe të lehtësojnë ndërhyrjen e hershme (Cottin et al., 2022; Stewart et al., 2022). Edhe në kontekstin shqiptar, profesionistët që punojnë në fushën e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve kanë theksuar nevojën për protokolle më të strukturuar vlerësimi, praktika të standardizuara dokumentimi dhe procedura më të qarta referimi, të afta për të mbështetur identifikimin e hershëm dhe vazhdimësinë e kujdesit (Qirjako et al., 2024).

Në këtë kontekst, zhvillimi i instrumenteve të përkthyer, të përshtatura kulturalisht, të validuara dhe të standardizuara për adoleshentët shqiptarë përfaqëson jo thjesht një kontribut metodologjik, por edhe një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të infrastrukturës më të gjerë të kujdesit për shëndetin mendor të adoleshentëve dhe të mbështetjes psikosociale në Shqipëri. Young Person's Clinical Outcomes in Routine Evaluation (YP-CORE), Identity Style Inventory-Version 5 (ISI-5) dhe Rosenberg Self-Esteem Scale (RSES) vlerësojnë tri dimensione plotësuese të funksionimit adoleshent: distresin psikologjik dhe mirëqenien emocionale, procesimin e identitetit dhe vetëvlerësimin global.

YP-CORE është zhvilluar si një instrument i shkurtër vlerësues si dhe matës i ecurisë, i konceptuar specifikisht për adoleshentët, në kuadrin e një pakete të gjerë instrumentesh vlerësimi të Clinical Outcomes in Routine Evaluation (CORE System Trust, n.d.). I ndërtuar mbi gjuhë dhe formulime pohimesh që synojnë të pasqyrojnë përvojat zhvillimore të

adoleshentëve, ai ka shfaqur besueshmëri, ndjeshmëri ndaj ndryshimit dhe vlerë në mjedise klinike, këshillimi dhe shërbime komunitare, si një vlerësues shumë i mirë i distresit psikologjik dhe funksionimit tek të rinjtë (O'Reilly et al., 2016; Twigg et al., 2009). Studimet e përshtatjes ndërkulturore dëshmojnë se YP-CORE ka shfaqur cilësi të mira psikometrike edhe pas përshtatjes në gjuhë dhe kultura të ndryshme (Di Biase et al., 2021; Gergov et al., 2017; Valdiviezo-Oña et al., 2024).

Ndryshe nga YP-CORE që e vendos theksin tek stresi emocional, ISI-5 trajton procesimin e identitetit, një nga detyrat qendrore zhvillimore të adoleshencës. Duke u mbështetur në kuadrin socio-kognitiv të Berzonskit, stilet e identitetit i referohen dallimeve relativisht të qëndrueshme në mënyrën se si individët përpunojnë, interpretojnë dhe reagojnë ndaj informacionit të lidhur me identitetin. ISI-5 u zhvillua si një instrument i rishikuar për vlerësimin e orientimeve informative, normative dhe difuze-shmangëse të identitetit, së bashku me angazhimin ndaj identitetit (Berzonsky et al., 2013). Studimet ekzistuese përgjithësisht mbështesin besueshmërinë dhe strukturën faktoriale të tij, ndërkohë që theksojnë rëndësinë e ekzaminimit të performancës së tij psikometrike në kontekste specifike gjuhësore dhe kulturore (Monacis et al., 2016; Muttaqin, 2021).

Shkalla e Vetëvlerësimit e Rosenberg mbetet një nga instrumentet më të përdorura për vlerësimin e vetëvlerësimit global. I zhvilluar fillimisht për adoleshentët, ky instrument vlerëson ndjenjat e përgjithshme të vetëvlerësimit dhe vetëpranimit përmes një formati të shkurtër me 10 pohime (Rosenberg, 1965). Vetëvlerësimi lidhet në mënyrë të qëndrueshme me mirëqenien emocionale, reziliencën, funksionimin akademik dhe vulnerabilitetin

ndaj vështirësive të shumanshme gjatë adoleshencës. Megjithëse RSES ka treguar veti të qëndrueshme psikometrike në nivel ndërkombëtar, studimet e fundit vazhdojnë të eksplorojnë variacionet kulturore në dimensionalitet dhe funksionimin e pohimeve, veçanërisht në lidhje me pohimet e formuluar pozitivisht dhe negativisht (Khalaf et al., 2026; Moksnes et al., 2024).

Validimi paralel i këtyre tre instrumenteve është, për rrjedhojë, i rëndësishëm si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik. Së bashku, ato ofrojnë një kuadër konciz, por shumëdimensional, për vlerësimin e mirëqenies emocionale, zhvillimit të identitetit dhe vetëvlerësimit gjatë adoleshencës. Validimi i tyre mund të kontribuojë jo vetëm në zhvillimin e kërkimit shkencor, por edhe në krijimin e një infrastrukture bazë psikometrike për shkollat, shërbimet e këshillimit dhe mjediset komunitare të shëndetit mendor në Shqipëri.

Ky studimi synon të përkthejë, përshtasë kulturalisht, validojë dhe standardizojë YP-CORE, ISI-5 dhe RSES tek adoleshentët shqiptarë të moshës 11–17 vjeç, duke ekzaminuar vetitë e tyre psikometrike si në mënyrë të pavarur, ashtu edhe në raport me njëri-tjetrin brenda një kuadri shumëdimensional vlerësimi. Përmes vlerësimit të strukturës së tyre faktoriale, besueshmërisë, validitetit dhe karakteristikave normative, studimi synon të mbështesë zhvillimin e praktikave të vlerësimit të ndjeshme ndaj kontekstit kulturor për mjediset arsimore, klinike dhe kërkimore në Shqipëri.

Metodologjia

Dizajni i studimit

Për këtë studim u përdor një dizajn vlerësimi psikometrik për të ekzaminuar përshtatshmërinë, besueshmërinë, validitetin dhe stabilitetin kohor të tre instrumenteve

psikologjike ndërkombëtarisht të njohura, të administruara tek adoleshentët në Shqipëri: Young Person's Clinical Outcomes in Routine Evaluation (YP-CORE), Rosenberg Self-Esteem Scale (RSES) dhe Identity Style Inventory (ISI-5). Qëllimi kryesor ishte vlerësimi i cilësive psikometrike të versioneve shqiptare të këtyre instrumenteve si mjete plotësuese për vlerësimin e shëndetit mendor të adoleshentëve, mirëqenies emocionale, vetëvlerësimit dhe funksionimit të identitetit brenda kontekstit sociokulturor shqiptar.

Studimi ndoqi gjithashtu një objektiv më të gjerë përtej validimit të instrumenteve individuale: ndërtimin e një kuadri shumëdimensional për vlerësimin psikologjik të adoleshentëve në Shqipëri, përmes integritet të matjeve të distresit psikologjik, vetëvlerësimit dhe procesimit të identitetit. Vendimi për të përfshirë RSES u mbështet teorikisht në lidhjen e dokumentuar gjerësisht midis vetëvlerësimit të ulët dhe rritjes së distresit psikologjik, ndërsa ISI-5 u përfshi për të ekzaminuar mënyrën se si orientimet e procesimit të identitetit lidhen me funksionimin emocional të adoleshentëve. Të marra së bashku, këto tri instrumente ofrojnë një bazë më gjithëpërfshirëse për vlerësimin e validitetit konvergjent, divergjent dhe të konstruktit në dimensione të ndërlidhura të shëndetit mendor të adoleshentëve.

Stabiliteti kohor u vlerësua përmes një dizajni test-ritest me një interval dy javor ndërmjet administrimeve. Pjesëmarrësit plotësuan të gjithë paketën e instrumenteve në dy momente kohore: Time 1 (T1) dhe Time 2 (T2), duke mundur ekzaminimin e konsistencës së rezultateve me kalimin e kohës. Përveç stabilitetit kohor, studimi analizoi konsistencën e brendshme, validitetin e konstruktit dhe validitetin konvergjent, si edhe ndërlidhjet ndërmjet instrumenteve të përfshira.

Të gjitha procedurat metodologjike u përmbajtën standardeve ndërkombëtarisht të njohura për përshtatjen ndërkulturore dhe vlerësimin psikometrik të instrumenteve psikologjike, sipas udhëzimeve të International Test Commission (ITC, 2017).

Pjesëmarrësit

Studimi u zhvillua në dy faza, brenda një dizajni psikometrik validimi me matje të përsëritura, me pjesëmarrës të përzgjedhur nga adoleshentë shqiptarë të moshës 12–16 vjeç.

Faza 1 (T1). Llogaritjet e madhësisë së kampionit, të bazuara në një marzh gabimi prej 5%, treguan se nevojiteshin afërsisht 385 pjesëmarrës për të siguruar fuqi statistikore të mjaftueshme për procedurat psikometrike dhe analizat faktoriale të planifikuara. Rekrutimi u realizua në disa rajone të Shqipërisë, përfshirë Tiranën, Shkodrën, Elbasanin, Vlorën, Korçën dhe Kukësin, me qëllim arritjen e një përfaqësimi të arsyeshëm gjeografik. Në total, 595 adoleshentë plotësuan paketën fillestare të vlerësimit në T1.

Faza 2 (T2). Afërsisht dy javë pas administrimit fillestar, të gjithë 595 pjesëmarrësit u ftuan të plotësonin sërish të njëjtën paketë instrumentesh, për të mundur vlerësimin e besueshmërisë test-ritest dhe stabilitetit kohor. Prej tyre, 393 adoleshentë përfunduan ritestin. Për të mundur përputhjen e saktë longitudinale duke ruajtur anonimitetin, secilit pjesëmarrës iu caktua një kod unik identifikimi, i cili lidhte përgjigjet e tyre në T1 dhe T2. Pas kontrollit të përputhjes së kodeve, kampioni final longitudinal me të dhëna në të dy momentet e vlerësimit përbëhej nga 358 adoleshentë. Analizat psikometrike të raportuara në tabelat e rezultateve u kryen mbi rastet me të dhëna të plota dhe të përdorshme për variablat përkatëse (N = 249).

Pjesëmarrësit u rekrutuan nga mjedise të ndryshme shkollore përmes kampionimit konvenient, bazuar në aksesueshmërinë institucionale dhe gatishmërinë e shkollave në secilin qytet për të bashkëpunuar. Kriteret e përfshirjes kërkonin që pjesëmarrësit të ishin të moshës 12-16 vjeç, të zotëronin në mënyrë të mjaftueshme gjuhën shqipe për të plotësuar instrumentet e vetëraportimit dhe të jepnin pëlqimin e informuar, së bashku me pëlqimin prindëror ose të kujdestarit ligjor. Adoleshentët me vështirësi të konsiderueshme njohëse ose komunikimi, që mund të pengonin kuptimin e pyetësorëve, u përjashtuan nga studimi. Kampioni final longitudinal për përputhjen T1-T2 përbëhej nga 358 adoleshentë; madhësia efektive e kampionit ndryshonte sipas analizës dhe sipas plotësisë së të dhënave në variablat e përfshira.

Instrumentet

Young Person's Clinical Outcomes in Routine Evaluation (YP-CORE)

Young Person's Clinical Outcomes in Routine Evaluation (YP-CORE) është një instrument i shkurtër me vetëraportim, i zhvilluar brenda kuadrit më të gjerë të sistemit CORE, për të vlerësuar distresin psikologjik dhe mirëqenien emocionale tek adoleshentët. Megjithëse YP-CORE u projektua kryesisht për adoleshentë të moshës 11–16 vjeç, praktika sugjeron se ai mund të përdoret në mënyrë më fleksibile deri në moshën 18-vjeçare (CORE System Trust, n.d.). Instrumenti përbëhet nga 10 pohime që mbulojnë katër dimensionet: mirëqenien subjektive, funksionimin e përditshëm, simptomat psikologjike dhe përvojat e lidhura me riskun, ku secili pohim vlerësohet duke iu referuar javës së fundit. Përgjigjet jepen në një shkallë

Likert me 5 pikë, nga 0 (aspak) deri në 4 (shumicën ose gjithë kohës), ku rezultatet më të larta totale pasqyrojnë nivele më të larta të distresit psikologjik. Kërkimet e mëparshme ndërkombëtare kanë mbështetur besueshmërinë, ndjeshmërinë ndaj ndryshimit dhe dobishmërinë klinike të instrumentit si në popullata jo klinike, ashtu edhe në ato klinike (Twigg et al., 2009). Studimi aktual shqyrtoi vetitë psikometrike të përshtatjes në shqip të YP-CORE, me vëmendje të veçantë ndaj konsistencës së brendshme, stabilitetit kohor dhe vlefshmërisë së konstruktive.

Shkalla e Vetëvlerësimit Rosenberg (Self-Esteem Scale - RSES)

Rosenberg Self-Esteem Scale (RSES; Rosenberg, 1965) është një nga instrumentet me vetëraportim më të përdorura për vlerësimin e vetëvlerësimit global dhe ndjenjës së vlerës personale. Instrumenti përbëhet nga 10 pohime, ndaj të cilave pjesëmarrësit përgjigjen përmes një formati të tipit Likert, që pasqyron shkallën e dakordësisë me pohime të formuluar si pozitivisht, ashtu edhe negativisht. Rezultatet më të larta tregojnë nivele më të larta të vetëvlerësimit global. RSES u përfshi në studim për të ekzaminuar validitetin konvergjent, duke u mbështetur në pritshmërinë teorikisht të argumentuar për një lidhje negative ndërmjet distresit psikologjik dhe vetëvlerësimit.

Inventari i Stileve të Identitetit – Versioni 5 (Identity Style Inventory – Version 5: ISI-5)

Identity Style Inventory (Version 5; ISI-5; Berzonsky et al., 2013) është një instrument shumëdimensional për vlerësimin e orientimeve të procesimit të identitetit dhe angazhimit ndaj identitetit. Ai vlerëson tre stile të dallueshme të

procesimit të identitetit: stilin informativ, normativ dhe difuz-shmangës, së bashku me një dimension që mat angazhimin ndaj identitetit. Pjesëmarrësit tregojnë shkallën në të cilën secili pohim karakterizon qëndrimet dhe sjelljet e tyre tipike, përmes një shkalle përgjigjeje të tipit Likert. ISI-5 u përfshi në studim për të eksploruar lidhjet ndërmjet modeleve të procesimit të identitetit dhe distresit psikologjik tek adoleshentët, si edhe për të kontribuar në vlerësimin më të gjerë të validitetit konvergjent dhe të konstruktiv të versionit shqiptar të YP-CORE.

Procesi i Përkthimit dhe Përshtatjes Kulturore

Përkthimi dhe përshtatja kulturore e YP-CORE, RSES dhe ISI-5 u realizuan në përpunime me udhëzimet e njohura ndërkombëtarisht për përshtatjen ndërkulturore të instrumenteve, sipas International Test Commission (ITC, 2017). Përkthimi fillestar i instrumenteve u krye në kuadër të projekteve të ndryshme: më vonë këto instrumente u përzgjedhën për të hartuar paketën e përdorur për këtë studim. Në të gjitha rastet, përkthimi është realizuar nga ekuipe multidisiplinare të përbëra nga profesionistë të shëndetit mendor, një përkthyes profesionist, studentë të psikologjisë dhe një person pa formim në shkencat humane apo sociale (lay person), i përfshirë për të minimizuar ndikimin e supozimeve profesionale gjatë procesit të përkthimit. Anëtarët e ekuipeve i përkthyen instrumentet në mënyrë të pavarur dhe paralelisht, pas së cilës versionet u rishikuan në ekip përmes diskutimesh pohim pas pohimi, me synim arritjen e ekuivalencës semantike, konceptuale dhe kulturore. Versionet paraprake u diskutuan më pas me adoleshentë të moshës 10–18 vjeç për të vlerësuar qartësinë, kuptueshmërinë dhe

përshtatshmërinë zhvillimore të gjuhës së përdorur.

Më pas u realizua përkthimi në të kundërt (back-translation) nga përkthyes dygjuhësh, të cilët nuk kishin njohuri paraprake mbi instrumentet origjinale, dhe versionet e rikthyera në anglisht u krahasuan në mënyrë sistematike me tekstet burimore përkatëse, me qëllim vlerësimin e ekuivalencës semantike, konceptuale dhe gjuhësore. Kur u paraqit e nevojshme, u kryen rregullime të vogla gjuhësore dhe kulturore për të siguruar përshtatshmëri zhvillimore, qartësi dhe kuptim kontekstual për popullatën shqiptare të adoleshentëve. Pilotimi i të tre instrumenteve ofroi evidenca shtesë mbi kuptueshmërinë dhe pranueshmërinë e pohimeve përpara fazës kryesore të mbledhjes së të dhënave.

Procedura

Mbledhja e të dhënave u zhvillua në mjedise shkollore pas sigurimit të autorizimeve institucionale dhe miratimit etik. Në Time 1 (T1), pjesëmarrësit plotësuan të gjithë paketën e vlerësimit, e cila përfshinte versionet shqiptare të YP-CORE, Rosenberg Self-Esteem Scale (RSES) dhe Identity Style Inventory (ISI-5). Afërsisht dy javë më vonë, të njëjtët pjesëmarrës plotësuan një paketë identike në Time 2 (T2), me qëllim vlerësimin e besueshmërisë test–ritest dhe stabilitetit kohor.

Të gjithë pyetësorët u administruan në mënyrë digjitale përmes një aplikacioni online të dedikuar, ku pjesëmarrësit plotësuan paketën e vlerësimit në pajisje të vëna në dispozicion brenda mjedisit të klasës së tyre. Administrimi u zhvillua në kushte të standardizuara dhe u mbikëqyr gjatë gjithë kohës nga anëtarë të ekipit kërkimor, duke siguruar

konsistencë të mjedisit të mbledhjes së të dhënave ndërmjet shkollave dhe rajoneve të ndryshme. Përpara fillimit të pyetësorit, pjesëmarrësit u informuan mbi natyrën konfidenciale të studimit, karakterin vullnetar të pjesëmarrjes dhe anonimitin e përgjigjeve të tyre. Format online mundësoi regjistrim efikas dhe të unifikuar të të dhënave, minimizoi rrezikun e përgjigjeve të paplota përmes mekanizmave të integruar të kujtesës për plotësim dhe lejoi grumbullimin e menjëhershëm dhe të sigurt të të dhënave. Plotësimi i gjithë paketës kërkonte afërsisht 10–15 minuta.

Analiza Statistikore

Analizat e të dhënave u kryen përmes programit SPSS version 25. Përpara realizimit të analizave kryesore psikometrike, u ndërmorën procedura paraprake të kontrollit të të dhënave për të vlerësuar cilësinë e tyre, karakteristikat shpërndarëse dhe përshtatshmërinë për analiza faktoriale dhe procedura besueshmërie (Tabachnick & Fidell, 2019).

Kontrolli fillestar përfshiu ekzaminimin e vlerave të munguara, verifikimin e vlerave minimale dhe maksimale në nivel pohimi, si edhe identifikimin e përgjigjeve që dilnin jashtë intervalit të pritshëm të pikëzimit. Përpara krijimit të rezultateve totale, pohimet e formuluar në drejtim të kundërt u rikoduan sipas manualeve të instrumenteve, në mënyrë që rezultatet më të larta të kishin të njëjtin kuptim brenda secilës shkallë. Për të gjitha pohimet u llogaritën statistika përshkruese, përfshirë mesataret dhe devijimet standarde.

Gjithashtu, u inspektuan treguesit e shtrembërimit (*skewness*) dhe të kurtosis në nivel pohimi për të vlerësuar karakteristikat e shpërndarjes dhe devijimet nga normaliteti (Field, 2018;

Kline, 2016). Rastet që shfaqnin modele të pandryshueshme përgjigjeje në të gjitha pohimet u identifikuan si potencialisht treguese të përgjigjeve të pavëmendshme ose jo të vlefshme dhe u përjashtuan nga analizat, veçanërisht duke qenë se instrumentet përfshinin edhe pohime të formuluar në drejtim të kundërt.

Duke qenë se studimi kishte një dizajn longitudinal, u vlerësua gjithashtu mundësia e paragjykimit të lidhur me humbjen e pjesëmarrësve ndërmjet matjeve, përmes krahasimit të pjesëmarrësve që përfunduan vlerësimet në të dy momentet kohore me ata që morën pjesë vetëm në T1. Besueshmëria nëpërmjet konsistencës së brendshme për YP-CORE, RSES dhe ISI-5 u vlerësua veçmas në T1 dhe T2 duke përdorur koeficientin alfa të Cronbach-ut (Cronbach, 1951), ndërsa për secilin instrument dhe në secilin moment kohor u llogaritën gjithashtu koeficientët e besueshmërisë split-half.

Struktura faktoriale e YP-CORE, RSES dhe ISI-5 u ekzaminua përmes Analizës Faktoriale Eksploruese (Exploratory Factor Analysis - EFA), e realizuar mbi nënkampionin final me të dhëna të plota dhe të përdorshme në të dy valët e vlerësimit ($N = 249$). Përpara ekstraktimit të faktorëve, përshtatshmëria e matricës së korrelacioneve u vlerësua përmes treguesit Kaiser-Meyer-Olkin (KMO) të përshtatshmërisë së kampionit dhe testit të sfericitetit të Bartlett-it (Bartlett, 1954; Kaiser, 1974). Vendimet mbi ruajtjen e faktorëve u mbështetën në kriterin e eigenvalue, inspektimin e scree plot dhe interpretueshmërinë teorike të faktorëve (Costello & Osborne, 2005).

Stabiliteti kohor përgjatë intervalit dyjavor u vlerësua përmes koeficientëve të korrelacionit intraklasor (Intraclass Correlation Coefficients – ICC), të

llogaritur ndërmjet rezultateve totale në T1 dhe T2, dhe të interpretuar në përputhje me standardet e vendosura për vlerësimin e stabilitetit (Koo & Li, 2016).

Gjithashtu, u kryen teste t për kampionët e lidhur (paired-samples t-tests) për të ekzaminuar nëse ekzistonin diferenca në nivelin mesatar ndërmjet rezultateve të T1 dhe T2, duke mundësuar identifikimin e ndryshimeve sistematike me kalimin e kohës, krahas vlerësimit të konsistencës së rezultateve. Për të gjitha testet statistikore u aplikua një prag rëndësie statistikore prej $p < .05$.

Konsiderata Etike

Studimi u zhvillua në përputhje me parimet etike të njohura për kërkimin psikologjik me popullata adoleshente. Pjesëmarrja ishte plotësisht vullnetare dhe procedurat e pëlqimit të informuar u përfunduan përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave. Për pjesëmarrësit nën moshën 18 vjeç, u sigurua pëlqimi me shkrim nga prindërit ose kujdestarët ligjorë, së bashku me miratimin e vetë adoleshentëve, në përputhje me kërkesat etike institucionale.

Përpara administrimit të instrumenteve, të gjithë pjesëmarrësit u informuan mbi qëllimin e studimit, natyrën konfidenciale të përgjigjeve të tyre, karakterin vullnetar të pjesëmarrjes dhe të drejtën e pakushtëzuar për t'u tërhequr nga studimi në çdo moment, pa asnjë pasojë. Të gjitha të dhënat u anonimizuan plotësisht dhe u përdorën ekskluzivisht për qëllime kërkimore.

Rezultatet

Në fazën e parë të pastrimit të të dhënave, u kontrollua cilësia e përgjigjeve të pjesëmarrësve ku u identifikuan raste të

mundshme të përgjigjeve automatike. Në të gjitha instrumentet kishte pohime të formuluar në të kundërt (*reverse items*) dhe kur të gjitha përgjigjet ishin të njëjta pa asnjë lloj ndryshimi, pra pyetëtori kishte devijim standard zero, duke sugjeruar një plotësim mekanik të pyetësorëve, këta pjesëmarrës u eliminuan. Këto raste nuk u përfshinë në analizat përfundimtare, me qëllim ruajtjen e validitetit dhe besueshmërisë së rezultateve. Për bazën e të dhënave finale: nuk u përjashtua asnjë rast për YP-CORE në T1 dhe T2; për RSES/IVR u përjashtua 1 rast në T1 dhe 3 raste në T2; ndërsa për ISI-5 u përjashtua 1 rast në T1 dhe 6 raste në T2. Statistikat përshkruese dhe treguesit e konsistencës së brendshme paraqiten në Tabelën 1.

Në përgjithësi, instrumentet treguan besueshmëri të kënaqshme deri të mirë në të dy momentet e matjes. YP-CORE rezultoi me alfa të Cronbach-ut .83 në T1 dhe .81 në T2, duke sugjeruar konsistencë të mirë të brendshme për matjen e distresit psikologjik. RSES tregoi gjithashtu besueshmëri të lartë, me alfa .86 në T1 dhe .87 në T2. Brenda ISI-5, stili informativ, stili difuz-shmangës dhe angazhimi ndaj identitetit treguan vlera të mira të konsistencës së brendshme. Stili normativ paraqiti vlera më modeste, në kufirin e pranueshmërisë, ndaj interpretimi i kësaj nënshkalle duhet të bëhet me kujdes në studime të mëtejshme.

Në nivel përshkrues, YP-CORE kishte mesatare $M = 12.77$, $DS = 6.63$ në T1 dhe $M = 12.94$, $DS = 6.53$ në T2. Vetëvlerësimi, i matur përmes RSES, kishte mesatare $M = 32.96$, $DS = 4.92$ në T1 dhe $M = 33.17$, $DS = 5.17$ në T2. Për nënshkallët e ISI-5, mesataret ishin përgjithësisht të qëndrueshme në dy momentet e matjes, me ndryshime të vogla në stilin informativ, stilin normativ dhe angazhimin ndaj identitetit.

Tabela 1: Statistikat përshkruese dhe treguesit e besueshmërisë së shkallëve në T1 dhe T2

Shkalla	Koha	N	M	DS	Min	Max	α	Split-half SB
YP-CORE	T1	249	12.77	6.63	0	33	.83	.88
YP-CORE	T2	249	12.94	6.53	0	32	.81	.84
RSES	T1	249	32.96	4.92	12	40	.86	.87
RSES	T2	249	33.17	5.17	10	40	.87	.87
ISI Informativ	T1	249	35.82	5.26	17	45	.79	.78
ISI Informativ	T2	249	34.80	6.03	9	45	.85	.86
ISI Normativ	T1	249	28.69	5.35	14	45	.66	.74
ISI Normativ	T2	249	27.91	5.19	9	43	.67	.69
ISI Difuz-shmangës	T1	249	22.47	5.89	9	41	.71	.72
ISI Difuz-shmangës	T2	249	22.47	6.46	9	38	.78	.78
ISI Angazhim	T1	249	34.69	6.28	14	45	.81	.86
ISI Angazhim	T2	249	33.89	6.78	15	45	.84	.86

Shënim. M = mesatarja; DS = devijimi standard; α = alfa e Cronbach-ut; Split-half SB = koeficienti Spearman-Brown për besueshmërinë split-half.

Besueshmëria test-ritest dhe diferencat ndërmjet T1 dhe T2 paraqiten në Tabelën 2. YP-CORE tregoi stabilitet të mirë në intervalin dyjavor, me $r = .77$ dhe ICC = $.77$, ndërsa diferenca ndërmjet dy matjeve nuk ishte statistikisht domethënëse, $t(248) = -0.60$, $p = .552$. Kjo tregon se niveli i distresit psikologjik nuk ndryshoi në mënyrë sistematike gjatë periudhës së ritestimit. Edhe RSES tregoi stabilitet të mirë, me $r = .76$ dhe ICC = $.76$, dhe pa diferencë domethënëse ndërmjet T1 dhe T2, $t(248) = -0.94$, $p = .349$.

Nënshkallët e ISI-5 treguan stabilitet mesatar deri të mirë. Stili informativ kishte $r = .57$ dhe ICC = $.56$; stili normativ $r = .65$ dhe ICC = $.64$; stili difuz-shmangës $r = .68$ dhe ICC = $.68$; ndërsa angazhimi

ndaj identitetit kishte stabilitetin më të lartë brenda ISI-5, me $r = .79$ dhe ICC = $.78$. Diferencat mesatare nga T1 në T2 ishin statistikisht domethënëse për stilin informativ, stilin normativ dhe angazhimin, por madhësitë e efektit ishin të vogla ($dz = .18-.19$). Për këtë arsye, këto diferenca duhet të interpretohen si ndryshime të vogla në vetëraportim dhe jo si evidencë për ndryshim të mirëfilltë zhvillimor brenda një intervali dyjavor.

Marrëdhëniet ndërmjet instrumenteve mbështetën validitetin konvergjent dhe drejtimin teorik të pritshëm të lidhjeve. Siç paraqitet në Tabelën 3, YP-CORE lidhej negativisht me vetëvlerësimin ($r = -.62$, $p < .001$), duke treguar se adoleshentët që raportojnë më shumë

Tabela 2: *Stabiliteti test-ritest dhe krahasimet ndërmjet T1 dhe T2*

Shkalla	r	ICC	t	df	p	Mdiff T1-T2	dz
YP-CORE	.77	.77	-0.60	248	.552	-0.17	-.04
RSES	.76	.76	-0.94	248	.349	-0.21	-.06
ISI Informativ	.57	.56	3.06	248	.002	1.02	.19
ISI Normativ	.65	.64	2.76	248	.006	0.78	.18
ISI Difuz-shmangës	.68	.68	0.00	248	1.000	0.00	.00
ISI Angazhim	.79	.78	2.96	248	.003	0.80	.19

Shënim. r = korrelacioni Pearson ndërmjet T1 dhe T2; ICC = koeficienti i korrelacionit intraklasor; Mdiff T1-T2 = diferenca mesatare T1 minus T2; dz = madhësia e efektit për kampionë të lidhur.

distres psikologjik raportonin edhe nivele më të ulëta të vetëvlerësimit. YP-CORE lidhej negativisht edhe me angazhimin ndaj identitetit ($r = -.47, p < .001$), stilin normativ ($r = -.39, p < .001$) dhe stilin informativ ($r = -.23, p < .001$), ndërsa lidhej pozitivisht me stilin difuz-shmangës ($r = .30, p < .001$).

Në të njëjtën kohë, RSES lidhej pozitivisht me angazhimin ndaj identitetit ($r = .60, p < .001$), stilin normativ ($r = .35, p < .001$) dhe stilin informativ ($r = .23, p < .001$), ndërsa lidhej negativisht me stilin difuz-shmangës ($r = -.35, p < .001$). Këto lidhje sugjerojnë se vetëvlerësimi më i lartë shoqërohet me një ndjenjë më të qartë të drejtimit personal

dhe me përpunim më aktiv të çështjeve të identitetit, ndërsa vetëvlerësimi më i ulët lidhet më tepër me pasiguri dhe shmangje.

Përshtatshmëria e të dhënave për analiza faktoriale u mbështet nga treguesit KMO dhe testet e Bartlett-it. Për YP-CORE, KMO ishte .89 dhe testi i Bartlett-it rezultoi domethënës, $\chi^2(45) = 862.33, p < .001$. Faktori i parë shpjegoi 43.68% të variancës, duke ofruar mbështetje për përdorimin e rezultatit total si tregues i përgjithshëm i distresit psikologjik. Për RSES, KMO ishte .90 dhe Bartlett $\chi^2(45) = 992.28, p < .001$; faktori i parë shpjegoi 47.28% të variancës, duke mbështetur interpretimin e shkallës si matje e vetëvlerësimit global. Për pohimet

Tabela 3: *Korrelacionet ndërmjet YP-CORE, RSES dhe nënshkallëve të ISI-5 në T1*

Variabli	1	2	3	4	5	6
1. YP-CORE	1					
2. RSES	-.62***	1				
3. ISI Informativ	-.23***	.23***	1			
4. ISI Normativ	-.39***	.35***	.33***	1		
5. ISI Difuz-shmangës	.30***	-.35***	-.14*	.04	1	
6. ISI Angazhim	-.47***	.60***	.39***	.38***	-.53***	1

Shënim. * $p < .05$; *** $p < .001$. YP-CORE = distres psikologjik; RSES = vetëvlerësim global.

Tabela 4: Përshatshmëria faktoriale dhe varianca e shpjeguar

Instrumenti	N	KMO	Bartlett χ^2 (df)	P	Faktorë të ruajtur	Varianca e shpjeguar
YP-CORE	249	.89	862.33 (45)	< .001	1	43.68%
RSES	249	.90	992.28 (45)	< .001	1	47.28%
ISI-5 stil-et	249	.79	1687.65 (351)	< .001	3	37.75%

Shënim. Për ISI-5, analiza faktoriale eksploruese u realizua vetëm mbi pohimet e stileve të identitetit, pa përfshirë pohimet e angazhimit, në përputhje me udhëzimet e instrumentit.

Tabela 5: Ngarkesat faktoriale të pohimeve të YP-CORE dhe RSES në faktorin kryesor

YP-CORE	Ngarkesa	RSES	Ngarkesa
YP-CORE 1	.75	RSES 1	.76
YP-CORE 2	.75	RSES 2	.78
YP-CORE 3	.37	RSES 3	.56
YP-CORE 4	.67	RSES 4	.64
YP-CORE 5	.19	RSES 5	.55
YP-CORE 6	.81	RSES 6	.77
YP-CORE 7	.80	RSES 7	.68
YP-CORE 8	.69	RSES 8	.48
YP-CORE 9	.80	RSES 9	.75
YP-CORE 10	.48	RSES 10	.81

Shënim. Janë paraqitur vlerat absolute të ngarkesave faktoriale në faktorin kryesor. Ngarkesat negative në YP-CORE reflektonin orientimin e komponentit dhe nuk ndryshojnë interpretimin psikometrik.

e stileve të ISI-5, KMO ishte .79 dhe Bartlett $\chi^2(351) = 1687.65$, $p < .001$. Zgjidhja me tre faktorë shpjegoi 37.75% të variancës dhe ishte në përputhje të përgjithshme me ndarjen teorike ndërmjet stilit informativ, normativ dhe difuz-shmangës.

Ngarkesat faktoriale të YP-CORE dhe RSES treguan se shumica e pohimeve kishin ngarkesa të pranueshme në faktorin kryesor. Në YP-CORE, disa pohime kishin ngarkesa më të ulëta, veçanërisht pohimi 5, gjë që sugjeron nevojën për shqyrtim të mëtejshëm të funksionimit të

këtij pohimi në kontekstin shqiptar. Në RSES, ngarkesat në faktorin e parë ishin përgjithësisht të forta, megjithëse struktura e shkallës mund të ndikohet nga prania e pohimeve të formuluar pozitivisht dhe negativisht, një dukuri e dokumentuar në përdorimin ndërkombëtar të kësaj shkalle.

Për të plotësuar interpretimin e strukturës së ISI-5, ngarkesat e stileve të identitetit paraqiten në Tabelën 6. Stili informativ dhe ai difuz-shmangës u shfaqën më të qartë, ndërsa stili normativ kishte ngarkesa më të moderuara dhe disa mbivendosje me faktorët e tjerë.

Tabela 6: *Ngarkesat faktoriale të stileve të identitetit në ISI-5 në TI*

Pohimi	Informativ	Difuz-shmangës	Normativ
ISI 4	.26	.16	.31
ISI 8	.61	.02	.03
ISI 12	.52	.06	.23
ISI 16	.73	-.15	.03
ISI 20	.72	.06	-.01
ISI 24	.72	-.20	-.03
ISI 28	.61	-.23	.23
ISI 32	.62	-.07	.08
ISI 36	.70	.03	-.09
ISI 2	.27	-.43	.49
ISI 6	.19	.16	.46
ISI 10	.14	-.44	.46
ISI 14	.12	.21	.56
ISI 18	-.06	.05	.63
ISI 22	.00	-.08	.57
ISI 26	-.01	.37	.39
ISI 30	.04	-.29	.48
ISI 34	.47	-.03	.31
ISI 3	-.07	.42	-.07
ISI 7	-.12	.17	.39
ISI 11	-.28	.33	.35
ISI 15	.21	.47	.17
ISI 19	-.14	.62	.09
ISI 23	-.07	.65	.16
ISI 27	-.17	.62	.02
ISI 31	-.02	.54	.03
ISI 35	-.04	.71	-.18

Shënim. Ngarkesat $\geq |.40|$ janë theksuar. Itemet e angazhimit ndaj identitetit nuk u përfshinë në këtë analizë faktoriale, sepse ato përbëjnë një shkallë të veçantë sipas udhëzimeve të ISI-5.

Diskutime

Qëllimi i këtij studimi ishte të shqyrtonte vetitë psikometrike të versioneve shqiptare të YP-CORE, RSES dhe ISI-5 tek adoleshentët shqiptarë, duke i parë këto instrumente si pjesë të një pakete më të gjerë vlerësimi për shëndetin mendor, vetëvlerësimin dhe zhvillimin e identitetit. Në tërësi, rezultatet ofrojnë evidencë të favorshme për përdorimin e këtyre instrumenteve në kontekstin shqiptar, veçanërisht për qëllime kërkimore dhe vlerësuese në mjedise shkollore apo psikosociale. Kjo është me rëndësi, sepse infrastruktura psikometrike për adoleshentët në Shqipëri mbetet ende e kufizuar dhe shpesh praktika profesionale mbështetet në instrumente të përkthyer pa një dokumentim të mjaftueshëm të funksionimit të tyre lokal (Pjetrushaj & Melonashi, 2025; UNICEF Albania, 2024).

Një aspekt që duhet theksuar në interpretimin e rezultateve është kontrolli i kujdesshëm i cilësisë së të dhënave përpara analizave kryesore. Përjashtimi i rasteve me përgjigje të pandryshueshme në të gjitha pohimet ishte një hap i rëndësishëm metodologjik, sepse instrumentet përfshinin edhe pohime të formuluara në drejtim të kundërt. Pra, dhënia e së njëjtës përgjigje në të gjitha pohimet nuk mund të interpretohet si një profil psikologjik i qëndrueshëm, por si një tregues i mundshëm i plotësimit mekanik, të pavëmendshëm ose të pamjaftueshëm të pyetësorit. Nisur nga ky vendim besueshmëria e analizave përfundimtare është rritur ndjeshëm, sepse është reduktuar rreziku që rezultatet psikometrike të ndikohen nga modele përgjigjeje që nuk reflektojnë përmbajtjen reale të pohimeve (Field, 2018; Tabachnick & Fidell, 2019).

YP-CORE tregoi konsistencë të brendshme të mirë dhe stabilitet të

lartë test-ritest. Kjo është një gjetje e rëndësishme, pasi instrumenti është i shkurtër, praktik dhe i përshtatshëm për administrim në mjedise ku koha dhe burimet janë të kufizuara. Në këtë kampion, rezultatet e YP-CORE nuk ndryshuan në mënyrë domethënëse nga T1 në T2, çka sugjeron qëndrueshmëri të mirë afatshkurtër të matjes së distresit psikologjik. Kjo mbështet përdorimin e tij si një mjet i përshtatshëm për vlerësim fillestar dhe monitorim të përgjithshëm në kontekste shkollore, kërkimore dhe këshillimi, në përputhje me rolin që YP-CORE ka në literaturën ndërkombëtare si instrument i shkurtër për vlerësimin e funksionimit emocional të të rinjve (Twigg et al., 2009; O'Reilly et al., 2016).

Megjithatë, interpretimi praktik i YP-CORE duhet të mbetet i kujdesshëm. Instrumenti mund të ndihmojë në identifikimin e adoleshentëve që raportojnë më shumë distres psikologjik, por ai nuk duhet të përdoret i vetëm për vendimarrje diagnostike. Rezultatet e tij marrin kuptim më të plotë kur lexohen së bashku me informacionin kontekstual mbi funksionimin shkollor, marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet me bashkëmoshatarët dhe ngjarjet stresuese të jetës. Në praktikën shkollore, kjo do të thotë se një rezultat i lartë duhet të shërbejë si sinjal për vlerësim të mëtejshëm dhe jo si etiketim i drejtpërdrejtë i një problemi klinik (Basheer et al., 2025; Thomson et al., 2025).

RSES tregoi veti shumë të mira psikometrike në këtë kampion. Konsistenca e brendshme ishte e lartë në të dy matjet dhe stabiliteti test-ritest ishte i fortë. Kjo sugjeron se versioni shqiptar i shkallës funksionon në mënyrë të qëndrueshme si matje e vetëvlerësimit global tek adoleshentët. Lidhjet me YP-CORE dhe ISI-5 ishin në përputhje me pritshmëritë teorike: vetëvlerësimi më i lartë lidhej

me më pak stres, më shumë angazhim ndaj identitetit dhe më pak shmangie në përpunimin e çështjeve personale. Këto marrëdhënie e mbështesin rolin e vetëvlerësimit si një tregues qendror i mirëqenies psikologjike gjatë adoleshencës (Rosenberg, 1965; Moksnes et al., 2024).

Në të njëjtën kohë, vetëvlerësimi nuk duhet kuptuar vetëm si një karakteristikë individuale e izoluar. Tek adoleshentët, ai ndërtohet dhe rinegociohet vazhdimisht në marrëdhënie me performancën akademike, pranimin nga bashkëmoshatarët, komunikimin familjar, perceptimin e trupit dhe pritshmëritë sociale. Për këtë arsye, lidhja e fortë ndërmjet vetëvlerësimit dhe distresit psikologjik në këtë studim sugjeron se ndërhyrjet që synojnë mirëqenien emocionale të adoleshentëve duhet të marrin parasysh edhe mënyrën se si ata e vlerësojnë veten, ndihen të pranuar dhe përfytyrojnë kompetencën personale (Patel et al., 2007; Sawyer et al., 2018).

Rezultatet për ISI-5 janë përgjithësisht mbështetëse, por kërkojnë një lexim më të kujdesshëm. Stili informativ, stili difuz-shmangës dhe angazhimi ndaj identitetit treguan besueshmëri të mirë ose të kënaqshme. Stili normativ, megjithëse i pranueshëm, pati vlera më të ulëta të konsistencës së brendshme. Kjo nuk e zhvlerëson nënshkallën, por sugjeron se ky dimension mund të jetë më kompleks në kontekstin shqiptar. Në kontekste ku familja, pritshmëritë sociale dhe normat kolektive kanë rol të rëndësishëm në vendimmarrjen e adoleshentëve, përgjigjet ndaj pohimeve normative mund të mos pasqyrojnë vetëm konformizëm, por edhe respekt për autoritetin, përkatësi familjare ose orientim drejt sigurisë sociale (Berzonsky et al., 2013; Monacis et al., 2016).

Kjo gjetje ka rëndësi teorike dhe kulturore. Në modelet perëndimore të zhvillimit të identitetit, orientimi

normativ shpesh interpretohet si prirje për të adoptuar vlera dhe qëllime të jashtme pa eksplorim të gjerë personal. Në kontekstin shqiptar, një interpretim i tillë duhet të nuancohet. Mbështetja tek familja dhe tek figurat e rëndësishme mund të përbëjë një burim stabiliteti për disa adoleshentë, ndërsa për të tjerë mund të kufizojë eksplorimin personal dhe autonominë. Prandaj, stili normativ mund të ketë domethënie të ndryshme në varësi të cilësisë së marrëdhënieve familjare, fleksibilitetit të normave sociale dhe nivelit të hapësirës që adoleshenti ka për të negociuar zgjedhjet e veta (Zahaj & Dimitrova, 2018; Sulstarova et al., 2025).

Një gjetje e rëndësishme lidhet me stilin difuz-shmangës. Ky stil ishte pozitivisht i lidhur me distresin psikologjik dhe negativisht i lidhur me vetëvlerësimin dhe angazhimin ndaj identitetit. Kjo mbështet idenë se shmangia e reflektimit mbi çështje personale, shtyrja e vendimeve dhe pasiguria në lidhje me drejtimin e jetës mund të shoqërohen me më shumë vështirësi emocionale tek adoleshentët. Në terma praktikë, kjo gjetje sugjeron se vështirësitë emocionale nuk duhen parë të shkëputura nga proceset e identitetit, veçanërisht në vlerësimet që realizohen në mjedise shkollore dhe këshillimi (Berzonsky et al., 2013; Muttaqin, 2021).

Në këtë kuptim, angazhimi ndaj identitetit mund të shihet si një element mbrojtës në funksionimin psikologjik të adoleshentëve. Ai nuk nënkupton domosdoshmërisht se zgjedhjet e adoleshentit janë përfundimtare ose të pandryshueshme, por se individi ka një ndjesi më të qartë orientimi dhe përkatësie ndaj vlerave, qëllimeve apo roleve të caktuara. Për praktikën e këshillimit, kjo nënvizon rëndësinë e punës me qëllimet personale, interesat, vlerat dhe pritshmëritë për të ardhmen, jo vetëm si çështje orientimi

akademik apo karriere, por edhe si pjesë e mirëqenies psikologjike (Cicchetti & Rogosch, 2002; Sawyer et al., 2018).

Në aspektin strukturor, rezultatet e analizave faktoriale ofrojnë mbështetje për përdorimin e instrumenteve, por tregojnë edhe disa pika që duhen ndjekur në kërkime të ardhshme. YP-CORE dhe RSES shfaqën faktorë të parë të fortë dhe të interpretueshëm, duke mbështetur përdorimin e rezultateve totale. Për ISI-5, struktura me tre stile u mbështet në përgjithësi, por stili normativ rezultoi më pak i pastër se dy stilet e tjera. Kjo sugjeron nevojën për analiza të mëtejshme, përfshirë analiza faktoriale konfirmuese dhe testim të invariancës sipas gjinisë, moshës apo rajonit (Costello & Osborne, 2005; Mokkink et al., 2024).

Nga pikëpamja praktike, ky studim kontribuon në zgjerimin e bazës psikometrike për vlerësimin e adoleshentëve në Shqipëri.

Instrumentet e shkurtra, të standardizuara dhe të përshtatura kulturalisht janë të rëndësishme në shkolla, shërbime këshillimi dhe mjedise komunitare, ku identifikimi i hershëm i vështirësive emocionale mund të mbështesë referimin dhe ndërhyrjen më të përshtatshme (Oddleifson et al., 2025; Stewart et al., 2022).

Megjithatë, studimi ka edhe kufizime. Të dhënat janë me vetëraportim, ndaj mund të ndikohen nga dëshirueshmëria sociale, niveli i reflektimit personal ose mënyra se si pjesëmarrësit kuptojnë pohimet. Gjithashtu, intervali test-ritest prej dy javësh është i përshtatshëm për vlerësimin e stabilitetit afatshkurtër, por nuk tregon mjaftueshëm mbi qëndrueshmërinë afatgjatë të instrumenteve. Për më tepër, të dhënat nuk duhet të interpretohen si tregues diagnostikë, sepse studimi kishte fokus psikometrik dhe jo klinik (Koo & Li, 2016).

REFERENCAT

- Barjamaj, V. (2026, January 29). *Youth Mental Health and Employment in Albania: What Young People Are Telling Policymakers - SCiDEV*. SCiDEV. <https://scidevcenter.org/2026/01/29/youth-mental-health-and-employment-in-albania-what-young-people-are-telling-policymakers/>
- Bartlett, M. S. (1954). A note on the multiplying factors for various chi-square approximations. *Journal of the Royal Statistical Society: Series B (Methodological)*, 16(2), 296–298. <https://www.jstor.org/stable/2983697>.
- Basheer, S., Tan, S., David, R., Majumder, P., & Sayal, K. (2025). Review article: The acceptability and effectiveness of standardised diagnostic assessment approaches in children and young people's mental health services – An updated systematic review. *Child and Adolescent Mental Health*, 30, 364–374. <https://doi.org/10.1111/camh.70007>
- Berzonsky, M. D., Soenens, B., Luyckx, K., Smits, I., Papini, D. R., & Goossens, L. (2013). Development and validation of the revised Identity Style Inventory (ISI-5): Factor structure, reliability, and validity. *Psychological Assessment*, 25(3), 893–904. <https://doi.org/10.1037/a0032642>
- Bodinaku, B. (2022). Një eksplorim i tipareve të ideacionit paranoid dhe hostilitetit në shoqërinë shqiptare [An exploration of constructs of hostility and paranoid ideation in the Albanian society]. *Social Studies Journal*, 16(6), 41–50.
- Bodinaku, B., Evans, C., & Pokorny, D. (2024). Interpreting differences in questionnaire scores in the context of cultural location: A country case study of Symptom Check List-90-Revised data from Albania, Germany and the USA. *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, 13(4), 159–170. <https://doi.org/10.1111/camh.70007>

- org/10.36941/ajis-2024-0106
- CORE System Trust. (n.d.). Clinical Outcomes in Routine Evaluation (CORE) system. <https://www.coresystemtrust.org.uk/>
- Costello, A., & Osborne, J. (2005). Best practices in exploratory factor analysis: four recommendations for getting the most from your analysis. *Research, and Evaluation Practical Assessment, Research, and Evaluation*, 10(7), 7. <https://doi.org/10.7275/jyj1-4868>
- Cottin, M., Blum, K., Konjufca, J., Quevedo, Y., Kaaya, S., Behn, A., Schmeck, K., Sharp, C., & Zimmermann, R. (2022). Digital use of standardised assessment tools for children and adolescents: can available paper-based questionnaires be used free of charge in electronic format? *BMC Psychiatry*, 22(1). <https://doi.org/10.1186/s12888-022-04023-w>
- Cronbach, L. J. (1951). Coefficient alpha and the internal structure of tests. *Psychometrika*, 16(3), 297–334. <https://doi.org/10.1007/bf02310555>
- Di Biase, R., Evans, C., Rebecchi, D., Baccari, E., Saltini, A., Bravi, E., Palmieri, G., & Starace, F. (2021). Exploration of psychometric properties of the Italian version of the Core Young Person's Clinical Outcomes in Routine Evaluation (YP-CORE). *Research in Psychotherapy: Psychopathology, Process and Outcome*, 24(2). <https://doi.org/10.4081/rippo.2021.554>
- Field, A. (2018). *Discovering statistics using IBM SPSS statistics* (5th ed.). Sage.
- Gergov, V., Lahti, J., Marttunen, M., Lipsanen, J., Evans, C., Ranta, K., Laitila, A., & Lindberg, N. (2017). Psychometric properties of the Finnish version of the Young Person's Clinical Outcomes in Routine Evaluation (YP-CORE) questionnaire. *Nordic Journal of Psychiatry*, 71(4), 250–255. <https://doi.org/10.1080/08039488.2016.1270352>
- International Test Commission. (2017). ITC Guidelines for Translating and Adapting Tests (Second Edition). *International Journal of Testing*, 18(2), 101–134. <https://doi.org/10.1080/15305058.2017.1398166>
- Kaiser, H. F. (1974). An Index of Factorial Simplicity. *Psychometrika*, 39(1), 31–36. <https://doi.org/10.1007/bf02291575>
- Khalaf, A., Ziad, R., Ny, P., & Hammarlund, C. S. (2026). Psychometric properties of Rosenberg's self-esteem scale among adolescents: a Rasch model analysis. *Frontiers in Psychology*, 17. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2026.1704135>
- Kline, R. B. (2016). *Principles and practice of structural equation modeling* (4th ed.). Guilford Press.
- Koo, T. K., & Li, M. Y. (2016). A Guideline of Selecting and Reporting Intraclass Correlation Coefficients for Reliability Research. *Journal of Chiropractic Medicine*, 15(2), 155–163. <https://doi.org/10.1016/j.jcm.2016.02.012>
- Mokkink, L. B., Elsmann, E. B. M., & Terwee, C. B. (2024). COSMIN guideline for systematic reviews of patient-reported outcome measures version 2.0. *Quality of Life Research*. <https://doi.org/10.1007/s11136-024-03761-6>
- Moksnes, U. K., Espnes, G. A., Eilertsen, M. E. B., Bjørnsen, H. N., Ringdal, R., & Haugan, G. (2024). Validation of Rosenberg self-esteem scale among Norwegian adolescents – psychometric properties across samples. *BMC Psychology*, 12(1). <https://doi.org/10.1186/s40359-024-02004-0>
- Monacis, L., de Palo, V., Sinatra, M., & Berzonsky, M. D. (2016). The Revised Identity Style Inventory: Factor Structure and Validity in Italian Speaking Students. *Frontiers in Psychology*, 7. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2016.00883>
- Muttaqin, D. (2021). Psychometric Properties of Identity Style Inventory-5 Indonesian Version: Factor Structure, Reliability, and Criterion Validity. *Jurnal Psikologi*, 48(1), 23. <https://doi.org/10.22146/jpsi.46179>
- Oddleifson, C., Vengurlekar, I. N., Hendrix,

- C., Levis, T., Anderson, E., Eklund, K., & Kilgus, S. (2025). A Scoping Review of Validity Evidence for Technology-Mediated Assessments of Youth Mental Health. *School Mental Health*. <https://doi.org/10.1007/s12310-025-09760-3>
- O'Reilly, A., Peiper, N., O'Keefe, L., Illback, R., & Clayton, R. (2016). Performance of the CORE-10 and YP-CORE measures in a sample of youth engaging with a community mental health service. *International Journal of Methods in Psychiatric Research*, 25(4), 324–332. <https://doi.org/10.1002/mpr.1500>
- Patel, V., Flisher, A. J., Hetrick, S., & McGorry, P. (2007). Mental health of young people: a global public-health challenge. *The Lancet*, 369(9569), 1302–1313. [https://doi.org/10.1016/S0140-6736\(07\)60368-7](https://doi.org/10.1016/S0140-6736(07)60368-7)
- Pjetrushaj, S., & Melonashi, E. (2025). Exploring the Landscape of Child and Adolescent Mental Health Care in Albania - Current Situation and Mental Health Services. *Polis*, 23(2), 96–111. <https://doi.org/10.58944/wxvw6025>
- Qirjako, G., Qosja, A., Çumashi, R., Kuneshka, L., & Burazeri, G. (2024). Abuse and neglect correlates of poor mental health among 15-year-old schoolchildren in a southeast European country. *Child Abuse & Neglect*, 157, 107081. <https://doi.org/10.1016/j.chiabu.2024.107081>
- Qosja, A., Çumashi, R., Burazeri, G., Bukli, M., & Qirjako, G. (2025). Prevalence and socio-demographic correlates of mental health indices among schoolchildren in Albania. *Scandinavian Journal of Public Health*. <https://doi.org/10.1177/14034948251326827>
- Rosenberg, M. (1965). *Society and the adolescent self-image*. Princeton University Press.
- Sawyer, S. M., Azzopardi, P. S., Wickremarathne, D., & Patton, G. C. (2018). The Age of Adolescence. *The Lancet Child & Adolescent Health*, 2(3), 223–228. [https://doi.org/10.1016/s2352-4642\(18\)30022-1](https://doi.org/10.1016/s2352-4642(18)30022-1)
- Solmi, M., Radua, J., Olivola, M., Croce, E., Soardo, L., Salazar de Pablo, G., Il Shin, J., Kirkbride, J. B., Jones, P., Kim, J. H., Kim, J. Y., Carvalho, A. F., Seeman, M. V., Correll, C. U., & Fusar-Poli, P. (2021). Age at onset of mental disorders worldwide: large-scale meta-analysis of 192 epidemiological studies. *Molecular Psychiatry*, 27(1), 281–295. <https://doi.org/10.1038/s41380-021-01161-7>
- Stewart, S. L., Celebre, A., Semovski, V., Hirdes, J. P., Vadeboncoeur, C., & Poss, J. W. (2022). The interRAI Child and Youth Suite of Mental Health Assessment Instruments: An Integrated Approach to Mental Health Service Delivery. *Frontiers in Psychiatry*, 13. <https://doi.org/10.3389/fpsy.2022.710569>
- Sulstarova, A., Bodinaku, B., Zahaj, S., Sula, G., & Hysi, G. (2025). Trauma, Emotional Neglect, and Developmental Vulnerability in Children: Evidence from Albania. *Behavioral Sciences*, 15(12), 1608–1608. <https://doi.org/10.3390/bs15121608>
- Tabachnick, B. G., & Fidell, L. S. (2019). *Using multivariate statistics* (7th ed.). Pearson.
- Thomson, L., Newman, K., Ewart, C., Bhardwaj, A., Dubicka, B., Marshall, T., Gledhill, J., Lang, A., Sprange, K., & Sayal, K. (2025). Barriers and facilitators to using standardised diagnostic assessments in child and adolescent mental health services: a qualitative process evaluation of the STADIA trial. *European Child & Adolescent Psychiatry*. <https://doi.org/10.1007/s00787-025-02678-w>
- Twigg, E., Barkham, M., Bewick, B. M., Mulhern, B., Connell, J., & Cooper, M. (2009). The Young Person's CORE: Development of a brief outcome measure for young people. *Counselling and Psychotherapy Research*, 9(3), 160–168. <https://doi.org/10.1080/14733140902979722>
- UNICEF Albania. (2021). *Impact of COVID-19 on poor mental health in children and young people is 'tip of the iceberg'*. <https://www.unicef.org/albania/press-releases/impact-covid-19-poor-mental-health-children-and-young-people->

- tip-iceberg-unicef
- UNICEF Albania. (2024, January 12). *Health Behaviour in School-aged Children: 11, 13, and 15 years old*. <https://www.unicef.org/albania/reports/health-behaviour-school-aged-children-11-13-and-15-years-old>.
- Valdiviezo-Oña, J., Ortiz-Mancheno, N., Valdivieso-Arias, G., Erazo-Pérez, D., Rodríguez-Lorenzana, A., Evans, C., & Paz, C. (2024). Assessing the suitability and psychometric properties of the Spanish version of the YP-CORE for adolescents in Latin America: A study in Ecuador. *BMC Psychology*, 12(1). <https://doi.org/10.1186/s40359-024-02169-8>
- World Health Organization. (2025, September 1). *Mental health of adolescents*. <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/adolescent-mental-health>
- World Health Organization Regional Office for Europe. (2025). *Child and youth mental health in the WHO European Region: Status and actions to strengthen the quality of care*. WHO Regional Office for Europe. <https://www.who.int/europe/publications/i/item/WHO-EURO-2025-12824-52598-81473>
- Zahaj, S., & Dimitrova, R. (2018). The influence of identity styles on adolescents' psychological problems in postcommunist Albania. In N. Lebedeva, R. Dimitrova, & J. Berry (Eds.), *Changing values and identities in the post-communist world* (pp. 281–294). Springer. https://doi.org/10.1007/978-3-319-72616-8_16

ABSTRACT

This study aimed to translate, culturally adapt, validate, and standardize three self-report instruments for the assessment of adolescent mental health in Albania: the Young Person's Clinical Outcomes in Routine Evaluation (YP-CORE), the Rosenberg Self-Esteem Scale (RSES), and the Identity Style Inventory–Version 5 (ISI-5). The study was conducted with 595 Albanian adolescents aged 12–16 years recruited from several regions of the country, while psychometric analyses were performed on the final sample with complete data (N = 249). Procedures included translation and cultural adaptation in accordance with International Test Commission guidelines, administration at two time points with a two-week interval, and examination of internal consistency, test–retest reliability, factor structure, and convergent validity. The findings indicated that both YP-CORE and RSES demonstrated good internal consistency and high temporal stability, while most ISI-5 subscales showed satisfactory reliability. Correlations among the instruments were consistent with theoretical expectations: psychological distress was negatively associated with self-esteem and identity commitment, and positively associated with the diffuse-avoidant identity style. Factor analyses generally supported the theoretical structures of the instruments, although several items and subscales require further examination within the Albanian context. The results suggest that the Albanian versions of the YP-CORE, RSES, and ISI-5 represent promising instruments for the assessment of emotional well-being, self-esteem, and identity processes among adolescents. The study contributes to the expansion of the psychometric infrastructure for child and adolescent mental health assessment in Albania and supports the development of culturally responsive assessment practices in educational, clinical, and research settings.

Keywords: *adolescent mental health; psychometric validation; cultural adaptation; psychological assessment; identity styles; self-esteem.*

ETIKA ANTROPOLOGJIKE SIPAS KËNDVËSHTRIMIT TË IMMANUEL KANT NË RAPORT ME BIODIVERSITETIN NATYROR

Silvana AGO

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Etikës dhe Filozofisë

E-mail: silvana.ago@unitir.edu.al

Jetmira FEKOLLI

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Etikës dhe Filozofisë

E-mail: jetmira.fekolli@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky punim trajton marrëdhënien midis filozofisë morale të Immanuel Kant dhe antropologjisë, duke u përqendruar veçanërisht te mbrojtja e kafshëve dhe etika mjedisore. Autorët argumentojnë se, sipas këndvështrimit antropologjik të Kantit, njeriu ka detyrime morale jo vetëm ndaj qenieve racionale, por edhe ndaj qenieve jo-racionale, përfshirë të gjitha speciet e gjalla. Në këtë kuptim, mbrojtja e kafshëve dhe e ekosistemit konsiderohet pjesë e përgjegjësisë morale njerëzore. Punimi thekson se mendimi kantian është kompleks dhe shpesh i vështirë për t'u interpretuar, sidomos në raport me dimensionin psiko-antropologjik të etikës. Megjithatë, filozofia morale e Kantit shihet si një bazë e rëndësishme për zhvillimin e etikës mjedisore moderne dhe për reflektimin mbi mirëqenien e kafshëve, duke mbështetur idenë se dëmtimi i natyrës dhe i qenieve të gjalla bie ndesh me detyrat morale të njeriut.

Fjalë kyçe: *Kant, antropologji, etikë, qenie racionale, ekosistem.*

Dr. **Silvana AGO** është pedagoge dhe studiuese në fushat sociale, veçanërisht në filozofi, sociologji dhe antropologji socio-kulturore. Ajo kontribuon si pedagoge në Universitetin e Tiranës, pranë Departamentit të Filozofisë.

Dr. **Jetmira FEKOLLI** është pedagoge në Universitetin e Tiranës, eksperte në fushën e filozofisë, etikes dhe sociologjisë. Ajo është lektore, autore e shumë artikujve shkencorë, sh dhe pjesëmarrëse në shumë konferenca brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ajo është gjithashtu bashkautore e disa librave në fushën e saj akademike.

Hyrje

Sipas shumë autorëve etika e Kantit ka pikënisje antropocentrike. Filozofë të cilët janë marrë me të, kryesisht me diskursin Kantian mbi gjykimin e tij për qëniet irracionale dhe ato racionale, shpesh here e kane gjykuar për këtë qëndrim. Shumë studiues ndër ta edhe Peter Singer, për shembull, thekson se

Kanti shquhet për një qasje antropocentrike për sa kohë ai vë në lojë qëllimin e kafshëve. Kjo sepse ai përjashton kafshët nga konsiderata e moralit, pra nga ajo që buron direkt nga morali. Nga analizat e bëra deri më tani ne kemi parë që nga Aristoteli e deri tek Kanti shumë studiues i konsiderojnë ata si antropocent - të vendosësh njeriun në qëndër (Singer, 2009: 57).

Marrin shembullin e veprës “Politika” të Aristotelit ku ai thekson se “natyra i ka vendosur të gjitha gjerat në funksion të njeriut” (Aristoteli, [350 B.C.] 1998: 115). Me konceptin “Zoon Politicon” ai sqaron se njeriu është qenie natyraliste politike. Aristoteli jep qartësisht aftësitë e njerëzve për te vepruar siç ai e quan kafshe politike. Kjo e shpjegon më së miri gjykimin mbi antropocentrizmin e tij.

Koncepti “antropocent” shpesh herë merret në konotacion negativ sepse e vendos dijetarin në pozitë e një (*non human*). Një nga thëniet më të njohura të Kantit është se

Qeniet racionale kanë vullnete sepse janë në gjendje të zgjedhin në bazë të parimeve dhe të vendosin qëllime të siguruara nga arsyeja, në vend që të motivohen tërësisht

nga dëshirat dhe impulset natyrore (Kant, 1997: 147).

Sipas gjykitimit të tij Kanti hodhi themelet e bazës filozofike modern mbi konceptin e qenieve të gjalla dhe sidomos atyre racionale. Sipas tij, vetë njohja na vjen nga arsyeja. Në këtë kontekst Kanti është filozofi që e ndau filozofin në tre segmente:

- a) njohja racionale që ai e quan njohjen “*logjike*”
- b) njohja irracionale që ai e quan “*fizike*” mënyra sesi bota është ndërtuar dhe njohja e trete;
- c) njohja “*etike*” të cilën ai e quante ligjin e lirisë (në Kant, 1997b, pp. 9-50).

Tek shtrira e tij antropologjike ai e konsideron njeriun si qenie e vetme që vepron në botë. Sipas tij njeriu është jo vetëm një objekt natyror (*siç e përcakton biologjia dhe shkencat e tjera të natyrës*) po si një subjekt që përdor arsyen, ndërmjet gjykitimit lirisë dhe gjykitimit moral (Kant, [1798] 2006: 87).

E parë në këtë kontekst ajo që e veçon parimin kantian, ndoshta edhe në ndryshim me klasikët e tjerë dhe sidomos Aristotelin, është qasja e tij me pragmatizmin, duket sikur Kant ndryshe nga Aristoteli e vendos antropologjinë larg biologjisë, dhe këtu kemi parasysh Aristotelin e që individin e quan njeriun një (Zoon -politicon), antropologjia kantiane ka thelb individin si qenie tërësisht racionale, morale që vepron në botë. Për Kantin antropologjia është pragmatiste, kjo është edhe arsye pse ai cilësohet si antropocent në gjykimin e tij sepse ai vendos njerëzit mbi çdo qenie tjetër. (Kant, 2006: 92).

Ekspozimi i Kantit sipas “formulës së njerëzimit” “i përmendur ne tekstin “Groundwork of the Metaphysics of Morals” që lidhet me **imperativin kategorik** “Vepronë mënyrë të tillë që ti trajtosh njerëzit si në personin tënd edhe tjetrit si qëllimi dhe kurrë si mjet” (Kanti, 2002: 45-89).

Në këtë diskurs ai i dallon personat (qeniet racionale të konsideruara si qëllime në vetvete, domethënë si diçka që nuk mund të përdoret thjesht si mjet) nga gjërat, të cilat, thotë ai, “*kanë vetëm një vlerë relative*” (Kanti, 2002, pp. 45-89). Duke u nisur nga vet gjykimit të tij vetë njerëzit janë qenie të cilat e krijojnë vet gjykimin e tyre, ato kanë domenin e tyre të gjykimit, dhe sipas tij logjika është domeni i arsyes së pastër, prandaj Kanti e ngre gjykimin njerëzore midis fizikes dhe etike. Pikërisht ky gjykim është ai që i bën njerëzit njerëz dhe jo kafshët.

Përveç kësaj, Kanti thotë se në “Doktrinën e Virtytit” qeniet njerëzore kanë detyra në lidhje me qeniet joracionale, është detyra indirekte në lidhje me natyrën dhe qeniet joracionale” (në: Kanti, 2002, pp. 45-89).

Sipas Sarkar (2024) ai thekson se: “sipas gjykimit kantian qeniet njerëzore nuk kanë detyra të drejt për drejta ndaj bimëve dhe kafshëve për sa kohë ata nuk janë qenie racionale për këtë arsye nuk kanë qëllime ne vetvete” (Sarkar, 2024, pp. 132-141).

Sarkar 2024 sqaron se kjo do të thotë se koncepti i tij për detyrat indirekte kontribuon në etikën mjedisore sepse të paktën ai justifikon kafshët mirëqenien dhe mbrojtjen e mjedisit. Njeriu është i pajisur me ndjeshmëri, dhembshuri, dashamirësi çka do të thotë ai duhet ta mbroj aktivitetin njerëzore, veprimtaria njerëzore nuk sjell gjë tjetër veçse ruajtjen e tyre jo sepse ato

janë kafshë dhe bimë por sepse nuk duhet të cenojnë integritetin e tyre moral (Sarkar, 2024, pp. 132-141).

Natyra racionale si qëllim në vetvete sipas gjykimit Kantian

Për të kuptuar rrëfimin e Kantit për vlerën e natyrës dhe të qenieve racionale, duhet të shqyrtojmë dy koncepte të rëndësishme që shfaqen si në Groundwork (GMS) ashtu edhe në Metafizikën e Moralit (MS), domethënë, “vullnet” dhe “fund”. Sipas gjykimit të Kantit çdo element që të zëvendësohet ka një çmim, sipas konceptit të tij asgjë nuk e zëvendëson njeriun (Kant, 1997, pp. 119-128).¹

Kanti thotë se:” Gjithçka në natyrë funksionon sipas ligjeve, por është vetëm në dorën e qenies njerëzore të komandoje ligjësinë pra “vetëm një qenie racionale ka aftësinë të veprojë në përputhje me përfaqësimin e ligjeve, domethënë në përputhje me parimet, ose ka vullnet. Meqenëse arsyeja kërkohet për nxjerrjen e veprimeve nga ligjet, vullneti nuk është gjë tjetër veçse arsye praktike. Domethënë, sipas kategorizimit kantian vetëm vullneti është ai i cili na çon në një drejtim të ri nëpërmjet arsyes, vetëm qenia njerëzore e ka vullnetin racionale për ta bërë këtë. Sipas tij meqenëse arsyeja nevojitet për të nxjerrë veprime nga ligji vullneti nuk është gjë tjetër veçse arsye praktike (Kant, 2012 pp. 119-128).

Në këtë këndvështrim sipas tij kafshët ndjekin dëshirat e tyre tërësisht instiktive dhe prirjet e tyre për të ngrënë, për të shmangur dëmtimet dhe për t’u riprodhuar. Bimët nuk kanë një sistem nervor dhe përgjigjet e tyre ndaj stimujve si drita ose prekja janë të ngadalta. Por as kafshët dhe as bimët nuk janë në gjendje të

¹ Po aty Kant na shpjegon mbi konceptin dhe rëndësinë që ka njohja njerëzore mbi aftësinë e tij për të vepruar ne përputhje me përfaqësimin e ligjeve.

veprojnë në bazë të arsyes. Kanti shpjegon pse vullneti duhet të përcaktohet nga një fund: Vullneti konsiderohet si një aftësi për të përcaktuar veten për të vepruar në përputhje me përfaqësimin e ligjeve të caktuara. Një kapacitet i tillë mund të gjendet vetëm te qeniet racionale. Tani, ajo që i shërben vullnetit si bazë objektive e vetëvendosjes së tij është një përfundim (Zweck) qëllim, dhe kjo, nëse jepet. E thënë më në mënyrë eksplicite sipas autorit *Zweck* nuk është thjesht një synim empirik por një qëllim objektiv, në këtë kontekst sipas parimit kantian njohja është kryesisht objektive, sepse bazohet në qeniet racionale dhe subjektive sepse bazohet tek përvoja e jetuar (Kant, 1996).

Në hyrje të "*Doktrinës së Virtytit*", Kanti shprehet se gjithmonë ka një raport midis asaj që ai e quan "Zweck" qëllimin e vullnetit të lirë dhe atë që ai e quan "Etika",

e cila na siguron një çështje (një objekt zgjedhjeje të lirë), pra një qëllim të arsyes së pastër të cilën ajo e përfaqëson si një qëllim që është gjithashtu objektivisht i nevojshëm, d.m.th. një fund që, për sa i përket qenieve njerëzore, është detyrë ta kemi" (Sarkar, 2024: 135).

Fundi është pra, një objekt i zgjedhjes së lirë, dhe përfaqësimi i tij e përcakton atë si një veprim. Çka do të thotë që fundi në vetvete është një vullnet, pra nuk është një ide abstrakte por një vendim i marrë nga arsyeja i cili në fund bëhet një liri veprimi.²

Sipas Christine Korsgaard (1996) çdo veprim ka fundin e tij dhe ky nuk duhet të jetë një akt i natyrës, por një veprim i lirë i agjentit. Për autorin kjo do të thotë që qëllimet morale nuk janë thjesht normative. E nisur në këtë këndvështrim sipas autores

gjykimi kantian nuk mbështetet vetëm tek subjekti por tek përsosmëria e tij.

Sipas Allen Wood (2008) gjykimi kantian ngjason me humanizmin etik, ku nuk do të thotë që virtyti është sentimentalist por ai është një formë kërkesë respektin për individin si qëllim në vetvete këtë këndvështrim duhet të ketë një fund të tillë dhe një imperativ kategorik që i përgjigjet atij dhe parimit etik në humanizmin kantian. Kjo do të thotë se qëllimet që janë njëkohësisht detyra, përkatësisht përsosja e dikujt dhe lumturia e të tjerëve, nuk janë krijuar nga impulset e ndjeshme të natyrës njerëzore, por nga vullneti i lirë i një individi.

Raporti midis arsyes njerëzore dhe iracionalitetit të kafshëve

Siç pamë më sipër, raporti midis arsyes njerëzore dhe vullneti i një qenieje racionale drejtohet gjithmonë drejt një qëllimi që ai i jep vetes. Pra e thënë edhe më qarte individi me arsye ka objektiva të qarta mbi qëllimet e tija. Pasi kemi sqaruar lidhjen e vullnetit me qëllimin e arsyes së pastër, tani mund të analizojmë siç duhet vlerën e natyrës dhe të kafshëve joracionale. Në këtë mënyrë, Kanti argumenton se qëllimi si parim objektiv do të jetë natyra racionale:

Tani them se qenia njerëzore dhe në përgjithësi çdo qenie racionale ekziston si qëllim në vetvete, jo thjesht si një mjet për t'u përdorur nga kjo sipas gjykimit të tij; përkundrazi, në të gjitha veprimet e tij duhet të konsiderohet gjithmonë në të njëjtën kohë si një fund (Kant, 2012: 93).

Kjo nënkupton, sipas tij, se çdo qenie njerëzore ka një vlerë në vetvete pra njeriu

² Raporti liri -vullnet i Immanuel Kant. Këtu kemi një pikë shumë të rëndësishme për *kuptimin e fundit* (Zweck) në raport me Willkür-in - *zgjedhjen e lirë*.

nuk duhet trajtuar kurrë si mjet por si një qëllim. Kanti i jep rëndësi vlerës që ka njeriu duke e përjashtuar nga konteksti i instrumentalizimit.

Pas këtij fragmenti, Kanti paraqet dallimin midis personave dhe sendeve:

qeniet, ekzistenca e të cilave nuk mbështetet në vullnetin tonë, por në natyrën, nëse janë qenie pa arsye, prapëseprapë kanë vetëm një vlerë relative, si mjet, dhe për këtë arsye quhen sende, ndërsa qeniet racionale quhen persona sepse natyra e tyre tashmë i dallon, si një qëllim në vetvete, domethënë si diçka që mund të mos përdoret thjesht si mjet, dhe kështu kufizon deri tani çdo zgjedhje (dhe është objekt respekti. Pra e thënë në mënyrë me filozofike por edhe në kontekstin antropologjik këndvështrimi i tij është fakti që ai nuk e sheh kurrë njeriun si një qenie biologjike por më shumë se kaq ai e sheh atë si një qenie racionale dhe autonome, si një qenie që i vendos vetes qëllime dhe si një subjekt që është i afte të marri detyrat (Kant, 1996: 47).

Në “Kritikën e arsyes praktike” Kanti vëren se respekti u drejtohet gjithmonë vetëm personave, dhe kurrë sendeve apo gjallesave të tjera pra diskursi kantina mbështet mbi parimi që arsyeja ju përket vetëm qenieve racionale pra njerëzve. Në raportin midis njerëzve dhe kafshëve ai thekson, në thelb, se këto të fundit mund të na zgjojnë prirjen, madje edhe dashurinë (p.sh., kuajt, qentë e kështu me radhë). Ose edhe frikën. Sikurse deti apo vullkanet, atë e krijon edhe një bishë grabitqare.³ Atëherë, natyra racionale duhet të shërbejë si kusht kufizues i të gjitha qëllimeve relative dhe arbitrare. Me fjalë të tjera, ky kusht kufizues mund

të përkthehet si detyrë për të mos trajtuar njerëzimin si një mjet të thjeshtë. Kjo është shprehur më qartë në “Metafizika e Moralit” (*Metaphysics of Morals*, botimi origjinal i Kantit i vitit 1797, tek i cili ai i jep rëndësi qëllimit përfundimtar njerëzor si qenie dhe kurrë si mjet). Kanti vetë e ka quajtur atë “Formula e Njerëzimit”. Pra, veproni që të përdorni njeriun, qoftë personin tuaj apo këdo tjetër gjithmonë si një qëllim. Asnjëherë thjesht si një mjet (Kant, 1997: 240).

Sipas Kantit, të gjitha qeniet racionale qëndrojnë nën ligjin që secila prej tyre duhet të trajtojë veten dhe të gjithë të tjerët si një qëllim dhe asnjëherë thjesht si një mjet. Por gjithmonë në të njëjtën kohë si qëllim në vetvete. Sipas këtij këndvështrimi kemi një bashkim sistematik të qenieve racionale nëpërmjet ligjeve të përbashkëta objektive. Pra një mbretëri, apo ligjësi, të vendosur nga vetë qenia antropologjike dhe jo thjesht biologjike (Kant, 1997). Qasja kantiane në këtë rast mbështet mbi faktin se *njeriu prej natyrës është biologjike por ai është edhe një konstrukcion antropologjik*. Ai nuk është vetëm qenie që riprodhon, por është një qenie e cila projekton, merr pushtet dhe udhëheq. Njeriu krijon norma kulturore dhe vendos hierarki gjinore dhe hierarki lloji të gjallesave të tjera (Kani, 2006).

Dinjteti njerëzor si vlerë absolute përballë interpretimeve natyraliste të etikës kantiane

Këndvështrimi kantian është interesant në kontekstin e tij sepse ai bën edhe një ndarje në pozicioni e njerëzve tek qëllimet dhe funksionet që ata kanë në botën e

³ Sipas parimit Kantian qeniet njerëzore janë ato që komandojnë gjallesat e tjera: çdo veprimi është i drejtuar nga njeriu, përmes arsyes.

qëllimeve. Në mbretërinë e qëllimeve, pra në një bashkësi ku të gjithë njerëzit trajtohen si qëllim, çdo gjë ka një çmim ose një dinjitet, të cilin Autman (2011: 68) e shpreh kështu:

ajo që ka një çmim mund të zëvendësohet me diçka tjetër si ekuivalentin e saj, çfarë nga ana tjetër është ngritur mbi çdo çmim dhe për këtë arsye nuk pranon se asnjë ekuivalent nuk ka një dinjitet.

Por ajo që përbën kushtin nën të cilin vetëm diçka mund të jetë një qëllim në vetvete nuk ka thjesht një vlerë relative, domethënë një çmim, por një vlerë të brendshme, domethënë dinjitet. Tani, morali është kushti kur vetëm një qenie racionale mund të jetë qëllim në vetvete, pasi vetëm përmes kësaj është e mundur të jesh një anëtar ligjvënës në mbretërinë e qëllimeve. Prandaj, morali, dhe njerëzimi për aq sa është i aftë për moral, është ai që ka dinjitet vetëm.

Natyra racionale duhet trajtuar si qëllim në vetvete, sepse ajo ka dinjitet. Megjithatë, interpretimet e fundit natyraliste të filozofisë së Kantit mund të sjellin njohuri të reja mbi këtë çështje. Frederick Rauscher (2015: 192) argumenton se,

në një etikë natyraliste kantiane nuk ka vend për asnjë pronë me vlerë të brendshme dhe se nuk ka asnjë pronë me vlerë reale në mënyrë të pavarur empirike të personat ose objektet në natyrë (intrinsic value).⁴

Sipas kësaj, vlera nuk është një pronë e ndonjë gjëje të pavarur nga agjenti moral, por një renditje e natyrës nga arsyeja. Kështu, një interpretim natyralist i etikës

së bazuar në detyrime të Kantit mund të përputhet me idealizmin moral në vend të realizmit moral. Sipas disa studiuesve të etikës kantiane, pretendimi se mjedisi është vendndodhja e vlerave reale që mbështesin vlerave shoqërore, kjo është e vështirë të vendoset nëse nuk respektohen normat shoqërore (O'Neill, 1997).

Në këtë mënyrë, idealizmi moral i Kantit mund të ofrojë arsye mjaft të forta për të mbrojtur dhe ruajtur mjedisin, duke përfshirë kafshët jo qeniet që ai i quan jo njerëzore. Për shembull, mund të vendosë detyra për mirëqenien e kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit pa angazhime të forta kundrejt tyre.

Më pas është e rëndësishme të shpjegohet se çfarë nënkupton Kanti me natyrë racionale. Në "The Groundwork" Kanti ([1785] 1997a) shprehet se,

vetë natyra racionale dallohet nga pjesa tjetër e natyrës nga kjo nënkupton zgjidhjen apo fundin që njerëzit i japin problemit, se ajo i jep vetes një qëllim për të arritur në një përfundim (mund të shihet edhe Altman, 2011, pp. 88-97).

Detyrat e virtytit, ose detyrat etike, janë ato që nxisin disa qëllime të konfirmuara nga arsyeja, pra detyra që janë njëkohësisht qëllime. Ato janë përsosmëria e dikujt dhe lumturia e të tjerëve. Qëllimi përfundimtar i njeriut është arritja e lumturisë, e cila mund të përfitohet vetëm nëse ai vlerëson normat etiko-sociale. Shumë nga detyrat etike në "Doktrinën e Virtytit" bazohen në mënyrë eksplicite në parimin e njerëzimit. Kjo nënkupton se parimi kantian nuk qëndron tek antropocentrizmi por tek roli që ka njeriu si qenie e veçantë për të

⁴ Sipas "Naturalism and Realism in Kant's Ethics" (Cambridge, 2015) vlera nuk mund të vërtetohet empirikisht nëse nuk studiohen në kontekstin e përgjithshëm moral. Kanti besonte tek vlerat e përbashkëta shoqërore dhe mendonte se individët përfitojnë kur i shohin vlerat shoqërore si normativa të së mirës së përbashkët.

rregulluar botën. Kanti e lidh moralin, si dhe etikën si pjesë të rëndësishme të tij, duke theksuar rëndësisë dhe rolin që ka njeriu në raport me moralin dhe etikën.

Kufijtë e moralit kantian përballë mbrojtjes së natyrës dhe ekosistemit në vetvete

Sipas Kantit, ndarja më themelore midis detyrave etike është midis detyrave ndaj vetes dhe detyrave ndaj të tjerëve. Detyrat ndaj vetes janë ato që kërkohen për shkak të respektit për njerëzimin në personin tonë, pra ajo që na kërkohet ne nga vetvetja, për vet dinjitetin e natyrës që ne kemi si qenie antropologjike (Kanti, 1996).

Si qenie të cilësuar nga konteksti biologjik dhe antropologjik, si dhe si qenie që kanë detyra ndaj të tjerëve, njerëzit kërkojnë fundin e lumturisë së tyre. Ne e respektojmë njerëzimin duke promovuar qëllimet e vendosura nga qeniet racionale, të lidhura me idenë e lumturisë së një personi (Kant, 1997). Detyrat ndaj të tjerëve dallohen, më tej, në *detyra respekti* dhe *detyra dashurisë*. Kanti e lidh detyrën me moralin (etikën njerëzore) i cili ka një qëllim fillestar, mbrojtjen e ekosistemit.

Kanti argumenton se nuk mund të ketë detyra të drejtpërdrejta në lidhje me natyrën në tërësi dhe me qeniet joracionale. Detyrat që ne kemi ndaj ekosistemit, apo edhe ndaj kafshëve, janë detyra indirekte në lidhje me to. Sipas tij, këto detyra janë detyrime ndaj tyre për shkak të një “amfibolie në konceptet morale të reflektimit”, pra një keqkuptim që na bën të ngatërrojmë një “detyrë” ndaj një lidhjeje me qeniet e tjera (Altman, 2011: 120).

Ato mund t’u referohen objekteve të tjera (përveç personave) ose objekteve që janë vërtet persona por mjaft të padukshëm, domethënë atyre që nuk

mund të paraqiten në shqisat e jashtme. Sipas tij, objektet e para (jo njerëzore) mund të jenë thjesht lëndë inorganike (minerale), ose materie e organizuar për riprodhim edhe pse ende pa ndjesi (bimë). Ose edhe pjesa të natyrës të pajisura me ndjesi dhe zgjedhje (kafshët). Kanti në doktrinën e tij mbi “Doctrine of Virtyte” argumenton se nuk ekzistojnë detyra të drejtpërdrejta midis qenieve irracionale apo natyrës, por objekte të natyrës morale. Kjo nënkupton që njeriu prej natyrës së tij e ndjen moralisht se duhet ti përgjigjet nevojave të natyrës nga parimi i moralit (Kanti, 1996). Sipas Kantit nuk është detyra morale në vetvete por refleksioni mbi moralin, ai që e bind njeriun (për nga kultura antropologjike dhe psikologjike) të mbështesin sigurinë mbi qeniet e tjera jo racionale (Kanti, 1996).

Si rezultat diskursi kantian synon të krijojë themele të shëndosha midis objekteve dhe jo objekteve, midis kafshëve dhe organizmave të tjera. Sipas tij, ne nuk kemi detyrime morale, por dëshira morale për t’i mbrojtur ato. Në këtë këndvështrimi, sipas tij, ajo që ka rendësi është trajtimi i vetë subjektit në raport me natyrën dhe qeniet e gjalla. Pra këndvështrimi kantian mbështet mbi argumentin se detyra e individëve është që moralisht të kuptojnë pozicionin e tyre si qenie racionale dhe pastaj të sigurojnë mbrojtjen e natyrës. Po aty Kanti (1996) trajton konceptin “animus destructionis”, që nënkupton moralin nga i cili njeriu nuk duhet të jete faktor shkatërrues ndaj natyrës por përkundrazi një mbrojtës i saj.

Kanti, shpesh here në leksionet e tij të hapura i jepte rëndësi vlerësimi ekologjik të jetës së bimëve dhe i entiteteve natyrore jo të gjalla. Vet sistemi ekologjik, pra ekosistemi mund të ndihmojë në nxitjen e prirjeve që e bëjnë njeriun më të pirur për të përmbushur detyrat e tij ndaj qenieve

njerëzore dhe atyre të bio-diversitetit. Pra ai thekson se agjentët moral pra njerëzit nuk duhet të jenë “spiritus destructionis” shpirtra shkatërrues të qenieve të gjalla. Kjo nënkupton sipas tij se njeri duhet të ketë një vlerë morale të cilës duhet ti mbështetet një vlerë të brendshme për të kultivuar një qasje sa më pozitive ndaj këtyre gjallesave (Kant, 1997).

Kjo, sipas interpretimit të Wood (2008) nevoja për të dashur gjëra të tjera jashtë nesh nuk duhet të jetë egoiste. Dhe se njeriu nuk mund të kënaqet pa pasur një interes specifik, nga pikëpamja morale. Kanti pohon se të mos kujdesesh për shkatërrimin e entiteteve të bukura natyrore është në kundërshtim me parimet e detyrës së një qenieje njerëzore ndaj parimit moral. Të qenit moral përfshin lidhjen me veten dhe me natyrën. Kjo në një mënyrë që nuk është thjesht egoiste. Vlerësimi i florës së bukur dhe entiteteve jo të gjalla kultivon një prirje të ngjashme, pasi në këtë mënyrë njeriu admiron entitetet e bukura, përveç prirjes për t'i shërbyer interesave të veta. Sipas Wood (1998), Kanti thotë se detyra jonë për të çuar përpara përsosmërinë tonë morale kërkon që ne të vlerësojmë dhe ruajmë bukurinë natyrore për hir të saj. Ai thotë gjithashtu se Kanti me sa duket pranon se bukuria natyrore mund të ketë vlerë për hir të saj (dhe jo thjesht si mjet) pa qenë natyrë racionale, në kuptimin e ndonjë qenieje racionale.

Analiza përfundimtare e perspektivës kantiane mbi njeriun dhe ekosistemin

Sipas Kantit, për nga këndvështrimi moral, njerëzit duhet ta shohin njëri-tjetrin si qenie që meritojnë respekt. Kushti bazë është trajtimi i të tjerët si qëllime dhe jo si mjete. Në lidhje me detyrat ndaj qenieve

të gjalla joracionale, Kantit është gjithashtu i prerë: nuk duhet të jemi aspak mizor me kafshët. Nëse jemi, kjo na bën më të pirur për të qenë mizorë edhe me njerëzit. Kanti shkruan, në thelb, se trajtimi i dhunshëm dhe mizor i kafshëve është shumë i kundërt me sjelljen e një qenieje njerëzore ndaj vetvetes. Trajtimi i dhunshëm dhe mizor i kafshëve dobëson apo edhe çrrënjës gradualisht prirjen për marrëdhënie të moralshme me njerëzit e tjerë (shih, Kanti, 2006: 87-95). Kjo nënkupton më së miri se qeniet njerëzore duhet të përmbahen nga trajtimi i dhunshëm dhe mizor i kafshëve. Sepse një trajtim i tillë do të bëjë që njerëzit të dështojnë në detyrat e tyre të drejtpërdrejta ndaj njëri-tjetrit.

A është etika e Kantit antropocentrike?

Antropocentrizmi është pikëpamja se kriteri për të pasur vlerë të qenësishme është të jesh pjesëtar i species “Homo Sapiens” dhe se vetëm qeniet njerëzore janë moralisht të rëndësishme. Ndërsa antiteza, versionet e ndryshme të cilat qëndrojnë kundër antropocentrizmit (raciocentrizmi, sentientizmi, biocentrizmi) përfaqësojnë pikëpamjen se të paktën disa qenie johumane kanë vlerë të qenësishme dhe se mund të përdoren disa kriterë për të vlerësuar se cilët johumanë duhet të jenë moralisht të konsiderueshëm. Sintetizmi është pikëpamja që të gjithë organizmat që kanë gjendje, psikologji, ose përvoja mendore, janë moralisht të konsiderueshme; ndërsa biocentrizmi është pikëpamja që mbështet mendimin se të gjitha gjallesat janë drejtpërdrejt qenie që meritojnë vëmendje përsa kohe i japin rëndësi veprimit qoftë edhe nëpërmjet instinktit.

E parë këto raporte Kanti prek shumë aspekte të botës së gjallë. Pavarësisht se në qendër vendos njeriun, ai nuk mund të konsiderohet një antropocent përderisa ai vendos njeriun në funksion të të gjitha gjallesave.

REFERENCES

- Altman, M. C. (2011). *Kant and applied ethics: The uses and limits of Kant's practical philosophy* (pp. 66–70; 88–97; 120). Wiley-Blackwell.
- Aristotle. ([350 BC] 1998). *Politics*, Hackett Publishing Company.
- Kant, I. ([1785] 1997a). *Groundwork of the metaphysics of morals*, Cambridge University Press.
- Kant, I. ([1785] 2012). *Groundwork of the metaphysics of morals*, Cambridge University Press.
- Kant, I. ([1797] 1996). *The metaphysics of morals* (M. J. Gregor, Trans., p. 47). Cambridge University Press.
- Kant, I. ([1798] 2006). *Anthropology from a pragmatic point of view*, Cambridge University Press.
- Kant, I. ([1798] 2006). *Anthropology from a pragmatic point of view*, Cambridge University Press.
- Kant, I. (1997b). *Lectures on ethics*, Cambridge University Press.
- Kant, I. (2002). *Groundwork for the Metaphysics of Morals*, Yale University Press.
- Korsgaard, C. M. (1996). *Creating the kingdom of ends*. Cambridge University Press.
- Rauscher, F. (2015). “Naturalism and realism in Kant’s ethics”, In A. Reath & J. Timmermann (Eds.), *Kantian ethics* (pp. 189–195; 207–224). Oxford University Press.
- Sarkar, P. K. (2024). “Kantian view on environmental ethics: Some observations”, *Journal of Philosophy and the Life-World*, pp. 132–141.
- Singer, P. (2009). *Animal liberation* (40th anniversary ed., p. 57). HarperCollins.
- Wood, A. W. (2008). *Kantian ethics* (Chapter 2). Cambridge University Press

ABSTRACT

This paper examines the relationship between Immanuel Kant’s moral philosophy and anthropology, with a particular focus on animal protection and environmental ethics. The authors argue that, from Kant’s anthropological perspective, human beings have moral obligations not only toward rational beings but also toward non-rational beings, including all living species. In this sense, the protection of animals and ecosystems is regarded as an integral part of human moral responsibility. The paper emphasizes that Kant’s thought is complex and often difficult to interpret, particularly with regard to the psycho-anthropological dimension of ethics. Nevertheless, Kant’s moral philosophy is viewed as an important foundation for the development of modern environmental ethics and for reflection on animal welfare, supporting the idea that harming nature and living beings is incompatible with humanity’s moral duties.

Keywords: *Kant, anthropology, ethics, rational beings, ecosystem.*

DEMOKRACIA PJESËMARRËSE DHE FUQIZIMI I QYTETARËVE NË PROCESET E POLITIKËBËRJES

Fiona TODHRI

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Punës Sociale dhe Politikës Sociale

E-mail: fiona.todhri@unitir.edu.al

Estela FERKO

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Punës Sociale dhe Politikës Sociale

E-mail: estela.ferko@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky studim analizon përfshirjen qytetare në proceset e hartimit të politikave sociale në nivelin e qeverisjes vendore në Shqipëri, me fokus në bashkitë Patos, Mat dhe Elbasan. Qëllimi kryesor është identifikimi i faktorëve institucionalë, socialë dhe strukturorë që ndikojnë në intensitetin dhe cilësinë e angazhimit qytetar në proceset vendimmarrëse lokale. Hulumtimi mbështetet në një qasje cilësore, duke përdorur intervista gjysmë të strukturuar me 31 pjesëmarrës, kryesisht aktorë kyç të administratës vendore dhe përfaqësues komunitarë, të përzgjedhur përmes kampionimit të qëllimshëm. Gjetjet tregojnë se, megjithëse ekzistojnë mekanizma formalë të konsultimit dhe informimit publik, pjesëmarrja qytetare mbetet e kufizuar dhe shpesh simbolike, pa ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrje. Kjo situatë pasqyron një hendek të qëndrueshëm midis pjesëmarrjes procedurale dhe asaj substanciale. Faktorët kufizues përfshijnë mungesën e besimit institucional, kufizimet socio-ekonomike dhe pabarazitë territoriale, veçanërisht në zonat rurale, të cilat ndikojnë në aksesin dhe efikasitetin e angazhimit qytetar. Duke u mbështetur në teoritë e demokracisë pjesëmarrëse dhe kapitalit social, studimi argumenton se kalimi drejt një modeli më substancial të

angazhimit kërkon forcimin e mekanizmave të dialogut, rritjen e transparencës dhe institucionalizimin e feedback-ut në procesin e politikëbërjes lokale.

Fjalë kyçe: *pjesëmarrja qytetare, politika sociale, qeverisja vendore, transparenca, llogaridhënia.*

Fiona TODHRI është pedagoge në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe ka 22 vjet përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë. Ajo është gjithashtu studiuese në fushat e shkencave sociale dhe shëndetit publik.

Estela FERKO është doktorante në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe ka një përvojë të gjatë në mësimdhënie në fushat e komunikimit dhe politikave sociale.

Hyrje

Demokracia nuk është aq shumë një formë qeverisjeje, sa është një kulturë që i jep shprehje një mënyre demokratike jetese, pa të cilën demokracia politike nuk mund të ekzistojë. Dewey shton se demokracia është një mënyrë jetese e udhëhequr nga një besim funksional në mundësitë e natyrës njerëzore. Pra, ajo nënkupton besim në potencialet e natyrës njerëzore ashtu siç ato shfaqen në çdo qenie njerëzore, pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, prejardhjes dhe familjes, apo pasurisë materiale dhe kulturore. Siç thekson Thomas M. Alexander (2020) në analizat e tij mbi Dewey-n, kjo kuptimësi e demokracisë duhet parë si pjesë e një tradite pragmatiste që e koncepton demokracinë si mënyrë jetese dhe jo thjesht si strukturë institucionale.

Në librin e tij *“Teoria e Demokracisë e Rishikuar”*, Giovanni Sartori (1987) bën një analizë gjithëpërfshirëse të konceptit të demokracisë, duke trajtuar si bazat teorike, ashtu edhe zbatimin praktik të saj. Në këtë vepër, Sartori shqyrton përkufizimet dhe interpretimet e ndryshme të demokracisë, duke vënë në dukje kompleksitetin dhe kontradiktat e saj të brendshme. Ai analizon sfidat e qeverisjes demokratike, si dhe rolin kritik të institucioneve politike në formësimin e sistemeve demokratike. Përmes një analize të detajuar dhe një qasjeje krahasuese, Sartori ofron njohuri mbi mekanizmat që mbështesin ose pengojnë

demokracinë, duke paraqitur në fund një perspektivë të nuancuar mbi mënyrën se si idealet demokratike mund të realizohen në shoqëritë moderne. Në këtë kuadër teorik, edhe ky studim synon t’u qaset këtyre dimensioneve të demokracisë, duke u mbështetur në këtë këndvështrim analitik për të shqyrtuar marrëdhënien ndërmjet pjesëmarrjes qytetare dhe funksionimit të demokracisë në nivel lokal.

Literatura mbi demokracinë empirike dhe shtetin e mirëqenies thekson lidhjen ndërmjet opinionit publik dhe output-it të politikave publike. Autorë si Esping-Andersen (1990), Huber & Stephens (2001), si dhe Pierson (1994) argumentojnë se strukturat institucionale dhe preferencat qytetare ndërveprojnë në mënyrë dinamike, duke ndikuar në zhvillimin dhe konsolidimin e politikave sociale përmes mekanizmave të feedback-ut. Kjo perspektivë teorike është e rëndësishme për këtë studim, pasi ndihmon në analizimin e mënyrës se si pjesëmarrja dhe perceptimet qytetare mund të ndikojnë (ose të mos ndikojnë) në formësimin e politikave sociale në nivel lokal dhe në proceset e vendimmarrjes publike.

Në përgjithësi, vendimmarrjet politike ndodhin brenda mjediseve komplekse sociale, politike dhe administrative, ku duhet të merren në konsideratë aktorë të shumtë, qëllime shpesh kontradiktore dhe llogaritje shumëdimensionale të koston së oportunitetit, si para, gjatë dhe pas marrjes së një vendimi. Duke pasur parasysh gamën e gjerë të problemeve të

mundshme politike, zgjidhjeve, kushteve, pritshmërive dhe sjelljeve të përfshira në procesin e politikëbërjes, dizajni i suksesshëm i politikave përballet me shumë barriera dhe pengesa potenciale, të cilat gjenerojnë një nivel të lartë pasigurie lidhur me realizueshmërinë dhe dëshirueshmërinë e opsioneve të caktuara të politikave krahasuar me alternativa të tjera (Howlett & Migone, 2025).

Në veprën “Ekonomia politike amerikane në perspektivë globale” Harold Wilensky (2002) analizon ndikimin e globalizimit në politikat ekonomike dhe sociale, me theks të veçantë në ndërveprimin midis ndërkombëtarizimit të financave dhe autonomisë së institucioneve monetare, faktorë që kanë ndikuar në rishpërndarjen e kompetencave të shtetit dhe në sfidimin e modeleve tradicionale të shtetit të mirëqenies. Megjithatë, Wilensky argumenton se, pavarësisht presioneve të globalizimit, shteti kombëtar mbetet një aktor qendror në formësimin e politikave publike, kohezionit social dhe identitetit politik. Në këtë kuadër, ai thekson se dallimet ndërmjet vendeve në performancën ekonomike dhe sociale lidhen kryesisht me zgjedhjet institucionale dhe orientimet politike të brendshme, duke sugjeruar ekzistencën e një hapësire reale për politika më të barabarta dhe gjithëpërfshirëse në demokracitë bashkëkohore.

Në vijim të kësaj perspektive, efektiviteti i politikave publike mund të analizohet nga disa këndvështrime, përfshirë kapacitetin e qeverive për të adresuar problemet shoqërore, ekspertizën e vendimmarrësve dhe rolin e shkencave sociale në përmirësimin e rezultateve të politikave. Paralelisht, çështja e kontrollit qytetar ngre pyetje thelbësore mbi mënyrën se si formësohen politikat publike dhe shkallën në të cilën qytetarët ndikojnë në proceset vendimmarrëse. Kjo perspektivë

nxit reflektim mbi funksionimin e institucioneve demokratike, përfshirë mekanizmat elektoralë, si dhe mbi vazhdimësinë e problemeve strukturore si pabarazia, korrupsioni, cilësia e shërbimeve publike dhe llogaridhënia e kufizuar. Në këtë mënyrë, evidentohet kompleksiteti i qeverisjes demokratike dhe hendeku i vazhdueshëm midis mekanizmave formalë të demokracisë dhe rezultateve të saj substanciale.

Në veprën “Procesi i vendimmarrjes: shtatë kategori të analizës funksionale”, Lasswell bën thirrje për një përditësim të kuptimit të procesit të vendimmarrjes së qeverisjes (1956: 1). Lasswell ishte një nga të parët që e trajtoi në mënyrë eksplicite procesin e përgjithshëm të hartimit të politikave publike në terma të “fazave” ose “stadeve”. Ai e përdor këtë term për t’iu referuar një sërë hapash të veçantë dhe të njëpasnjëshëm, të cilët në parim mendohet se zhvillohen në rend kronologjik, nga iniciativa, përmes formulimit dhe vendimmarrjes, deri te vlerësimi dhe përfundimi i politikës. Më konkretisht, Lasswell (1956) dallon atë që ai i quan shtatë “fazat” e “procesit të vendimmarrjes”... Në këtë kuadër, Lasswell integron elementë thelbësorë të shkencës së politikave publike, duke përfshirë kategoritë e vlerave, procesin shoqëror, këndvështrimin analitik dhe orientimin drejt zgjidhjes së problemeve. Në këtë mënyrë, procesi i vendimmarrjes vendoset brenda një sistemi heuristik që ndihmon në ndërtimin e një harte të plotë të problemeve politike dhe alternativave të mundshme të ndërhyrjes.

Carole Pateman, në veprën e tij “Pjesëmarrja dhe teoria demokratike” (1970) argumenton se ekziston një dallim thelbësor midis teorive të demokracisë pjesëmarrëse dhe atyre të demokracisë përfaqësuese, duke theksuar se ideja

e një “teorie klasike” të unifikuar të demokracisë është një mit i riprodhuar në literaturë. Sipas saj, teoritë e demokracisë pjesëmarrëse nuk janë thjesht normative ose preskriptive, por ofrojnë gjithashtu plane konkrete veprimi dhe mekanizma institucionalë për avancimin drejt një sistemi më thellësisht demokratik.

Studiuesit të demokracisë Robert Putnam i njohet autorësia e konceptit kapital social. Ai e koncepton kapitalin social si një të mirë publike që përfshin potencialin për pjesëmarrje, orientimin qytetar dhe nivelin e besimit ndërpersonal të disponueshëm në qytete, rajone apo shtete (Putnam, 1993; Putnam, 2002). Sipas Putnam, kapitali social zhvendoset nga një karakteristikë individuale në një tipar kolektiv, duke u bërë një atribut i matshëm në nivel agregat. Në këtë kuptim, ai përfaqëson një burim shoqëror që karakterizon kulturën politike të shoqërive moderne dhe lidhet drejtpërdrejt me nivelin e besimit dhe bashkëpunimit. Sipas Putnam, kapitali social përbëhet nga elemente të organizimit shoqëror, si rrjetet sociale, normat dhe besimi, të cilat lehtësojnë veprimin kolektiv dhe bashkëpunimin për përfitim të ndërsjellë (Putnam, 1993: 35). Kjo qasje e vendos kapitalin social në nivelin e strukturave kolektive, duke theksuar se ai nuk është thjesht një atribut individual, por një karakteristikë e organizimit shoqëror që ndikon në sjelljen e individëve. Në këtë mënyrë, kapitali social bëhet një koncept i matshëm dhe i krahasueshëm ndërmjet qyteteve, rajoneve dhe shteteve, duke reflektuar nivelin e besimit dhe aftësinë për bashkëpunim në një shoqëri të caktuar (Putnam, 1993).

Ky studim synon të analizojë pjesëmarrjen qytetare në proceset e hartimit dhe zbatimit të politikave sociale në nivel lokal në Shqipëri, me fokus në

mënyrën se si perceptimet dhe preferencat e qytetarëve artikuloohen dhe integrohen në vendimmarrjen publike. Duke u bazuar në një qasje krahasuese ndërmjet tre njësive të qeverisjes vendore—Patos, Mat dhe Elbasan—kërkimi identifikon hendekun midis pjesëmarrjes formale dhe ndikimit substancial, si dhe shqyrton faktorët institucionalë, socialë dhe strukturorë që ndikojnë në këtë dinamikë. Në vijim të literaturës mbi demokracinë pjesëmarrëse dhe përgjegjshmërinë institucionale, studimi e koncepton politikëbërjen si një proces dinamik dhe ndërveprues, ku qytetarët nuk janë vetëm përfitues të politikave publike, por edhe aktorë potencialë në formësimin e tyre. Në këtë kuadër, pjesëmarrja kuptimplotë konsiderohet një element thelbësor që ndikon si në efektivitetin e politikave sociale, ashtu edhe në cilësinë e qeverisjes demokratike në nivel lokal.

Metodologjia e Studimit

Studim u mbështetet në një qasje kërkimore cilësore, e cila është veçanërisht e përshtatshme për eksplorimin dhe interpretimin e thelluar të fenomeneve komplekse sociale, sidomos të ndërveprimit ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve publike në kontekstin e qeverisjes vendore. Në përputhje me epistemologjinë konstruktiviste, qasja cilësore mundëson analizimin e mënyrës se si individët i japin kuptim përvojave të tyre dhe se si këto kuptime formësojnë perceptimet mbi pjesëmarrjen në proceset e politikëbërjes (Creswell, 2014; Kvale & Brinkmann, 2009). Strategjia metodologjike synon të analizojë si dimensionet strukturore, ashtu edhe ato kulturore të pjesëmarrjes qytetare, me fokus të veçantë në mënyrën se si qytetarët perceptojnë, përjetojnë dhe vlerësojnë përfshirjen e tyre në hartimin

dhe zbatimin e politikave sociale në nivel lokal. Në këtë kuptim, pjesëmarrja trajtohet jo vetëm si mekanizëm institucional, por edhe si proces shoqëror i ndërtuar përmes ndërveprimit, besimit dhe praktikave të komunikimit.

Studimi përdor dizajnin e studimit të shumëfishtë të rasteve (multiple case study), në përputhje me qasjen analitike të Yin (2018), i cili mundëson një analizë të thelluar, krahasuese dhe të ndjeshme ndaj kontekstit të proceseve reale të qeverisjes në mjedise të ndryshme. Rastet e mara në bashkitë Patos, Mat dhe Elbasan, janë zgjedhur me qëllim për të siguruar variacion në kontekstet socio-institucionale dhe për të mundësuar përgjithësim analitik, dhe jo statistikor. Mbledhja e të dhënave fokusohet te aktorët kryesorë institucionalë, përfshirë zyrtarë të qeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë relevantë të përfshirë në komunikimin dhe zbatimin e politikave publike. Vëmendje e veçantë i kushtohet mekanizmave të komunikimit dhe modeleve të ndërveprimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve, përfshirë kanalet formale dhe joformale të angazhimit. Në tërësi, kjo qasje metodologjike mundëson një kuptim të plotë të pjesëmarrjes qytetare si një proces dinamik, shumëaktorësh dhe të formësuar nga ndërveprimi institucional, praktikat e komunikimit dhe faktorët kontekstualë lokalë.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë pjesëmarrjen qytetare në proceset e hartimit dhe zbatimit të politikave sociale në nivel lokal në Shqipëri, me fokus të veçantë në bashkitë Patos, Mat dhe Elbasan. Studimi synon të kuptojë mënyrën se si qytetarët përfshihen në proceset e qeverisjes vendore dhe se si kjo pjesëmarrje reflektohet në praktikat e politikëbërjes.

Objektivat e këtij studimi janë identifikimi dhe analiza kritike e faktorëve nxitës dhe kufizues që formësojnë angazhimin qytetar si formë e pjesëmarrjes demokratike në nivel lokal. Në veçanti, studimi synon të shqyrtojë mënyrën se si këta faktorë ndikojnë në proceset vendimmarrëse dhe në cilësinë e ndërveprimit ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve publike. Gjithashtu, synohet të vlerësohet në çfarë mase pjesëmarrja qytetare kontribuon në krijimin e një qeverisjeje më të përgjegjshme, transparente dhe gjithëpërfshirëse në nivel vendor.

Dizajni i Studimit

Intervistat gjysmë të strukturuar

Instrumenti i intervistës gjysmë të strukturuar u zhvillua mbi bazën e një rishikimi të thelluar të literaturës përkatëse, duke u mbështetur në studime empirike dhe burime ndërkombëtare për të siguruar përputhshmëri me standardet e kërkimit cilësor (Creswell, 2014; Kvale & Brinkmann, 2009). Ai u konceptua si një instrument fleksibel, por njëkohësisht i strukturuar, i dizajnuar për të mundësuar mbledhjen e të dhënave të pasura cilësore përmes eksplorimit të perceptimeve dhe përvojave të pjesëmarrësve. Udhëzuesi i intervistës u organizua në pesë dimensione kryesore: përfaqësimi qytetar, transparenca dhe llogaridhënia, bashkëpunimi ndërinstitutional dhe me shoqërinë civile, analiza dhe shkëmbimi i njohurive, si dhe zbatimi dhe vlerësimi i politikave publike. Përpara mbledhjes së të dhënave, instrumenti iu nënshtrua një procesi pilotimi me pjesëmarrës me karakteristika të ngjashme me kampionin final, me qëllim vlerësimin e qartësisë, koherencës dhe përshtatshmërisë së pyetjeve; rezultatet e pilotimit çuan në rishikime të formulimeve dhe përmirësim

të strukturës së instrumentit. Vlefshmëria u siguroa përmes vlefshmërisë përmbajtësore (content validity), duke garantuar përputhje të plotë me dimensionet teorike të pjesëmarrjes qytetare dhe qeverisjes lokale, ndërsa besueshmëria u forcua përmes përdorimit të një protokollit të standardizuar intervistimi dhe aplikimit konsistent të udhëzuesit në të gjitha rastet. Rigoroziteti interpretativ u mbështet gjithashtu nga dokumentimi sistematik i procesit kërkimor (audit trail), duke rritur transparencën dhe gjurmueshmërinë e analizës. Në përputhje me parimet e reflektivitetit në kërkimin cilësor, studiuesi ka reflektuar vazhdimisht mbi pozicionin e tij/saj gjatë procesit të intervistimit dhe interpretimit të të dhënave, me qëllim minimizimin e ndikimit të paragjykimëve subjektive dhe forcimin e kredibilitetit analitik të gjetjeve.

Metodat e kampionimit

Në kërkimin cilësor, strategjitë e kampionimit klasifikohen në kampionim probabilitar dhe joprobabilitar. Sipas literaturës metodologjike (Creswell, 2014; Bryman, 2016), zgjedhja e strategjisë së kampionimit përcaktohet nga objektivat e kërkimit, pozicioni epistemologjik dhe natyra interpretative e fenomenit të

studiuar. Ndërsa kampionimi probabilitar përdoret kryesisht në kërkime sasiore për të mundësuar përgjithësim statistikor, kërkimi cilësor synon kuptim të thelluar, interpretim kontekstual dhe analizë të proceseve sociale. Në këtë kuadër, kampionimi i qëllimshëm (purposive sampling) është strategjia kryesore e përdorur në këtë studim, në përputhje me logjikën e studimit të rastit (case study), ku qëllimi është kuptimi i thelluar i fenomenit dhe jo përgjithësimi statistikor (Creswell & Poth, 2018; Yin, 2018). Përzgjedhja e pjesëmarrësve u bazua në këto kritere: (1) njohuri të avancuara mbi kontekstin lokal të qeverisjes; (2) njohje të strukturave institucionale dhe proceseve vendimmarrëse; (3) kuptim të dinamikave socio-ekonomike lokale; (4) përvojë në hartimin dhe/ose zbatimin e politikave sociale; dhe (5) përfshirje në ndërveprime institucionale dhe komunitare në nivel bashkie. Këto kritere synuan identifikimin e informantëve kyç (key informants) të aftë për të ofruar të dhëna të pasura, relevante dhe analitike të vlefshme. Në përputhje me qasjen e Patton (2015), kampionimi u orientua drejt përzgjedhjes së rasteve informacion-bërëse (information-rich cases), ndërsa u ruajt edhe variacioni ndërmjet roleve institucionale për të siguruar diversitet perspektivash dhe

Tabela: *Kategoritë e të intervistuarve*

Kategoria e të intervistuarve	Përshkrimi
Drejtorë të strukturave administrative	Persona përgjegjës për drejtimin e drejtorive në nivel bashkie
Specialistë	Punonjës të administratës publike me detyra teknike dhe profesionale
Anëtarë të këshillit bashkiak	Përfaqësues të zgjedhur në organin vendimmarrës lokal
Përfaqësues të komunitetit	Individë që përfaqësojnë interesat dhe zërin e komunitetit lokal
Organizata jo-fitimprurëse	Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile të përfshira në çështje sociale dhe komunitare

për të forcuar triangulimin analitik. Kjo qasje është konsistente me parimet e rigorozitetit në kërkimin cilësor, ku theksi vendoset mbi thellësinë e të dhënave dhe jo mbi përfaqësimin statistikor. Në total, studimi përfshiu **31 pjesëmarrës**, të përzgjedhur nga njësitë e qeverisjes vendore në bashkitë Patos (10), Mat (10) dhe Elbasan (11), duke mundësuar një analizë krahasuese ndërkontekstuale të praktikave të pjesëmarrjes qytetare.

Gjetjet e studimit

Nga pjesëmarrja formale drejt pjesëmarrjes substanciale

“Pjesëmarrja qytetare kërkon hapa shtesë për të informuar qytetarët, pasi përpjekjet aktuale nuk kanë qenë të mjaftueshme; ajo mbetet ende në nivele të ulëta.”

Bazuar në intervistat e zhvilluara me informatorë kyç në tre bashkitë e përzgjedhura, kryesisht zyrtarë të qeverisjes vendore, gjetjet tregojnë se, në nivel formal, ekzistojnë përpjekje të vazhdueshme për të informuar qytetarët përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit mbi çështje që lidhen me interesat e tyre. Institucionet përdorin kanale të ndryshme të njoftimit publik, duke demonstruar një angazhim procedural ndaj transparencës. Megjithatë, në lidhje me përfshirjen e qytetarëve, një çështje kryesore mbetet niveli i ulët i interesit publik, i cili lidhet ngushtë me mënyrën se si institucionet angazhohen me komunitetin. Proceset e informimit dhe konsultimit iniciohen nga Kryetari i Bashkisë, ndërsa konsultimet publike drejtohen nga Këshilli Bashkiak, i cili ka rol mbikëqyrës dhe vendimmarrës në këtë proces. Megjithatë, pavarësisht se mekanizmat formalë të informimit dhe konsultimit janë të mirëstrukturuar në

nivel procedural, mbetet për t'u vlerësuar nëse këto procedura përkthehen në një ndikim real dhe të drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Të dhënat cilësore tregojnë se një sfidë e vazhdueshme është niveli i ulët i angazhimit qytetar, duke evidentuar një hendek midis instrumenteve formale të pjesëmarrjes dhe zhvillimit të një kulture aktive të përfshirjes komunitare. Në këtë kontekst, pjesëmarrja qytetare në Bashkinë e Patosit karakterizohet nga ekzistenca e mekanizmave formalë të informimit dhe konsultimit, por përballet me angazhim të kufizuar, veçanërisht në zonat urbane.

“Arsyet kryesore që lidhen me mos-pjesëmarrjen në dëgjuesat publike ose konsultimet janë, ndër të tjera, niveli i informacionit dhe ndërgjegjësisimit të qytetarëve.”

Një tjetër pretendim i ngritur nga stafi bashkiak lidhet me nivelin e ulët të ndërgjegjësisimit qytetar dhe mungesën e angazhimit, shpesh i atribuar mungesës së përgjegjësisë qytetare. Në këtë kontekst, referimi ndaj “nivelit intelektual” si arsye për mos-pjesëmarrje kërkon një interpretim më të kujdesshëm dhe kritik, pasi rrezikon ta reduktojë një fenomen kompleks në një shpjegim individualist. Nga një perspektivë teorike, pjesëmarrja qytetare lidhet ngushtë me konceptin e kapitalit social, ku rrjetet sociale, besimi dhe normat e bashkëpunimit ndikojnë drejtpërdrejt në nivelet e angazhimit qytetar. Kështu, pjesëmarrja e ulët nuk mund të shpjegohet vetëm nga karakteristikat individuale, por edhe nga mungesa e kushteve strukturore që nxisin ndërveprimin dhe besimin institucional. Për më tepër, sipas teorive të angazhimit qytetar, pjesëmarrja ndikohet nga një sërë faktorësh, përfshirë burimet individuale si koha, arsimi dhe të ardhurat,

si dhe niveli i mobilizimit institucional dhe mundësitë e krijuara për përfshirje. Kjo nënkupton se mungesa e pjesëmarrjes nuk duhet të interpretohet thjesht si “mungesë vullneti” nga qytetarët, por si produkt i një ndërveprimi kompleks midis faktorëve strukturorë dhe institucionalë. Ky kuadër teorik reflektohet qartë në rastin e Bashkisë së Matit, ku pjesëmarrja qytetare ndikohet ndjeshëm nga obligimet e përditshme dhe prioritetet socio-ekonomike, duke e vendosur përfshirjen publike në një pozicion dytësor. Në këtë kontekst, përpjekjet e bashkisë për të përdorur metoda të komunikimit të drejtpërdrejtë, si kontaktet derë më derë, përfaqësojnë një qasje proaktive për të tejkaluar këto barrierë dhe për t’i afruar institucionet me komunitetin. Në këtë drejtim, çështja e besimit institucional dhe transparencës shfaqet si një nga sfidat më kritike. Megjithatë proceset e konsultimit janë të strukturuar dhe funksionale, mungon një mekanizëm i qartë dhe i qëndrueshëm i feedback-ut ndaj qytetarëve. Qytetarët shpesh shprehin shqetësimet e tyre, por nuk marrin përgjigje të qarta mbi rezultatin e kërkesave të tyre. Kjo krijon një ndjenjë dekurajimi dhe ul motivimin për pjesëmarrje të ardhshme.

“Pjesëmarrja qytetare ndikohet nga faktorë si niveli i ulët arsimor dhe njohuritë e kufizuara mbi legjislacionin, të cilat kufizojnë aftësinë e qytetarëve për t’u angazhuar efektivisht në proceset vendimmarrëse.”

Arsyet e identifikuara për pjesëmarrje të ulët—obligimet e përditshme dhe indiferenca—tregojnë një kombinim të faktorëve strukturorë dhe kulturorë. Nga njëra anë, qytetarët përballen me kufizime kohore dhe prioritetet ekonomike; nga ana tjetër, ekziston një distancë emocionale

dhe e besimit ndaj proceseve publike, e shprehur si indiferencë. Ky aspekt i fundit është veçanërisht i rëndësishëm, pasi tregon mungesë të perceptimit të ndikimit në vendimmarrje. Një nga faktorët kryesorë ndikues është dimensionin social dhe kulturor. Nga njëra anë, vërehet mungesë interesi dhe pjesëmarrje aktive të disa qytetarë, e lidhur me nivelin arsimor dhe njohuritë e kufizuara mbi legjislacionin. Nga ana tjetër, përmendet edhe elementi i “mentalitetit”, i cili mund të interpretohet si trashëgimi e një kulture të kufizuar të angazhimit qytetar dhe një perceptim i ulët i vetë-efikasitetit në raport me institucionet publike.

“Pavarësisht përpjekjeve për njoftim dhe organizim, pjesëmarrja mbetet e ulët, duke reflektuar mungesën e pjesëmarrjes ‘të vërtetë’. Kjo lidhet me faktin se procesi i pjesëmarrjes perceptohet më shumë si proces politik, gjë që ndikon në nivelin e besimit të qytetarëve.”

Në të njëjtën kohë, bashkitë kanë ndërmarrë përpjekje konkrete për të adresuar këtë hendek përmes strategjive të ndryshme të informimit dhe ndërgjegjësimit, përfshirë komunikimin derë më derë. Kjo qasje përputhet me modelet e “qeverisjes së afërt me qytetarin” (governance outreach), ku administrata publike nuk pret pjesëmarrjen, por e nxit atë duke iu afruar fizikisht dhe socialisht komuniteteve. Praktika të tilla kontribuojnë pozitivisht në ndërtimin e besimit institucional, i cili sipas literaturës është një parakusht kyç për rritjen e pjesëmarrjes qytetare. Sa më i lartë niveli i besimit në institucione, aq më e madhe është gjasat që qytetarët të angazhohen në proceset publike. Në përfundim, analiza sugjeron se interpretimet që lidhin mos-pjesëmarrjen vetëm me faktorë individualë janë të pamjaftueshme. Një

qasje më e balancuar duhet të marrë parasysh ndërveprimin midis faktorëve individualë, strukturorë dhe institucionalë, duke vendosur përgjegjësinë për rritjen e pjesëmarrjes jo vetëm mbi qytetarët, por edhe mbi institucionet lokale. Faktorë si distanca fizike, struktura urbane, mungesa e ndërmjetësve lokalë dhe dominimi i komunikimit formal institucional kontribuojnë në uljen e nivelit të angazhimit qytetar. Kjo e transformon pjesëmarrjen nga një proces ndërveprues dhe dialogjik në një praktikë kryesisht procedurale, ku qytetarët më shumë informohen sesa përfshihen realisht në vendimmarrje. Nga një perspektivë më e gjerë analitike, ky rast sugjeron se urbanizimi dhe organizimi territorial mund të ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e pjesëmarrjes qytetare, duke kërkuar që institucionet lokale të zhvillojnë mekanizma alternativë ndërmjetësimi dhe komunikimi të përshtatur me specifikat kontekstuale.

Nga konsultimi formal drejt ndikimit real në vendimmarrje

“Pjesëmarrja qytetare kërkon hapja shtesë për informimin e qytetarëve, pasi masat e ndërmarrja deri tani nuk kanë qenë të mjaftueshme; niveli i saj mbetet i ulët. Në zonat rurale, kryepleqtë dhe drejtuesit lokalë luajnë një rol ndërmjetësues në komunikimin me komunitetin. Ndërsa në Patos, struktura të tilla komunitare mungojnë, dhe komunikimi mbështetet kryesisht në organizimin institucional të vetë bashkisë.”

Analiza e të dhënave cilësore tregon se, në nivel institucional, ekzistojnë mekanizma të formalizuar për informimin dhe konsultimin e qytetarëve, përfshirë dëgjesat publike, konsultimet online, takimet e hapura me autoritetet lokale

dhe komunikimin përmes rrjeteve sociale. Këto instrumente përbushin kërkesat procedurale të transparencës dhe krijojnë një kuadër ligjor-administrativ për përfshirjen e publikut në proceset vendimmarrëse. Megjithatë, duke u mbështetur në dallimin midis demokracisë procedurale dhe asaj substanciale, këto gjetje evidentojnë një hendek kritik midis pjesëmarrjes formale dhe pjesëmarrjes me ndikim. Ndërsa pjesëmarrja formale nënkupton ekzistencën e hapësirave konsultative dhe të drejtën për të shprehur opinionet, pjesëmarrja me ndikim nënkupton që kontributet e qytetarëve të integrohen realisht në vendimet përfundimtare.

Gjetjet tregojnë se, megjithëse strukturat pjesëmarrëse janë të mirëpërcaktuara institucionalisht, angazhimi qytetar mbetet i kufizuar, veçanërisht në zonat urbane. Sfida kryesore nuk është vetëm ofrimi i informacionit, por krijimi i një kulture të qëndrueshme dialogu dhe reciprociteti ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve. Mungesa e mekanizmave të strukturuar të feedback-ut, perceptimi i ndikimit të kufizuar dhe distanca institucionale nga komuniteti dobësojnë motivimin për pjesëmarrje. Këto dinamika theksojnë se besimi, rrjetet sociale dhe ndërveprimi reciprok janë parakushte thelbësore për angazhim qytetar efektiv. Në këtë kontekst, kalimi nga një model procedural në një model *deliberativ* të pjesëmarrjes kërkon: (a) forcimin e mekanizmave të llogaridhënies; (b) sigurimin e raportimit sistematik mbi mënyrën se si kontributet e qytetarëve reflektohen në vendime; (c) fuqizimin e strukturave ndërmjetësuese komunitare; dhe (d) zhvillimin e formave të vazhdueshme dhe jo episodike të angazhimit. Këto elemente janë në përputhje me qasjet e qeverisjes deliberative, të cilat theksojnë dialogun e

vazhdueshëm dhe mësimin reciprok midis shtetit dhe shoqërisë.

Një sfidë kryesore e identifikuar nga autoritetet lokale është niveli i lartë i indiferencës qytetare, shpesh i lidhur me mungesën e besimit, perceptimin e ndikimit të kufizuar dhe distancën institucionale. Megjithatë, e interpretuar përmes teorisë së angazhimit qytetar dhe kapitalit social, kjo indiferencë nuk duhet të kuptohet vetëm si apati individuale, por si rezultat strukturor i marrëdhënieve të dobëta të besimit dhe ndërveprimit reciprok midis institucioneve dhe qytetarëve. Një sfidë tjetër lidhet me strategjitë e komunikimit, të cilat nuk janë plotësisht efektive në mobilizimin e grupeve të ndryshme shoqërore, veçanërisht të të rinjve dhe qytetarëve ekonomikisht aktivë. Kjo pasqyron një problem më të gjerë të identifikuar në literaturën mbi qeverisjen pjesëmarrëse: mospërputhjen midis modeleve institucionale të komunikimit dhe realiteteve të përditshme sociale të qytetarëve.

Roli i komunikimit institucional në pjesëmarrjen qytetare

“Për të nxitur pjesëmarrjen qytetare, Bashkia e Matit ka përdorur kanale të ndryshme komunikimi, si mediat lokale dhe rrjetet sociale, duke publikuar në mënyrë të përsëritur njoftime informuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të qytetarëve.”

Komunikimi institucional përfaqëson një nga dimensionet më të rëndësishme në promovimin dhe konsolidimin e pjesëmarrjes qytetare në nivel lokal. Siç evidentohet në rastin e Bashkisë së Matit, institucionet lokale përdorin kanale të ndryshme komunikimi, përfshirë mediat lokale dhe rrjetet sociale, për të publikuar në mënyrë të vazhdueshme

njoftime informuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së qytetarëve. Megjithatë, ky model komunikimi mbetet kryesisht njëdrejtimësh dhe informativ në natyrë dhe nuk garanton domosdoshmërisht angazhim aktiv të komunitetit. Edhe pse kuadri ligjor—veçanërisht Ligji nr. 146 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”—ofron një bazë të fortë për proceset pjesëmarrëse, zbatimi i tij në praktikë përballet me sfida të rëndësishme. Një nga problemet kryesore lidhet me nivelin vazhdimisht të ulët të pjesëmarrjes qytetare, duke sugjeruar se ekzistenca e thjeshtë e mekanizmave formalë nuk është e mjaftueshme për të siguruar përfshirje efektive. Në këtë kontekst, strukturat komunitare dhe nëpunësit administrativë lokalë luajnë një rol ndërmjetësues kyç midis institucioneve dhe qytetarëve. Komunikimi i hershëm, i qartë dhe i vazhdueshëm i objektivave dhe proceseve vendimmarrëse është thelbësor për ndërtimin e besimit dhe rritjen e pjesëmarrjes. Po ashtu, përdorimi i gjuhës së thjeshtë dhe të kuptueshme rrit aksesueshmërinë e informacionit dhe mbështet përfshirjen e grupeve më të gjera shoqërore. Reforma administrativo-territoriale ka zgjeruar ndjeshëm si shtrirjen territoriale ashtu edhe kompetencat e bashkive, duke rritur kompleksitetin e komunikimit institucional dhe nevojën për kapacitete më të forta administrative. Në këtë kuadër, konsultimi publik nuk duhet të trajtohet si një aktivitet i rastësishëm, por si një proces i vazhdueshëm që shoqëron gjithë ciklin e politikave—nga vlerësimi i nevojave deri te zbatimi dhe monitorimi. Megjithatë, si në Bashkinë e Matit ashtu edhe në Bashkinë e Elbasanit, sfidat lidhen jo vetëm me ekzistencën e kanaleve të komunikimit, por edhe me cilësinë, aksesueshmërinë dhe efektivitetin e tyre. Mungesa e informacionit të

thjeshtuar, e formateve të përshtatura të komunikimit dhe e mekanizmave ndërveprues kufizon aftësinë e qytetarëve për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplote. Komunikimi i bazuar kryesisht në njoftime rrit aksesin në informacion, por nuk garanton pjesëmarrje aktive, veçanërisht në mungesë të komunikimit të personalizuar dhe ndërveprimit të drejtpërdrejtë me komunitetin.

“Gjuha e thjeshtuar është një element themelor në përmirësimin e efektivitetit të ndërveprimit midis institucioneve dhe qytetarëve. Përdorimi i një gjuhe të qartë, të kuptueshme dhe të drejtpërdrejtë e bën komunikimin më të aksesueshëm dhe më të kuptueshëm, duke lehtësuar kuptimin publik të informacionit dhe proceseve vendimmarrëse.”

Një dimension i rëndësishëm i komunikimit institucional lidhet gjithashtu me transparencën në politikat fiskale dhe buxhetore. Qytetarët shpesh nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi kufizimet buxhetore apo ndarjen e kompetencave ndërmjet institucioneve, gjë që krijon pritshmëri jorealiste. Në këtë kuadër, komunikimi i qartë, i thjeshtë dhe transparent mbi kapacitetet dhe kufizimet institucionale është thelbësor për forcimin e besimit publik dhe përmirësimin e marrëdhënieve midis qytetarëve dhe institucioneve. Në përfundim, analiza sugjeron se komunikimi institucional është një përcaktues kyç i cilësisë së pjesëmarrjes qytetare. Kalimi nga një model komunikimi informativ drejt një modeli ndërveprues dhe gjithëpërfshirës kërkon jo vetëm përmirësime në mjete dhe kanale, por edhe një rikonceptualizim të marrëdhënieve midis institucioneve dhe qytetarëve, të bazuar në dialog, besim dhe përgjegjësi të përbashkët.

Nga pjesëmarrja formale drejt pjesëmarrjes substanciale: roli i faktorëve mundësues dhe kufizues

“Edhe pse vërehet një nivel i caktuar i pjesëmarrjes dhe interesit nga qytetarët, ndikimi i tyre në proceset vendimmarrëse mbetet i kufizuar. Kërkesat kryesore të qytetarëve lidhen me çështje të infrastrukturës, mundësitë e punësimit dhe përmirësimin e shërbimeve sociale.”

Faktorët kufizues në pjesëmarrjen në vendimmarrje

Faktorët strukturorë luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm. Angazhimet e përditshme, presionet ekonomike dhe pabarazitë territoriale—veçanërisht në zonat rurale—kufizojnë aksesin në hapësirat pjesëmarrëse dhe reduktojnë mundësitë për angazhim të qëndrueshëm. Nga perspektiva e qeverisjes pjesëmarrëse, kjo reflekton pabarazi në aksesin ndaj “strukturave të mundësisë” të nevojshme për përfshirje kuptimplotë qytetare. Për më tepër, barrierat socio-kulturore ndikojnë në mënyrën se si qytetarët artikulojnë nevojat e tyre. Nënraportimi i çështjeve sensitive, si dhuna në familje, reflekton stigmatizimin social, normat kulturore dhe perceptimin e kufizuar të sigurisë në ndërveprimet institucionale. Këto gjetje janë në përputhje me teorinë e angazhimit qytetar, e cila thekson se pjesëmarrja formohet jo vetëm nga dizajni institucional, por edhe nga normat kulturore, identiteti dhe vetë-efikasiteti i perceptuar. Në tërësi, këto gjetje sugjerojnë se, edhe pse ekzistojnë mekanizma formalë të pjesëmarrjes, angazhimi kuptimplotë kërkon adresimin e një kombinimi faktorësh, përfshirë pabarazitë strukturore, deficitin e besimit institucional dhe kufizimet socio-kulturore.

Faktorët mundësues dhe përpjekjet për fuqizim

Nga ana tjetër, të dhënat identifikojnë disa faktorë mundësues që synojnë forcimin e pjesëmarrjes qytetare. Një faktor kyç është përpjekja institucionale për fuqizimin e grupeve të nënpërfaqësuar, veçanërisht grave në zonat rurale, përmes nismave për ndërtimin e kapaciteteve dhe përfshirjes së tyre në buxhetimin me pjesëmarrje. Megjithatë, gjetjet tregojnë një tension kritik midis përfshirjes formale dhe fuqizimit substancial. Edhe pse pjesëmarrja mund të rritet në aspektin sasior, ajo nuk shoqërohet domosdoshmërisht me artikulumin e nevojave specifike për grupe të caktuara. Gratë dhe burrat shpesh shprehin shqetësime të ngjashme bazike, ndërsa çështjet gjinore mbeten kryesisht të paartikuluara. Kjo pasqyron një hendek midis pjesëmarrjes formale dhe fuqizimit substancial, ku përfshirja nuk përkthehet automatikisht në zë apo ndikim.

Mungesa e kërkesave për shërbime si kujdesi për fëmijët e përforcon këtë model. Nga perspektiva socio-kulturore, kjo reflekton vazhdimësinë e roleve tradicionale gjinore, ndërgjegjësimin e kufizuar mbi të drejtat dhe normat e brendësuar shoqërore. Në kuadër të literaturës mbi kapitalin social dhe pjesëmarrjen gjinore, kjo sugjeron se përfshirja strukturore duhet të shoqërohet me strategji të synuara fuqizimi që rrisin ndërgjegjësimin dhe artikulumin e zërit qytetar.

Në këtë kontekst, masa institucionale si zhvendosja e takimeve në hapësira neutrale dhe më të aksesueshme përfaqësojnë praktika të rëndësishme mundësuese. Këto ndërhyrje reduktojnë barrierat fizike dhe simbolike të pjesëmarrjes dhe janë në përputhje me qasjet e qeverisjes gjithëpërfshirëse, të cilat theksojnë aksesueshmërinë, sigurinë

dhe përshtatjen kontekstuale në proceset pjesëmarrëse.

Në përgjithësi, kalimi nga pjesëmarrja formale drejt asaj substancialë formësohet nga ndërveprimi i faktorëve institucionale, strukturorë dhe socio-kulturore. Edhe pse ekzistojnë mekanizma mundësues si nismat për fuqizim dhe praktikrat gjithëpërfshirëse, efektiviteti i tyre kufizohet nga deficitet e besimit, pabarazitë në akses ndaj hapësirave pjesëmarrëse dhe normat kulturore të rrënjësura thellë.

Dimensioni institucional dhe kufizimet e tij

“Në nivel institucional, bashkitë kanë zhvilluar një sistem relativisht të konsoliduar të informimit publik dhe konsultimit të qytetarëve përmes dëgjësive publike dhe përdorimit të mjeteve të ndryshme të komunikimit. Këto përpjekje përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt forcimit të transparencës procedurale dhe pjesëmarrjes formale, duke treguar një konsolidim gradual të praktikave të qeverisjes pjesëmarrëse në nivel lokal.”

Si rezultat, krijohet një pabarazi midis përfshirjes formale dhe ndikimit real. Transparenca është e domosdoshme, por jo e mjaftueshme në mungesë të mekanizmave të feedback-ut, reagimit institucional dhe fuqizimit qytetar përgjatë gjithë ciklit të politikave. Në përgjithësi, reformat institucionale kanë forcuar dimensionin informues të pjesëmarrjes, ndërsa dimensionet deliberative dhe vendimmarrëse mbeten të pazhvilluara. Kalimi nga modeli i “informimit të hapur” drejt një modeli të “qeverisjes ndërvepruese” kërkon krijimin e mekanizmave të strukturuar të feedback-ut që lidhin konsultimin me vendimmarrjen.

“Problemet kryesore lidhen me nivelin e ulët të pjesëmarrjes dhe përfshirjen e kufizuar të grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse. Në këtë kuadër, njësitë vendore duhet të forcojnë bashkëpunimin me strukturat komunitare, të cilat mund të shërbejnë si hallka ndërmjetësuese për komunikim më efektiv me qytetarët.”

Gjetjet tregojnë se kërkesat e qytetarëve përqendrohen kryesisht në fusha si infrastruktura, punësimi, shërbimet sociale dhe strehimi. Ky model pasqyron një pjesëmarrje të orientuar drejt nevojave imediate socio-ekonomike, më shumë sesa drejt çështjeve strategjike të politikave publike. Modeli ndikohet nga disa faktorë të ndërlidhur. Së pari, kushtet materiale ndikojnë drejtpërdrejt në prioritetet e pjesëmarrjes, pasi në kushte pasigurie ekonomike angazhimi orientohet drejt mbijetesës. Së dyti, niveli i arsimimit dhe ndërgjegjësimit qytetar ndikon në kompleksitetin e kërkesave të artikuluara. Së treti, ndjenja e efikasitetit politik luan rol kyç; kur qytetarët nuk besojnë se pjesëmarrja sjell rezultate konkrete, angazhimi i tyre mbetet i kufizuar dhe pragmatik, duke reflektuar mungesë të cikleve efektive të feedback-ut. Dimensionet kulturore dhe psikologjike e përforcojnë këtë situatë. Mosbesimi institucional, përvojat negative dhe normat e dobëta të pjesëmarrjes reduktojnë gatishmërinë për të artikulluar kërkesa më komplekse. Roli i ndërmjetësve institucionalë dhe shoqërorë është vendimtar; kur ata kufizohen në mbledhjen e kërkesave dhe jo në fuqizimin qytetar, pjesëmarrja mbetet kryesisht procedurale dhe jo transformuese.

Diskutime

Duke u mbështetur në perspektivën e John Dewey mbi demokracinë si një proces

i “jetës së përbashkët” dhe zhvillimit kolektiv, pjesëmarrja qytetare në nivel lokal duhet të kuptohet si një mekanizëm themelor për ndërtimin e të mirës publike. Megjithatë, në linjë me kritikën e Giovanni Sartorit mbi demokracinë procedurale, gjetjet e këtij studimi tregojnë një hendek të qartë midis ekzistencës së mekanizmave formalë të pjesëmarrjes dhe ndikimit të tyre substancial në vendimmarrje. Edhe pse institucionet lokale kanë krijuar hapësira për informim dhe konsultim publik, këto nuk përkthehen në ndikim real qytetar, duke konfirmuar kufizimin e demokracisë në dimensionin e saj procedural. Në kuadrin e Lasswell-it mbi ciklin e politikëbërjes, pjesëmarrja qytetare mbetet e përqendruar kryesisht në fazat e para të politikave (informim dhe konsultim), ndërsa fazat e vendimmarrjes dhe vlerësimit mbeten kryesisht të mbyllura ndaj ndikimit qytetar.

Nga perspektiva e Lasswell-it, një sistem efektiv politikash kërkon integrimin e vazhdueshëm të input-it qytetar në të gjitha fazat e policy cycle. Megjithatë, gjetjet tregojnë një shkëputje midis input-it dhe output-it politik, ku kontributet e qytetarëve nuk përkthehen në vendime detyruese apo në mekanizma të strukturuar feedback-u. Në linjë me Sartorin dhe O’Donnell (2007), kjo situatë mund të interpretohet si një formë e demokracisë kryesisht procedurale ose delegative, ku institucionet ruajnë kontrollin mbi vendimmarrjen, ndërsa qytetarët mbeten në rol konsultativ. Nga perspektiva e Pateman, kjo nënkupton dështim të demokracisë pjesëmarrëse për të prodhuar qytetarë aktivë me ndikim real në qeverisje.

Teoria e kapitalit social e Robert Putnam-it ofron një shpjegim të rëndësishëm për kufizimet e pjesëmarrjes substancialë. Putnam argumenton se

besimi, rrjetet shoqërore dhe normat e reciprocitetit janë parakushte për angazhim efektiv qytetar. Gjetjet e këtij studimi sugjerojnë një nivel të ulët të këtyre komponentëve, veçanërisht në zonat urbane, ku ndërveprimi social dhe strukturat ndërmjetësuese janë më të dobëta. Në këtë kontekst, mungesa e kapitalit social dobëson jo vetëm angazhimin qytetar, por edhe funksionimin e ciklit të Lasswell-it, duke reduktuar efektivitetin e feedback-ut institucional dhe duke kufizuar aftësinë e sistemit për të mësuar nga qytetarët.

Në vijim të Pateman, pjesëmarrja nuk duhet parë vetëm si instrument për përmirësimin e politikave, por edhe si proces formues për qytetarin demokratik. Megjithatë, gjetjet tregojnë se përfshirja qytetare mbetet kryesisht formale dhe nuk prodhon transformim të roleve qytetare. Në këtë drejtim, Sartori do ta interpretonte këtë si një dominim të demokracisë procedurale mbi atë substanciale, ndërsa Putnam do të theksonte se mungesa e ndërveprimit të qëndrueshëm institucional–qytetar çon në erozion të mëtejshëm të kapitalit social. Lasswell, nga ana tjetër, do të nënvizonte mungesën e institucionalizimit të feedback loops si një dështim strukturor në lidhjen e fazave të politikëbërjes.

Gjetjet gjithashtu tregojnë se pjesëmarrja qytetare është e kufizuar kryesisht në artikullimin e nevojave imediate socio-ekonomike, si infrastruktura, punësimi dhe shërbimet sociale. Ky orientim pragmatik reflekton ndikimin e kushteve materiale, por edhe mungesën e kapaciteteve informative dhe institucionale për të artikuluar kërkesa më strategjike. Në kuadrin e Putnam-it, kjo lidhet me nivelin e ulët të kapitalit social dhe edukimit qytetar, ndërsa në kuadrin e Pateman, tregon mungesë të zhvillimit të kompetencave

demokratike përmes pjesëmarrjes. Në të njëjtën kohë, Lasswell ndihmon në interpretimin e këtij fenomeni si një kufizim në fazën e artikullimit të input-it politik, i cili nuk arrin të përkthehet në ndikim në fazat pasuese të ciklit.

Një dimension tjetër i rëndësishëm lidhet me rolin e institucioneve dhe ndërmjetësve socialë. Edhe pse ekzistojnë struktura formale konsultimi, mungesa e mekanizmave të qëndrueshëm të feedback-ut dhe ndërmjetësimit social kufizon efektivitetin e pjesëmarrjes. Nga perspektiva e Sartorit, kjo përforcon karakterin formal të demokracisë lokale; nga Pateman, kufizon zhvillimin e pjesëmarrjes si praktikë emancipatore; ndërsa nga Putnam, tregon dobësi në rrjetet horizontale të bashkëpunimit. Lasswell, në këtë kontekst, thekson se mungesa e një cikli të plotë komunikimi politik midis shtetit dhe qytetarëve pengon transformimin e input-it në output efektiv politik.

Në përfundim, analiza e integruar teorike e Sartorit, Pateman, Putnam dhe Lasswell tregon se pjesëmarrja qytetare në nivel lokal në Shqipëri karakterizohet nga një tranzicion i papërfunduar midis demokracisë procedurale dhe asaj substanciale. Sartori shpjegon kufizimin institucional të pjesëmarrjes, Pateman mungesën e transformimit demokratik, Putnam deficitin e kapitalit social dhe Lasswell fragmentimin e ciklit të politikëbërjes. Ky kombinim teorik sugjeron se përmirësimi i pjesëmarrjes kërkon jo vetëm reforma institucionale, por edhe forcim të kapitalit social, institucionalizim të feedback-ut dhe zgjerim të dimensionit deliberativ të demokracisë lokale. Vetëm në këtë mënyrë pjesëmarrja mund të kalojë nga një praktikë formale në një mekanizëm substancial të qeverisjes demokratike.

Përfundime të studimit mbi pjesëmarrjen qytetare dhe qeverisjen vendore

Studimi i realizuar në tre njësi të qeverisjes vendore (Patos, Mat dhe Elbasan) tregon se, pavarësisht ekzistencës së mekanizmave formalë për transparencë dhe pjesëmarrje qytetare, pjesëmarrja substanciale dhe ndikimi real i qytetarëve në vendimmarrje mbeten të kufizuara. Institucionet lokale kanë zhvilluar struktura dhe procedura për informim dhe konsultim publik të mbështetura nga kanale të ndryshme komunikimi; megjithatë, këto mekanizma mbeten kryesisht proceduralë dhe nuk garantojnë gjithmonë përfshirje efektive.

Ekziston një hendek i qartë midis pjesëmarrjes formale dhe asaj substanciale. Ky hendek lidhet kryesisht me mungesën e mekanizmave efektivë të feedback-ut, gjë që kufizon komunikimin e vazhdueshëm mbi mënyrën se si trajtohen kontributet e qytetarëve. Si pasojë, dobësohet besimi institucional dhe ulet perceptimi i ndikimit real të pjesëmarrjes.

Pjesëmarrja ndikohet nga një ndërthurje faktorësh strukturorë, socialë dhe kulturorë. Në zonat rurale, strukturat ndërmjetësuese lehtësojnë përfshirjen, ndërsa në zonat urbane mungesa e tyre dhe distanca më e madhe midis institucioneve dhe qytetarëve e reduktojnë angazhimin aktiv. Niveli i ulët i ndërjegjësismit qytetar dhe mungesa e njohurive mbi kuadrin ligjor e institucional e kufizojnë më tej pjesëmarrjen.

Përpjekjet për përfshirjen e grave dhe grupeve vulnerabël janë të pranishme, por shpesh mbeten formale dhe nuk shndërrohen në fuqizim substancial. Kjo lidhet me aftësinë e kufizuar për të artikuluar dhe përfaqësuar nevoja specifike, si dhe me kufizimet institucionale dhe buxhetore që pengojnë zbatimin e kërkesave të qytetarëve.

Shoqëria civile dhe bashkëpunimi institucional luajnë një rol të rëndësishëm,

por ende të fragmentuar. Organizatat e shoqërisë civile veprojnë si ndërmjetës dhe mbështesin grupet vulnerabël; megjithatë, përfshirja e tyre nuk është e institucionalizuar në mënyrë sistematike në proceset e politikëbërjes. Edhe bashkëpunimi ndërinstitucional kufizohet nga kapacitetet administrative, niveli i transparencës dhe barrierat në komunikim.

Sfidat kryesore përfshijnë koordinimin e dobët ndërmjet aktorëve, kufizimet financiare, nivelin e ulët të besimit reciprok dhe mungesën e mekanizmave të qartë të bashkëpunimit. Këta faktorë në tërësi kufizojnë ndikimin e aktorëve joqeveritarë dhe ndikojnë negativisht në cilësinë dhe reagueshmërinë e politikave publike.

Konsiderata etike

Autorët deklarojnë se ky punim është origjinal, nuk është botuar më parë dhe nuk është në shqyrtim për publikim në ndonjë revistë tjetër. Të gjitha të dhënat dhe metodat janë raportuar në mënyrë të saktë dhe transparente, në përputhje me standardet e integritetit akademik, duke përfshirë citimin e duhur, shmangien e plagjiaturës dhe përdorimin etik të burimeve.

Kërkimi me pjesëmarrje njerëzore

Ky studim është realizuar në përputhje me parimet e Deklaratës së Helsinkit. Të gjithë pjesëmarrësit janë informuar plotësisht mbi qëllimin e studimit, procedurat e përfshira dhe të drejtat e tyre, përfshirë të drejtën për t'u tërhequr në çdo moment pa pasoja negative. Pëlqimi i informuar është marrë nga të gjithë pjesëmarrësit përpara përfshirjes së tyre në studim. Pjesëmarrja ka qenë vullnetare dhe janë marrë masa të rrepta për të garantuar konfidencialitetin dhe anonimitetin. Në këtë studim nuk janë publikuar të dhëna që mund të identifikojnë pjesëmarrësit, dhe të gjitha të dhënat janë trajtuar në mënyrë që të mbrojnë privatësinë e tyre.

REFERENCAT

- Bryman, A. (2016). *Social research methods* (5th ed.). Oxford University Press.
- Creswell, J. W. (2014). *Research design: Qualitative, quantitative, and mixed methods approaches* (4th ed.). SAGE Publications.
- Esping-Andersen, G. (1990). *The Three Worlds of Welfare Capitalism*. Princeton University Press.
- Howlett, M., & Migone, A. (2025). Beyond evidentiary uncertainty: Mitigating political risks in policy designs. *Policy Design and Practice*, 8(3), 379–391. <https://doi.org/10.1080/25741292.2025.2529624>
- Huber, E., & Stephens, J. D. (2001). *Development and Crisis of the Welfare State: Parties and Policies in Global Markets*. University of Chicago Press.
- Lasswell, H. D. (1956). *The decision process: Seven categories of functional analysis*. University of Maryland Press.
- O'Donnell, G. (2007). *Dissonances: Democratic critiques of democracy*. University of Notre Dame Press.
- Pateman, C. (1970). *Participation and democratic theory*. Cambridge University Press.
- Patton, M. Q. (2015). *Qualitative research & evaluation methods* (4th ed.). SAGE Publications.
- Pierson, P. (1994). *Dismantling the Welfare State? Reagan, Thatcher, and the Politics of Retrenchment*. Cambridge University Press.
- Putnam, R. D. (1993). "Bowling alone: America's declining social capital", *Journal of Democracy*, 6(1), 65–78. <https://doi.org/10.1353/jod.1995.0002>
- Putnam, R. D. (2002). *Democracies in flux: The evolution of social capital in contemporary society*. Oxford University Press.
- Sartori, G. (1987). *The theory of democracy revisited*. Chatham House Publishers.
- Thomas, M. Alexander. 2020. "Toward a culture of Democracy", *Dewey Studies*, Vol. 4, No. 1, 2020, pp. 18–24.
- Wilensky, H. L. (2002). *American political economy in global perspective*. University of California Press.

ABSTRACT

This study examines citizen participation in social policy-making processes at the local governance level in Albania, focusing on the municipalities of Patos, Mat, and Elbasan. The primary objective is to identify the institutional, social, and structural factors that influence the intensity and quality of citizen engagement in local decision-making processes. The research adopts a qualitative approach, employing semi-structured interviews with 31 participants, mainly key actors from local administrations and community representatives, selected through purposive sampling. The findings indicate that, although formal mechanisms for public consultation and information-sharing exist, citizen participation remains limited and often symbolic, with little direct influence on decision-making. This situation reflects a persistent gap between procedural and substantive participation. Constraining factors include a lack of institutional trust, socio-economic limitations, and territorial inequalities, particularly in rural areas, which affect both access to and the effectiveness of civic engagement. Drawing on theories of participatory democracy and social capital, the study argues that a transition toward a more substantive model of citizen engagement requires strengthening dialogue mechanisms, enhancing transparency, and institutionalizing feedback within the local policymaking process.

Keywords: *Citizen participation, social policy, local governance, transparency, accountability.*

REFLEKTIM MBI KONCEPTIN E DEMAGOGUT DHE DEMAGOGJISË NË ANTIKITET

Marsida MINGA

Akademia e Forcave të Armatosura

Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes

E-mail: marsidaheta8@gmail.com

marsida.heta@aaf.mil.al

Zana STRAZIMIRI

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Filozofisë

E-mail: zanastrazimiri@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Ky punim është një përpjekje për të reflektuar mbi një aspekt fenomenologjik të demokracisë siç është ai i demagogjisë e figurës së demagogut që e ka shoqëruar atë historikisht, pavarësisht specifikës së konteksteve të ndryshme socio-politike në hapësirë dhe kohë. Sot, kur fenomeni i populizmit dhe i demagogëve populiste kërcënon gjerësisht demokracinë përfaqësuese, është i nevojshëm thëllimi në studimin e tij, si një praktikë demokratike, por që e kufizon konceptin e demokracisë, kuptimin e përmbajtjen e saj të vërtetë. Në punim synohet rikthimi dhe ripërcaktimi në mënyrë kritike i nocionit të demagogjisë e të demagogut, duke u mbështetur në qasjet e mësimet e autorëve antikë, pasi trashëgimia e tyre mbetet e rëndësishme për të kuptuar e vlerësuar fenomenin dhe kontekstet që lidhen me të. Studimi i tyre lejon gjurmimin e bazës ideologjike të demagogjisë e gjenezës së disa çështjeve themelore dhe të përsëritura që mbeten ende të hapura sot, për të parandaluar që demagogjia e praktika jodemokratike, të afta të duken demokratike, të zëvendësojnë demokracinë, duke synuar madje një pushtet autokratik.

Fjalë kyç: *demokraci, demagog, demagogji, retorikë*

Msc. **Marsida MINGA** ndjek studimet doktorale pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Filozofisë. Marsida zotëron një diplomë Bachelor në Filozofi (2011) dhe një diplomë Master i Shkencave në Filozofi Sociale (2013). Që nga viti 2023 ajo ndjek studimet doktorale

me fokus në filozofi politike, duke u përqendruar në ndërveprimet midis populizmit dhe elitarizmit në demokraci. Ajo është Asistent/Lektore për shkencë sociale dhe leadership në Fakultetin e Sigurisë dhe Mbrojtjes, Akademia e Forcave të Armatosura. Marsida është e interesuar në Shkencë Sociale, Etikë, Komunikim, Politikë, Media.

Prof. Asoc. Dr. **Zana STRAZIMIRI** ka një karrierë të gjatë si pedagoge pranë Departamentit të Filozofisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Fusha e mësimdhënies e kërkimit të saj shkencor ka qenë “Historia e filozofisë antike e mesjetare” dhe “Filozofia morale”. Duke filluar nga viti 2026, ajo kontribuon pranë këtij departamenti si pedagoge e jashtme.

Hyrje

Fenomeni i populizmit po karakterizon hapur e progresivisht demokracitë përfaqësuese, madje një mënyrë për të tipizuar konjunkturën aktuale politike jo vetëm në Evropë është evidentimi i ngritjes në pushtet të politikanëve që përshkruhen më së miri si “demagogë” e i retorikës së tyre demagogjike.

Lidhja midis populizmit bashkëkohor dhe demagogjisë është e shpeshtë, si në literaturën akademike, ashtu edhe në debatin politik. Me ngritjen e partive dhe politikanëve populistë, të majtë apo të djathtë, studiuesit u janë referuar trashëgimisë e mësimëve nga demokracitë e Greqisë së lashtë, përqendruar në “demagogët” e tyre. Madje duhet patur parasysh se demagogjia, nisur fillimisht nga Greqia klasike, ka qenë një shqetësim kryesor për mendimtarët politikë, pasi përcaktonte diskutimet mbi tema kyçe të natyrës e difekteve të demokracisë, leadershipit politik, retorikës publike, kundërvënieve midis fraksioneve oligarkike dhe popullore apo të natyrës së regjimit më të mirë.

Reflektimi mbi kuptimin e përmbajtjen e termave “demagog” e “demagogji” që në gjenezën e tyre, si politikisht, por edhe historikisht, ka rëndësi e orienton për ta kuptuar fenomenin, por e nevojshme edhe sot për të ruajtur e mbrojtur demokracinë, kur praktika të caktuara brenda saj e të konsideruara demokratike, në fakt, e cenojnë dhe nuk e garantojnë atë. Nga ana tjetër, nëse nuk ka ndërgjegjësim, edukim

dhe emancipim të vetë masave lidhur me praktika të këtij lloji, ato do të vazhdojnë të jenë një erozion i brendshëm i shoqërisë demokratike. Siç thotë Piero Buscioni, do të ketë turma të paditura për sa kohë që do të ketë demagogë banalë, dhe do të ketë demagogë banalë për sa kohë që do të ketë turma të paditura.

Në punim do referohen dhe analizohen qasje mbi konceptet e demagogjisë e demagogut në fushën e mendimit antik, duke përzgjedhur Aristofanin, Platonin dhe Aristotelin. Rikthimi tek disa nga kritikët më të ashpër të demokracisë athinase mund të gjykohet me interes për të parë nëse në vlerësimet e tyre mund të identifikohen elementë, qasje e konkluzione që vlejnë për të kuptuar edhe më mirë krizën aktuale si dhe analogjitë në ballafaqimin me to të populistëve të sotëm demagogë, në ruajtje të shëndetit të demokracisë.

“Kalorësit” – një satirë kundër demagogjisë

Demokracia dhe demagogjia janë të dy fjale me origjinë greke, të lidhura me përvojën politike të Greqisë klasike. Termi u shfaq së pari në shekullin e 5-të p.e.s., në Athinë, një periudhë që u dallua për ndarje të rëndësishme shoqërore-politike midis aristokracisë dhe popullit, në kontekstin e një procesi demokratizimi. “Demagog” lidhet me dy fjalë: *δημαγωγός* (demagogos) dhe *δημηγόρος* (demegoros), që kanë rrënjë të ngjashme, ndaj dhe ndajnë një kuptim

të ngjashëm. Parashtesat e pranishme në të dyja këto fjalë, përkatësisht emrat “δημα” dhe “δημη” rrjedhin nga e njëjta fjalë, “δῆμος” (demos), që do të thotë popull. Prapashtesa e të parës rrjedh nga folja “ἄγω” (ago), që do të thotë të udhëheqësh, ndërsa e dyta është një formë e foljes “ἀγορεύω” (agoreuo), që do të thotë të flasësh në një kuvend. Por dy foljet rrënjësore janë të lidhura ngushtë (Ober, 1989).

Sidoqoftë, tej konotacionit negativ të konsoliduar gjatë shekujve, vetë termi “demagog” e ka origjinën në një qasje neutrale dhe përshkruese. Edhe kur përdorej, termi zakonisht u referohej politikanëve si “udhëheqës të popullit”. Të ishte demagog nënkuptonte të bëje politikë dhe termi mbetej përshkrues.

Studiuesi i njohur i antikitetit grek, Moses Finley, duke pohuar përdorimin e termit në kuptim neutral, argumenton se demagogët ishin një element struktural në sistemin politik athinas e ky term ishte njëloj i aplikueshëm për të gjithë udhëheqësit, pavarësisht klasës apo pikëpamjeve; ata gjykoreshin individualisht jo thjesht nga mënyrat e taktikat që përdornin, por nga performanca e tyre. Finley shprehet gjithashtu se në Athinën demokratike të gjithë politikanët duhet të ishin deri diku “demagogë”, pasi, në kushtet e mungesës së mbështetjes së partive politike të organizuara, pushteti i tyre varej në mënyrë të pashmangshme nga aftësia për të fituar pëlqimin e ‘demosit’ në kuvendet publike, kryesisht përmes retorikës (Finley, 1962).

Figura të shquara të jetës politike të antikitetit, si Themistokliu, Perikliu dhe Kleoni u quajtën të gjithë “demagogë”, pavarësisht vlerësimit të veprimeve të tyre politike. Edhe studiuesja Melissa Lane ka argumentuar qartë se grekët e lashtë nuk bënë dallim midis “politikanit të mirë” dhe “demagogut të keq”: ata mund të

dallonin padyshim midis një burrështetasi të mirë dhe një të keq, por nuk e përdornin fjalën “demagog” për të identifikuar dhe përshkruar domosdoshmërisht një politikan të keq. Kuptim i termit do ndryshojë gradualisht nga neutral në përbuzës, negativ dhe, sipas Lane, dy filozofë dhe kritikë të demokracisë, Platoni dhe Aristoteli, do luajnë një rol kyç në një transformim të tillë (Lane, 2012).

Shfaqja e parë e termit “demagog” i takon komedisë së Aristofanit, “Kalorësit” (424 p.e.s.), një komedi politike me një strukturë alegorike, që konsiderohet si një nga veprat më të mira të komedianit, një metaforë e situatës politike athinase të asaj kohe.

Autori ironizon dhe i kundërvihet demagogut Kleon (politikan dhe strateg athinas i rëndësishëm por kontrovers i shekullit të 5 p.e.s, aktiv gjatë Luftës së Peloponezitet, por edhe parlamentit të Athinës që e konsideron përgjegjës për gjendjen në të cilën është katandisur vendi, për paaftësi në drejtimin e jetës së vendit, për prirje luftënxitëse, duke u bërë kështu vegël, në duart e demagogëve si Kleoni.

Komedia është një kritikë e drejtpërdrejtë e politikave luftënxitëse të Athinës gjatë Luftës së Peloponezitet. Është Athina post-periklane në një dekadencë marramendëse, e gjuhëzuar para një klase politike mashtruese, plot me demagogë, aq dinakë sa dhe lakmitarë, mendjengushtë dhe të padobishëm. Është një Athinë e rraskapitur nga vite lufte vëllavrasëse siç ishte Lufta e Peloponezitet, e cila i vuri përballë athinasit kundër grekëve të tjerë, kryesisht spartanëve, ku përfituesit e saj nuk ishin sigurisht qytetarët e Athinës. Aristofani është shumë i vetëdijshëm për këtë dhe e sulmon hapur, mbi të gjitha, politikanin demokrat Kleon, përfaqësuesin kryesor të fraksionit luftënxitës.

Komedia e Aristofanit denoncon

me ironi të pamëshirshme degjenerimin e demokracisë në Athinë. Vepra ka një aktualitet të spikatur, pasi ekspozon demagogjinë dhe tregon metodat e përdorura nga demagogët (të aftë për të manipuluar popullin me lajka, frikë dhe premtime boshe) për të fituar pushtet, idenë e degjenerimit të debatit politik e lehtësinë me të cilën njerëzit mund të mashtrohen brenda kuvendeve ose procedurave demokratike. Skena e komedisë është shtëpia e Demosit të Pniksit; Demosi (populli), një personazh me një emër të qartë, transparent, që paraqitet në mënyrë alegorike si i zoti i shtëpisë, ndërsa politikanët si shërbëtorët të tij. I vlerësuar në aspektet e tij më të ulta, si masë pa ideale, ai ka qëllim vetëm kënaqësitë shqisore e zbavitjet, duke simbolizuar demokracinë e degjeneruar. Ky është qëndrimi antidemagogjik i autorit që shpreh me forcë atë panoramë të Athinës së kohës, si qytet i mashtruesve, demagogëve, veseve, politikanëve të pandershëm, për të cilën do flasë më vonë Platoni.

Demosi është një plak injorant që, ndonëse ka një dinakëri të lindur, i ndjeshëm ndaj lajkave të shërbëtorëve të vet, e le veten të drejtohet e mashtrohet nga njëri prej tyre, Paflagoni, figuracioni komik i të gjithëfuqishmit luftënxitës Kleon. Paflagoni është një njeri i korruptuar, me një profesion të përbuzshëm si regjës lëkurësh e të cilit Aristofani i referohet vazhdimisht për ta degraduar më tej portretin e tij. Ky sharlatan, që vjedh dhe shpërdoron pronën e Popullit, mbart një sërë tiparësh negative, si servilizmin, sjelljen lajkatare e hipokrite ndaj zotërisë së tij, ndërsa tregohet i ashpër e dhunues ndaj njerëzve të thjeshtë si vetja. Falë karakterit të tij të keq e mënyrave prej demagogu, me oratorinë e zhurmshme dhe të pahijshme, ka fituar simpatinë e mbështetjen e Popullit, ndaj sillet sikur të ishte zoti i shtëpisë.

Dy prej shërbëtorëve përpiqen ta largojnë Paflagonin, duke nxitur pikërisht një tjetër demagog ta zëvendësojë atë në “bërjen e politikës”, Kukurecaxhiun Agorakriti, me një emër shumë aludues që do të thotë “i zgjedhur nga sheshi”. Aristofani demaskon kështu rënien e praktikave të mira demokratike të shkaktuara nga veprimet e demagogëve, një rënie për të cilën nuk ka ilaç (për sa është e vërtetë që fundi i Paflagonit do përkohë me triumfin e Kukurecaxhiut, edhe më i përbuzshëm dhe negativ se ai).

Por çfarë cilësish duhet të ketë dikush që të merret me politikë? Për ta joshur e për të kapërcyer frikën e mosbesimin e Kukurecaxhiut në këtë rol, për shkak të mungesës së dijeve e kulturës, shërbëtorët e qetësojnë duke i thënë se “demagogjia s’i ka hije më njeriut që është i ditur e i ndershëm, por vetëm një xhahili të shpëlarë” (Aristofani, 1962:27), se ai është i përshtatshëm pikërisht se “bëhet i madh, duke qenë dinak, rezil e arrogant” (Aristofani, 1962:26). Portreti i demagogut e nevojës që Populli ka për të thellohet më tej; njëri nga shërbëtorët e këshillon Kukurecaxhiun lidhur me detyrat që ka përpara e që fare mirë mund t’i realizojë: “Trazoji, mpleksi çështjet... fashitja mendjen popullit me fjalka të ëmbla prej gjellbërësi. Ç’i duhet një demagogu, ti i ke në sërë: zërin të çjerrë, fisin fundërrinash dhe sjelljet prej rrugaçi! I ke të gjitha ç’i duhen në zanat qeveritarit (Aristofani, 1962:29). Përdorimi i fjalës “demagog” nga Aristofani duket se ka natyrë përshkruese, atë të qeverisjes, të të bërit politikë.

Sulmet e Aristofanit ndaj shoqërisë së kohës janë kritika ndaj përfaqësuesve të padenjë të rendit demokratik. Aristofani mendon se Populli, Demosi duhet të ushtronte pushtetin e dhënë me më shumë ndërjegjësim e vigjilencë, për

të mos lejuar politikanët ta mashtrojnë duke mbushur xhepat e tyre dhe duke përndjekur kundërshtarët e tyre:

Të madh e të fuqishëm o Popull e ke pushtetin/ Secili ta ka frikën sikur t'ishe mbret!/Po ty të heq prej hundësh lehtë kushdo/ gëzohesh dhe kur të bëjnë lajka/ por edhe kur mashtrohesh rri e dëgjon me goj' hapur, këdo që mban fjalime/ dhe mendja e pranishme shkon larg me fluturime" (Aristofani, 1962: 91)

Komedia shfaqet ekstremisht agresive, me një satirë therëse që manifestohet edhe në fjalorin tejet të ashpër në gojën e personazheve. Sidoqoftë në fundin e komedisë, autori përpiket ta rehabilitojë disi Demosin, duke treguar se nuk është aq i mefshtë, por se qëllimisht i lë njerëzit që të vjedhin e pasurohen prej tij që në vazhdim drejtësia t'i bëjë të kthejnë mbrapsht gjithçka. Me këtë mbrojtje duket se Aristofani përpiket që të shmangë akuzën se po fyen pushtetin. Ai ve në gojën e Popullit fjalët: "Në qoftë se kujtoni që mendt'e mia vanë/nuk paski tru në flokë/ me kast bëj budallanë/ Ma kënda dita ditës ta kem sofrën shtruar/T'ushqej dhe një ministër, kusar të diplomuar/ që kur zë fryhet tepër, e shtrihet zdrëng përdhe/ e ngre e më t'i qepem edhe ta bëj pelte!/ Sa herë më vjedhin unë hiqem se nuk shoh asgjë./ por jam vigjilent dhe më vonë i detyroj të vjellin ato që më kanë vjedhur/ duke u vendosur në fyt hinkën e votës, lakun e votimit gjyqësor" (Aristofani, 1967: 92)

Në fund, Populli gjen si aleat Korin e përbërë nga Kalorësit, e vetmja milici e qëndrueshme qytetare, fisnikë athinas që përfaqësojnë një fraksion konservator, armiqësor ndaj Kleonit. Ndërkaq, Agorakriti, rivali intrigant, edhe më i neveritshëm e mashtrues se Paflagoni, do marrë fitoren dhe do e ridrejtojë Popullin në rrugën e duhur; tashmë ky i fundit do të ketë qeverinë që meriton, ndërsa

demokracia athinase ishte shndërruar në demagogjike.

Duket se e gjithë kjo histori i shërben autorit për të prezantuar një tezë politike me të vërtetë paradoksale: Athinasve, që u mungon kriteri i përzgjedhjes së lidershit dhe e lenë veten të gënjen nga lajkatarë të "thekur", nuk mund të çlirohen nga abuzimet e Kleonit, nëse ky i fundit nuk do të zëvendësohet nga dikush edhe më mjeran e i paturpshëm se ai. Pak kohë pas kësaj komedie shumë të suksesshme, vetë Kleoni u rizgjodh, si një konfirmim i diagnozës e prognozës së Aristofanit!

Ngjan si një analogji me të sotmen; në një kontekst shoqëror ku populizmi është i përhapur, qytetarët, të zhgënjyer nga politika e sloganeve boshe, polarizimi i debatit publik, luhaten midis mosbesimit ndaj atyre në qeveri dhe iluzionit të shpëtimit nga një udhëheqës i ardhshëm karizmatik.

Platoni mbi demagogun e demagogjinë

Nëse Aristofani e përdori termin "demagog" nga një qasje përshkruese, neutrale, me Platonin e Aristotelin, dy filozofët e mëdhenj - kritikë të demokracisë, kuptimi do ndryshojë në negativ.

Duke lexuar Platonin, kupton se kjo prirje për të besuar në premtimet e rreme të demagogëve ka pasoja dramatike; në këndvështrimin e tij, shkaqe institucionale dhe strukturore, sociale dhe antropologjike, e bëjnë të natyrshëm degjenerimin demagogjik të regjimit demokratik. Demagogjia, e rrënjësuar në vetë *ethos*-in e themeleve të demokracisë e degjeneron atë në një regjim autokratik.

Në të vërtetë, lidhur me rolin e Platonit në kristalizimin e nocionit negativ të "demagogut" si antiteza e "burrit të shtetit", literatura akademike

u është referuar disa prej dialogëve më të rëndësishëm të tij. Në to, si një kritik radikal i demokracisë, Platoni këmbëngul për lidhjen e brendshme, sipas tij të pashmangshme, midis demagogjisë e demokracisë, një regjim ku njerëzit, të shtyrë nga dëshira irracionale dhe thelbësisht injorantë, vendosin për çështje themelore të jetës kolektive, pa pasur aftësinë e mjaftueshme për ta bërë këtë. Qasja kritike e Platonit përqendrohet në rolin e sofistëve dhe demagogëve që përkeqësojnë efektet e dëmshme të injorancës masive. Top of Form

Në dialogun *Gorgias* (një dialog i hershëm, 386 p.e.s.) Sokrati kritikon ashpër retorikën sofiste, duke e quajtur atë një formë “lajkatimi” ose “bindjeje” të zhveshur nga e vërteta etike; teksti sulmon demagogjinë, duke argumentuar se pushteti politik duhet të bazohet në drejtësi dhe jo në manipulimin e masave. Në dialog ballafaqohen portretet e kundërta të burrështetasit të mirë dhe të keq, nga këndvështrimi i moralit, dijeve dhe retorikës.

Çështja e demokracisë ofron të *Gorgias* sfondin për konfliktin midis retorëve-sofistë, artit retorik dhe filozofëve - zotëruesve të dijes së vërtetë, shkencës. Në fokus janë udhëheqësit popullorë të Athinës demokratike e veçanërisht instrumenti i tyre kryesor politik, retorika; vlerësimi i demokracisë zhvillohet kryesisht përmes analizës së retorikës. Protagonizmi i Sokratit nënkupton pikërisht përballjen e filozofit/filozofisë me retorët/retorikën, përmes një mizanskene domethënëse, me personazhe të njohur të kohës, midis të cilëve Gorgias që, pas Protogorës, ishte më i njohuri midis sofistëve. Hulumtimi përqendrohet në çështjen nëse retorika është apo jo një *techné*, mjeshtëri, art, apo ka karakterin e dijes së vlefshme. Sokrati mohon pretendimin mbi retorikën si një

teknikë, art, mjeshtëri dhe pohon se ajo është “një praktikë empirike” (Platone, 1991). Ashtu si në dialogë të tjerë, argumenti që qëndron në themel të këtij refuzimi është pjesërisht epistemologjik dhe pjesërisht aksiologjik. Retorika, në fakt, nuk ka një fushë njohëse të përcaktuar dhe shprehet në një aktivitet kryesisht negativ, përkatësisht lajkatimin e instinkteve më të këqija të masave: “A mendoni se retorët flasin gjithmonë duke pasur parasysh më të mirën, të shqetësuar vetëm që qytetarët, në sajë të fjalimeve të tyre, të bëhen më të mirë, apo oratorët politikë synojnë gjithashtu vetëm t’i kënaqin qytetarët dhe, për përfitimin e tyre personal, pa menduar fare për të mirën e përbashkët, u flasin njerëzve sikur të ishin fëmijë, duke kërkuar vetëm t’i kënaqin ata, pa u shkuar ndërmend fare nëse duke vepruar kështu njerëzit bëhen më të mirë apo më të këqij?” (Platone, 1991).

Në këtë kontekst, Platoni, me gojën e Sokratit, analizon figurën e Gorgias e tregon kontradiktën e brendshme të saj e doktrinës që përfaqëson; Gorgias këmbëngul se mund të mësojë artin e vet prej retori pa u marrë drejtpërdrejt me drejtësinë, pasi rëndësi ka që thjesht të mendojë drejt e ta përdorë drejt këtë mjeshtëri.

Retorika, nga çduket, prodhon atë tip bindjeje që të mbush mendjen, e jo atë tip bindjeje e aftë të mësojë rreth të drejtës e të padrejtës...Retorika prodhon bindje por pa dije (Platone, 1991).

Lidhur me çështjen e dijes, të njohjes se ç’është e drejta, sipas Platonit kjo është strukturalisht e pamundur, pasi retorika, nga vetë natyra e saj, u takon dukjeve e jo njohjes të natyrës së gjërave. Fakti që dishepujt i bëjnë një përdorim të padrejtë retorikës, nënkupton që e keqja, në një farë mënyre, është edhe tek mjeshtri, edhe tek

instrumenti. Madje të dy dishepujt e Gorgias në dialog shfaqen të tillë: Polo i Agrigjendës paraqitet si një njëri fanatik i artit të vet, retorikës, impulsiv dhe i paduruar, me parime morale që lënë për të dëshiruar, që nuk vlerëson se retori duhet të njohë ç'është e drejta. Kalikle, dishepulli tjetër, ka humbur çdo parim etik dhe e çon retorikën në kufij ekstremë; Platoni e ka portretizuar si personazhin që mbart në vete gjithçka që mund të prodhonte retorika e politika demokratike, e dëmtuar nga tendencat demagogjike në Athinën e asaj kohe.

Duke evidentuar kontrastin e thellë midis filozofëve dhe retorëve, Platoni kontribuoi në formësimin e tipareve kryesore të debatit mbi demagogjinë për shekujt në vijim. Nga qasje etike, epistemologjike e politike, ai e demaskon demagogjinë përsa argumenton karakterin e mangët moral të demagogut, gatishmërinë e tij për të ndjekur vetëm interesat personale, mungesën e njohurive thelbësore që e pengojnë atë të zhvillojë ide se çfarë është e drejtë dhe e mirë për qytetin dhe marrëdhënien e tij thjesht instrumentale me njerëzit. Duke bërë dallimin midis burrështetasit dhe demagogut, në mënyrë analoge midis filozofit dhe sofistit, ajo që i karakterizon dhe i dallon filozofin dhe burrështetasin nga pretendentët dhe mashtruesit është zotërimi i njohurive të vërteta, që përfshijnë shkencën politike. Sipas tij, përmes një edukimi të gjatë dhe të hollësishëm ata kanë kuptuar të vërtetën rreth çështjeve më të rëndësishme për një qenie njerëzore dhe zotërimi i një dijeje të tillë u jep atyre të drejtën të sundojnë, madje edhe mbi ligjet. Një koncept i tillë pasqyrohet, për shembull, në portretizimet kontrastuese të Perikliut dhe Kleonit në *Kalorësit* e Aristofanit dhe *Luftën e Peloponezisë* të Tukididit (si dhe te Aristoteli dhe Ciceroni), ku Perikliu përfaqëson burrështetasin ideal dhe Kleoni demagogun tipik.

Për Platonin, aftësia e retorëve është e zhveshur nga çdo implikim moral dhe dije thelbësore. Ata janë specialistë në aftësinë për të hamendësuar shijet, dëshirat dhe mendimet e njerëzve dhe për t'i manipuluar e lajkatur ata përmes retorikës, ndaj ky lloj politikanësh nuk është në gjendje të edukojë njerëzit dhe t'i udhëheqë ata drejt së mirës. Retorët, sipas fjalëve të Sokratit, “përqendrohen vetëm në kënaqësinë e qytetarëve, duke përcmuar interesin e përbashkët për hir të interesit të tyre privat”, ndërsa roli i tyre duhet të jetë që “të kujdesen që qytetarët të bëhen sa më të mirë të jetë e mundur” (Platone, 1991).

Platoni, me gojën e Sokratit, argumenton se filozofët e duan dhe e ndjekin dijen, urtësinë, mençurinë dhe, duke vepruar kështu, mund të përmirësojnë virtytet e bashkëqytetarëve të tyre dhe të kontribuojnë në bërjen e qytetit më të drejtë, që janë qëllimet më autentike të burrit të shtetit. Sipas tij, lidershipi i mirë politik konsiston në ngritjen e qytetarisë në virtyt, çka ka të bëjë me dijen. Në një nga fragmentet e Gorgias, Sokrati thotë se: “udhëheqësi i mirë, që zotëron mjeshtërinë politike, ...vetëm ai që është i përgatitur t'i bëjë njerëzit më të virtytshëm dhe më të ditur, është burrë shteti” (Platone, 1991). Ai pohon:

unë besoj të jem ndër të paktit athinas, për të mos thënë i vetmi që tentoj artin e vërtetë politik. Dhe vetëm kur të ushtrohemi me virtyt, vetëm atëherë jeta mund t'i dedikohet politikës....Fjalimet që unë mbaj herë pas here nuk synojnë kënaqësinë, por atë që është më e mira” (Platone, 1991: 520-521).

Kjo mishëron edhe konceptin e idealit platonian të udhëheqësit, pikërisht atë të mbretit-filozof.

Në një farë mënyre, Platoni radikalizonte një opinion përgjithësisht dominues në Athinën demokratike: ndërsa

përdorimi i aftë i retorikës nga politikanët vlerësohej shumë, në të njëjtën kohë, shihej me skepticizëm edhe në atë masë sa mund të përdorej edhe për qëllime amorale. Gjykohej se elokuenca ishte e nevojshme për udhëheqjen politike, por ajo duhet të shoqërohej gjithmonë me gjykim të mirë, virtyt dhe *paideia* - edukim i gjere, ku retorika ishte vetëm një pjesë (Ober, 1989: 183–188).

Përveç portretizimit të figurës së demagogut e tipareve të tij, Platoni ndalet veçanërisht në rolin që masat injorante luajnë në mbajtjen në këmbë e vitalizimin e demagogëve e demagogjisë. Kjo qasje ilustron në mënyrë të qartë nga një fabul e famshme tek *Gorgias*, ku bëhet një analogji: nëse një pastiçier e një mjek do të paraqiteshin para një jurie fëmijësh dhe i pari do u premtonte atyre ëmbëlsira të dëmshme ndërsa i dyti do u propozonte dietë dhe purgativë, ai që do triumfonte lehtësisht do ishte pastiçieri (Platone, 1991). Qartësisht, pas figurës së mjekut, nuk është e vështirë të dallosh atë të Sokratit, i ekzekutuar sepse u kishte thënë bashkëqytetarëve të tij të vërteta që nuk pëlqenin t'i dëgjonin. Si një autor thellësisht antidemokratik, Platoni kërkon të mbrojë tezën se vetëm të diturit kanë të drejtë të qeverisin; “fëmijët-popull”, që dëshirojnë kënaqësitë e pastiçierit dhe mbeten të shurdhër ndaj argumenteve jo komode të mjekut, pra turma, nuk arrin të kuptojë pasojat dramatike të demagogjisë.

Edhe dialogu tjetër i Platonit tek, *Republika* (1999), kryevepra filozofike e tij, që mbahet mend për alegorinë e shpellës, për përshekrimin e një shteti ideal të drejtuar nga filozofët-mbretër, për dënimin e poetëve, etj, është gjithashtu një libër kundër demagogëve, veçanërisht e rëndësishme lidhur me debatin mbi demagogjinë në demokraci.. Në Librin IX të *Republikës*, Platoni argumenton se

njerëzit më të mirë për të qeverisur komunitetin janë ata, sjellja e të cilëve drejtohet nga arsyeja. Të tjerët, tek të cilët arsyeja është e pafuqishme, duhet t'u nënshtrohen të parëve, ashtu si fëmijët duhet t'i nënshtrohen udhëzimit të baballarëve dhe mësuesve derisa të bëhen të rritur. Në këtë mënyrë, të gjithë do t'i nënshtrohen në mënyrë të barabartë komandës së arsyes, të brendshme dhe të drejtpërdrejtë në disa, të jashtme dhe të ndërmjetësuar në të tjerët (Platoni, 1999: 374-375).

Ky realizim i roleve udhëheqëse sipas shkallëve të racionalitetit nuk ekziston në demokraci, ku pushteti është të paktën formalisht në duart e shumicës së burrave të papjekur racionalisht. Këta fëmijë-burra pra, do të jenë të ekspozuar në mënyrë të pashmangshme ndaj manipulimit demagogjik; demagogjia rezulton të jetë një instrument me dy tehe skllavërimi, sepse i ekspozon masat ndaj lajkatimit të demagogëve që u drejtohen instinkteve të tyre më të këqija dhe i detyron vetë demagogët t'i nënshtrohen presionit të këtyre instinkteve (Vegetti, 2013).

Në Librin VI të Republikës, demagogu krahasohet me stallierin e “një kafshe të madhe dhe të fuqishme” që di mënyrat për ta kënaqur dhe zbutur atë, dhe e bën këtë teknikën e tij “politike”. Sidoqoftë, kjo është një teknikë e paaftë për të dalluar atë që është e nevojshme për qëllimet e manipulimit të kafshës nga ajo që është vërtet “e nevojshme, e drejtë dhe e bukur” (Platoni 1999: 241-241).

Për sa qëllimi i diskursit demagogjik është të tërheqë numrin më të madh të bashkëqytetarëve në anën e tij, ai është shpesh i ndryshueshëm, kameleon.; i varur nga rrethanat dhe ndjenjat e audiencës, imazhet e evokuara nga demagogët ndryshojnë për të ndikuar te qytetarët dhe për të stimuluar reagime të caktuara.

Demagogët paradigmaticë si Kleoni, të përshkruar si të korrumpuar dhe të paskrupullt nga Aristofani dhe Turkididi, arrijnë të ngjallin entuziazëm, nga njëra anë duke u bërë pëlqimi i audiencës së tyre përmes lajkave, dhe, nga ana tjetër, duke nxitur instinktet më të këqija të saj. Studiuesi i njohur i antikitetit, Mario Vegetti, pohon se për Platonin, përkushtimi ndaj kënaqësive të trupit dhe dëshira agresive për vetë-afirmim mbizotërojnë te shumica e njerëzve; “Homo democraticus” drejtohet nga shpirti “impulsiv,” i dëshirave (*epithymetikón*) dhe jo nga shpirti i tij “racional” (*loghistikón*). Platoni e hodhi poshtë në mënyrë drastike parakushtin e nënkuptuar ose të qartë antropologjik të demokracisë, pra disponueshmërinë natyrore të dhuntisë intelektuale për të gjitha qeniet njerëzore (Vegetti, 2013).

Një efekt anësor, por problematik i demagogjisë, është konformizmi, siç tregon Platoni në një analizë të jashtëzakonshme në Librin VI të Republikës lidhur me “shkaqet që përdhosin karakteret” e pasojat e “korrumpimit të shpirtit” nga edukimi demagogjik sofist. Është vërtet e vështirë, pohon ai, pasi është problematike, veçanërisht për një të ri, t’i rezistojë presionit të opinionit publik të gënijer nga sofistët (i cili këtu shprehet me dallgë sharjesh dhe lëvdatash). Përballë këtij presioni, ai duhet të përshtatet, të bindet, të përulet e të përfundojë duke “gjykuar njëlloj si turma”, duke “përfutur të njëjtat shije e duke u ngjarë atyre”. Jo vetëm kaq, por aty ku bindja dështon, funksionon shtërngesa, dhuna, “turpërime, gjoba, kërcënim me vdekje” (Platoni 1999: 241).

Duket se Platoni e ekzagjeron këtu në përshkrimin e shtypjes së ashpër të demokracisë athinase, por është e qartë se ai ka në mendje dënimin e Sokratit. Dhe më shumë sesa shtërngimi i dhunshëm, problematik është presioni i konsensusit,

konformizmit të masave, imponimi i mënyrave të jetesës dhe i mendimit të përbashkët. Sigurisht, konformizmi demokratik lejon gjithashtu një larmi të madhe mendimesh dhe sjelljesh, siç e bën të qartë analiza e e Platonit në Librin VIII, por në çdo rast, këto janë mosmarrëveshje brenda demokracisë, jo kundër demokracisë (Vegetti, 2013).

Shtuar demagogjisë dhe konformizmit, e keqja tjetër e regjimit demokratik është anarkia, refuzimi për t’iu nënshtruar ligjeve dhe normave që perceptohen si të dëmshme për lirinë, kundërvënja ndaj çdo forme autoriteti, moral apo politik, përveç asaj të demagogut “udhëheqës të popullit”. Në Librin VIII të Republikës, regjimi demokratik përshkruhet si regjimi më i këndshëm, në të cilin mund të zgjedhësh lirisht lloje të ndryshme jetese dhe kënaqësi të dëshirave. Nuk ka dyshim se demokracia dhe filozofia, dhe veçanërisht filozofia sokratike, lindën si pasardhëse të shoqërisë së *polis*-it. Por ato ishin rivale, çka e dëshmoi dhe historia tragjike e Sokratit. Prandaj, Platoni e konceptoi filozofinë e tij kryesisht si një terapi për të këqijat që preknin qytetin demokratik, anarkinë e vlerave, dorëzimin e fuqisë së vendimmarrjes tekave arbitrare të shumicës së paaftë dhe demagogëve të papërgjegjshëm, mbizotërimin e interesit privat mbi të mirën publike. Për më tepër, demaskimi i demokracisë “së mitur” demagogjike prej tij, mund të lexohet gjithashtu si një kontribut në përcaktimin e kushteve për mundësinë e një regjimi të pjekur demokratik, të aftë për vetëqeverisje (Vegetti, 2013). Si një kritik inteligjent i iluzioneve të demokracisë, ai i jep pikërisht filozofisë detyrën për të ndërtuar kushtet për formën më të mirë të jetës së përbashkët, të mishëruar në ëndrrën e shoqërisë së përsosur që do të zgjidhte njëherë e mirë edhe problemin e demagogëve e demagogjisë.

Në ato demokraci ku sundon ligji nuk ka demagogë, por në krye të shtetit gjënden qytetarët më të zgjedhur (Aristoteli)

Më pak letrar se Aristofani ose Platoni, Aristoteli është i vetmi që ka zhvilluar një teori të vërtetë të qeverisjes demagogjike në antikitet, e cila mbetet aktuale për të reflektuar edhe mbi degjenerimet populiste të kohës sonë. *Politika* është vepra ku termi përdoret qartë në një kuptim të dallueshëm negativ.

Në fakt, nëse për Platonin demokracia është një regjim i pakthyeshëm devijant, Aristoteli nuk duket të shfaqë një gjykim krejt negativ mbi këtë formë qeverisjeje; nëse një demokraci mbetet brenda kufijve të ligjit ajo nuk është e qortueshme, por në atë rast kur vepron “demokracia e demagogëve” të cilët minojnë fuqinë e ligjit për ta bërë demosin sovran, demokracia degjeneron. Pra ndryshe nga Platoni, Aristoteli nuk e barazoi demokracinë me demagogjinë. Ai e trajtoi këtë të fundit të lidhur me një formë specifike të regjimit demokratik, me manifestimin më të keq të këtij regjimi, një version i radikalizuar i saj ku nuk ekziston rendi e drejtësia, një formë korrupsioni në të cilën kontribuojnë si faktorët antropologjikë ashtu edhe institucionalë.

Sipas Aristotelit, një nga karakteristikat që na lejon të identifikojmë këtë shtrembërim të demokracisë është fakti se vendimmarrja kolektive nuk merr formën mbizotëruese të ligjit, por atë të dekretit individual. Në rastet kur populli zgjedh organet e pushtetit e ata që e lakmojnë pushtetin bëhen demagogë, atëherë këta të fundit bëjnë përpjekje të mëdha që popullit t'i sigurojnë pushtet absolut, madje më të madh se të ligjeve. Formalisht, populli mban pushtetin politik, por në realitet janë demagogët ata që e ushtrojnë atë, janë ata zot i mendimit të tij, “padron i opinioneve”

të tij e populli u bindet e sovraniteti popullor është kështu i instrumentalizuar. Qeverisja përmes dekretëve është vepër e tyre duke ndikuar e zënë në grackë asamblenë demokratike. Ky është rasti kur

... autoriteti suprem i përket masës dhe jo ligjit, gjë që ndodh kur vendimet e votuara nga asambleja popullore dhe jo ligji janë sovrane (kanë fuqi të madhe). Dhe kjo është vepër e demagogëve... Në të vërtetë, ligjet duhet të ushtrojnë autoritetin e tyre në çdo rast, ndërsa magjistratët dhe qytetarët duhet të ndërhyjnë në raste të veçanta. Meqë një demokraci është një nga format e qeverisjes, është e qartë se një regjim i tillë, në të cilin çdo gjë rregullohet me vendimet e asamblesë popullore, nuk mund të jetë një demokraci në kuptimin e vërtetë të fjalës, sepse asnjë vendim nuk është universal” (Aristoteli, 2003: 53).

Aristoteli paralajmëron për rrezikun që i kanoset demokracisë kur nuk sundon ligji pasi, sipas tij, demagogët

... i akuzojnë magjistratët e thonë se populli duhet të gjykojë dhe populli i ka për zemër akuzat, por kështu dërmohen institucionet politike. Dhe ndoshta do të kishte arsye ai që mallkonte këtë pushtet të popullit, i cili nuk lë të zerë vend një kushtetutë e vërtetë, sepse atje ku nuk kanë pushtet ligjet, nuk ka kushtetutë... (Aristoteli, 2003: 54).

Por ekziston edhe një element tjetër që karakterizon këtë “demokraci demagogjike” e që Aristoteli e ve në pah: përfaqësimi popullor, si aspekt i demokracisë në këtë formë të veçantë të saj, duket sikur mishëron popullin si një tërësi e paqartë, një masë homogene:

Në qytetet ku demokracia qeveris sipas ligjit nuk ka vend për demagogët dhe qytetarët më të mirë zënë vend në pushtet, ndërsa

demagogët lindin atje ku ligjet nuk janë sovrane; atëherë populli bëhet monark i vërtetë dhe një monark i formuar nga shumica, të cilët janë qytetare, jo të marrë një nga një, por në tërësi, të gjithë së bashku....” (Aristoteli, 2003: 54).

Aristoteli kap këtë aspekt të përvojës demagogjike ku demagogu e paraqet veten si zëdhënësin autentik të vullnetit të gjithë “popullit”. Ndërsa brenda kësaj tërësie ekzistojnë qytetarë që, si individë ose si anëtarë të grupeve apo organizimeve të ndryshme, shprehin interesa, identitete dhe vizione të ndryshme, demagogu ndërton një përfaqësim mitik të popullit, si një entitet kolektiv unitar.

Demagogjia mund të bëhet një forcë negative, mund ta korruptojë demokracinë kushtetuese deri në atë pikë sa ta bëjë atë tiranike, pasi kontribuon në prishjen e ekuilibrit shoqëror dhe politik, pezullimin e sundimit të ligjit dhe minimin e mundësisë së kompromisit. Në këtë situatë, demokracia bëhet e ngjashme me tiraninë edhe në aspektin e retorikës publike. Kështu, sipas Aristotelit, gjuha instrumentalizohet plotësisht nga lajkatarët demagogë në rastin e demokracisë, nga servilët në atë të tiranisë, me qëllim fitimin e besimit të atyre në duart e të cilëve është përqendruar pushteti, përkatësisht, popullit dhe tiranit

Populli, duke u gjendur në këto kushte dhe duke qenë për këtë lloj monarku, kërkon të ushtrojë pushtetin i vetëm, duke mos pranuar autoritetin e ligjeve dhe bëhet despotik, sepse vendimet e marra nga populli bëhen për nder të lajkatarëve. Kjo demokraci bëhet e njëjtë si ajo monarki që quhet tirani. Dhe njëllojshmëria qëndron në zakonet që mbretërojnë, në shtypjen që ushtrohet mbi njerëzit më të mirë, në pozitën që fitojnë në këtë rast të demokracisë

vendimet e asambleve dhe në monarki urdhrat e tiranit, me ngjashmërinë e demagogëve dhe lajkatarëve. Në fakt, të dy këta (demagogët dhe lajkatarët) kanë fuqi të madhe ndaj padronëve të tyre: lajkatarët ndaj tiranëve dhe demagogët ndaj popullit që ka pozitë në qytet... (Aristoteli, 2003: 54).

Sipas studiuesit Lucio Bertelli, ky imazh i demos-it tiran, i udhëhequr dhe i nxitur nga demagogët, i detyrohet, më shumë sesa situatave historike të verifikueshme, traditës antidemokratike dhe veçanërisht lidhjes së ngushtë midis retorikës demagogjike me demokracinë, teorizuar nga Platoni në veprat *Gorgias* dhe *Republika* (Bertelli, 2018).

Aristoteli, në zbërthimin që i bëri fenomenit të demagogjisë, kontribuoi në mënyrë të veçantë me analizën që i bëri retorikës. Në të vërtetë, është e pamundur të injorohet rëndësia e retorikës në traditën e lashtë greke, pavarësisht nëse vlerësohej apo kritikohet, siç është rasti me vizionin sokratiko-platonik, që e konsideroi atë pseudo-shkencë. Sigurisht, një *politeia en logos*, që e bazon identitetin e vet në debat, në diskutim, në lirinë oratorike, i jepte mundësi kujtdo për të shprehur lirisht mendimet e veta në kuvend. Aristoteli i kushton një traktat specifik retorikës, duke e përcaktuar atë si artin e bindjes, por ndryshe nga mësuesi i tij Platoni, ai njih asaj një status jo tërësisht negativ dhe një shkallë të caktuar autonomie. Si art i bindjes, në vetvete retorika nuk është as e mirë e as e keq, por kjo nuk pengon që të keqpërdoret, si në rastin e demagogëve, për të joshur njerëzit e fituar për krahen e tyre. Kjo qasje ndaj saj me përdorimin instrumental, lajkatar, do i shënjojë edhe termi “demagog” konotacion negativ, një rezultat i pashmangshëm në fakt i oratorisë politike.

Sidoqoftë në veprën e tij lidhur me retorikën, risia e Aristotelit do të qëndrojë në përpjekjen e tij për ta transformuar atë nga thjesht praktikë (*ἐμπειρία*), e aftë të bindë këdo për çdo gjë, siç ishte damkosur nga tradita e mëparshme sofistike, në një *τέχνη* të vërtetë, e aftë për të mishëruar vlerën e logosit, dimensionin racional. Falë Aristotelit, retorika u bë ajo aftësi e normuar, në sajë të së cilës dikush është në gjendje të arsyetojë rreth çdo problemi të propozuar. Duke analizuar retorikën aristoteliane, studiuesi i njohur i antikitetit Giovanni Reale vlerëson se për filozofin, retorika është një metodologji bindjeje; problemi themelor i retorikës aristoteliane janë mekanizmat, domethënë strukturat logjike që mbështesin format e fjalimeve (të mesazheve) që synojnë të bindin. Në traktatin e tij *Retorika*, Aristoteli argumenton se ajo nuk duhet të jetë e bazuar në ndjenjë (nxitjes të së cilës retorët i jepnin rëndësi të madhe), por të jetë njësh me të vërtetën, drejtësinë dhe mirëdashësinë e në shërbim të tyre. Vërtet retori duhet ta kuptojë shpirtin njerëzor për të ngjallur pasion tek dëgjuesi, por më e rëndësishme është që ai të jetë në gjendje të formulojë argumente logjike (Reale, 1987: 48).

Aristoteli argumentoi se bindja retorike vepronte nëpërmjet tre mekanizmave kryesorë: *logos* (arsyetimi me argumentet e duhura), *ethos* (apelimi ndaj autoritetit, besueshmërisë dhe karakterit moral të oratorit) dhe *pathos* (nxitja e emocioneve të audiencës). Sidoqoftë ai është i kujdesshëm të tregojë se *pathos*-i, emocionet, mund të rrisin gjykimin dhe të kontribuojnë në procesin e diskutimit vetëm kur ato janë të rëndësishme për temën në diskutim. Anasjelltas, një përdorim demagogjik dhe manipulues i emocioneve në retorikë ndodh kur ato përdoren instrumentalisht, pa asnjë lidhje me temën. Edhe *ethos*-

in, Aristoteli e konsideron shumë të rëndësishëm; folësi në fakt duhet të jetë i aftë ta vërë audiencën në gjendje të duhur emocionale në mënyrë që të bindet, por duke shfaqur një qëndrim dashamirës ndaj saj, duke manifestuar shqetësimin për problematikat e situatën e saj. Nga ana tjetër, argumentimi sa më i mirë i çështjeve publike kërkon gjithashtu një proces të gjerë përvojë praktike, ku parimet e retorikës rrënjosen thellë në arsyetimin praktik të folësit, duke u integruar në *ethos*-in e tij. Madje, sipas Aristotelit, ky asimilim gradual i parimeve retorike mbi bazën e *ethos*-it formon premisën që retorika të evoluojë në një virtyt qytetar, brenda kornizës teleologjike të ndjekjes së *jetës së mirë*, e mundur vetëm në një formë të drejtë regjimi jo demagogjik. Elementi i fundit dhe ndoshta kryesor që Aristoteli identifikon për ta bërë retorikën një mjeshtëri, një art qytetar, në vend të një instrumenti demagogjike, është nënshtrimi i saj ndaj filozofisë morale dhe shkencës së politikës (Aristoteli, 2024).

Përfundime

Demagogjia është pjesë integrale e praktikës së demokracisë, për shkak të zbatimit të parimit të fjalës së lirë. Fillimisht, termat demagog, demagogji nuk nënkuptonin domosdoshmërisht një qëndrim kritik nga ana e përdoruesit të këtyre fjalëve. Platoni dhe filozofët e mëvonshëm, shkruan për demagogët në mënyrë kritike dhe përdorën termin “burrë shteti” (*politikos*) si të kundërtën e tij normative. Në *Politikën* e tij, Aristoteli argumentoi se demagogët mund të sjellin llojin e demokracisë së drejtpërdrejtë, që sot do të quhej populiste, një lloj demokracie në të cilën “turma është sovranë dhe jo ligji”. Ai gjithashtu e kuptoi demagogjinë edhe si një problem të përdorimit të gjuhës në komunikimin publik, domethënë retorikës,

nëse ajo e relativizon të vërtetën ose e shpërfill atë krejtësisht.

Demagogjia është një fenomen politik i përhapur që manifestohet përmes përdorimit të argumenteve emocionale, retorikës “mashtuese” dhe premtimeve të paplotësuara, për të fituar mbështetje popullore. Në kontekstin bashkëkohor, ky fenomen është bërë një shqetësim në rritje,

veçanërisht në një epokë të karakterizuar nga kriza ekonomike, konflikte sociale dhe polarizim politik. Për ta kuptuar plotësisht këtë fenomen, është e rëndësishme të kuptojmë origjinën e tij, karakteristikat e tij kryesore dhe pasojat që demagogjia mund të ketë në peizazhin politik dhe opinionin publik në përgjithësi; tradita e mendimit antik është burim autentik për këtë.

REFERENCAT

- Wolf, L. K. A. (2015). *Effects of Peer Influence in Adolescence* (Doctoral dissertation, UCL (University College London)).
- Aristofani. (1962). *Kalorësit*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”.
- Aristoteli. (2003). *Politika*, Tiranë: Konica.
